



ZYRA E
BASHKIMIT
EVROPIAN
NË KOSOVË

INSTITUTI PËR
HULUMTIME
ZHVILLIMORE
RIINVEST



KLIMA E BIZNESIT NË KOSOVË

NJË PERSPEKTIVË NDËR-RAJONALE



KLIMA E BIZNESIT NË KOSOVË



NJË PERSPEKTIVË
NDËR-RAJONALE

2014

TABELA E PËRMBAJTJES

07 LISTA E AKRONIMEVE

09 HYRJE

11 1. KOSOVA NË NJË VËSHTRIM

12 1.1. Zhvillimi i sektorit privat në Kosovë

15 2. PROFILET E PESË RAJONEVE EKONOMIKE TË KOSOVËS

23 3. METODOLOGJIA

25 4. GJETJET E ANKETËS

25 4.1. Performanca e NVM-ve

31 4.2. Lista e përgjithshme e barrierave në të bërit biznes

34 4.3. Analizë e detajuar e barrierave zhvillimore të NVM-ve

34 a) Barrierat financiare

37 b) Barrierat që lidhen me informalitetin

40 c) Barrierat fiskale

42 d) Barrierat ligjore

45 e) Barrierat institucionale

47 f) Barrierat e fuqisë punëtore

48 g) Barrierat infrastrukturore

51 h) Barrierat tjera

54 4.4. Përmbledhje për të ardhmen e bizneseve dhe për barrierat e tyre

56 4.5. Perspektiva e bizneseve mbi institucionet lokale dhe qendrore

63 5. REZULTATET E FOKUS GRUPIT

63 5.1. Barrierat në zhvillimin e NVM-ve

63 a) Barrierat e fuqisë punëtore

64 b) Barrierat infrastrukturore

64 c) Barrierat financiare

65 d) Barrierat ligjore

66 e) Barrierat fiskale

66 5.2. Marrëdhëniet në mes të bizneseve dhe institucioneve

66 a) Përfshirja e bizneseve në politik-bërje

67 b) Niveli i ndihmës financiare nga qeveria qendrore dhe qeveritë lokale

67 c) AZhR-të dhe roli i tyre

68 5.3. Vlerësimi i strategjive zhvillimore rajonale

70 5.4. Sektorët me potencial rritjeje

75 KONKLUZIONI DHE REKOMANDIMET

80 REFERENCAT

Financuar nga:
Tyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe
Asociacioni i Agjencive Zhvillimore Rajonale



Deklaratë mohimi:

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e
Institutit Riinvest dhe në asnjë rrethanë nuk i paraqet pikpamjet
e Bashkimit Evropian.

Kontribuuesit:

Agon Nixha, Diellza Gashi, Premton Hyesni,
Gent Beqiri, Lumir Abdixhiku dhe Alban Hashani

Faqosja dhe Dizajni

Faton Selani

Originali është shkruar në anglisht

Publikuar nga:

INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 42
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816
www.riinvestinstitute.org



LISTA E AKRONIMEVE

ASK	→	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	→	Administrata Tatimore e Kosovës
AZhR	→	Agjencitë Rajonale Zhvillimore
BE	→	Bashkimi Evropian
BIRN	→	Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese
BPV	→	Bruto Produkti Vendor
CEFTA	→	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
CIDA	→	Agjencia Ndërkombëtare Zhvillimore e Kanadasë
ECMI	→	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
FPM	→	Federata e Punësimit në Mal të Zi
ICT	→	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IHD	→	Investimet e Huaja Direkte
KE	→	Komisioni Evropian
MTI	→	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NVM	→	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OJQ	→	Organizata jo-qeveritare
OZHM	→	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
STIKK	→	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës
TVSH	→	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNDP	→	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara

HYRJE

Është e ditur dhe e pranuar gjerësisht se përmirësimi i klimës së biznesit — duke përfshirë aspektet financiare, rregullatore, ligjore, dhe institucionale — ka një ndikim pozitiv në zhvillimin e përgjithshëm të sektorit privat. Ndikimi i zhvillimit të sektorit privat në përmirësimin e mirëqenies socio-ekonomike të një vendi është jo-ekuivok. Ky sektor performon në mënyrë efikente në nivele të ndryshme të prodhimit, krijon kushte për zgjidhje inovative për barrierat teknike dhe operacionale dhe nxit inovacionin teknologjik dhe transferimin e njohurive.

Sektori privat ka qenë i domosdoshëm për arritjen e rezultateve të rëndësishme të zhvillimit nëpër botë. Ky sektor përbën pjesën më të madhe të BPV-së në shumë vende në zhvillim. Është gjithashtu përgjegjës për rreth 90 përqind të vendeve të punës në botë (Banka Botërore, 2012), dhe mbart peshën më të rëndë në arritjen e Objektivit të parë të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) të përgjysmimit të numrit të njerëzve që jetojnë me më pak se 1 \$ në ditë deri në vitin 2015 (CIDA, 2003). Përveç kësaj, në shumë vende sektori privat gjeneron një pjesë të madhe të të ardhurave nga taksat për të siguruar shërbime shëndetësore, arsim dhe shërbime të tjera të rëndësishme publike. Thënë ndryshe, sektori privat paraqet burimin kryesor për rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, zbutjen e varfërisë, si dhe për rritjen e të hyrave të qeverisë në shumë vende të zhvilluara dhe në zhvillim.

Prej hyrjes në rrugën e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut, Kosova është përballur vazhdimisht me pengesa të natyrave të ndryshme që, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë reflektuar në mjedisin e biznesit dhe si rezultat kanë penguar zhvillimin e sektorit privat në vend. Përkundër disa reformave të fundit, Kosova ende renditet e 86-ta nga 189 vende në Raportin e të Bërit Biznes të Bankës Botërore 2014, më keq se të gjitha vendet e tjera fqinje me përjashtim të Shqipërisë. Maqedonia, për shembull, renditet e 25-ta, apo 61 vende më lart se Kosova. Për më tepër, bizneset e Kosovës veprojnë në një mjedis ku konkurrenca e pandershme, korrupsioni, sistemi gjyqësor jo-funksional, dhe faktorë tjerë të dëmshëm, përbëjnë “rregullat dominuese të lojës”. Kjo klimë e pafavorshme e biznesit ka qenë një barrë për bizneset ekzistuese të Kosovës (54 përqind e tyre kanë pësuar rënie të shitjeve të tyre), ndërsa në të njëjtën kohë ka dërguar sinjale negative për investitorët e huaj potencialë, duke ulur fluksin e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) (Riinvest, 2013).

Duke marrë parasysh fotografinë jo të mirë të sektorit privat në Kosovë, Instituti Riinvest është përcaktuar se duhet bërë një vlerësim i klimës së biznesit. Instituti, me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ka vendosur që të përpilojë një raport që kryesisht ka për qëllim ofrimin e një pasqyre më të qartë të: (i) zhvillimit të mjedisit të biznesit në periudhën 2009-2012; (ii) gjendjes së tanishme të klimës së biznesit; dhe (iii) mundësive të rritjes afat-mesme dhe rreziqeve potenciale. Duke i mbuluar këto tri pika, do të jetë e mundur të shihet trendi i mjedisit të biznesit gjatë viteve të fundit, dhe në të njëjtën kohë, të

bëhen parashikime për të ardhmen. Përveç rishikimit të hulumtimeve ekzistuese, ky raport mbështetet në një studim reprezentativ me bizneset, si dhe në të gjeturat e gjeneruara nga diskutimet në fokus grupe që përfshijnë akterë jo-biznesorë si: zyrtarët e komunave, shoqërinë civile dhe akterët e tjerë.

Gjatë viteve të fundit, ka pasur punë të gjerë empirike që hedh dritë mbi klimën e biznesit në Kosovë (për shembull: Instituti Riinvest 2003, 2011, 2013; Oda Ekonomike e Kosovës, 2013). Megjithatë, me dijeninë e autorëve, studimet ekzistuese i qasen kësaj teme nga këndvështrimi kombëtar, duke paraqitur kështu vetëm rezultate agregate. Në këtë raport, për herë të parë, Instituti Riinvest studion çështjen prej perspektives rajonale. Për të qenë më specifik, Instituti ka anketuar 1000 biznese — 200 nga secili prej pesë rajoneve ekonomike në Kosovë¹; dhe në të njëjtën kohë, ka zhvilluar pesë diskutime në fokus grupe — sërish, një për secilin rajon. Duke përfutur nga të dyja, pra mostrës së madhe të bizneseve të anketuara në njërin anë dhe diskutimeve nga fokus grupet në anën tjetër, ekipi i Riinvest-it ka gjeneruar rezultate për çdo rajon, ka krahasuar përgjigjet e rajoneve, si dhe ka analizuar nëse rezultatet ndryshojnë nga klima e përgjithshme e biznesit në vend. Ky raport jep rekomandime specifike për grupe të ndryshme të akterëve që mund të përdoren në proceset e politikë-bërjes.

Pjesa tjetër e këtij raporti është e organizuar si më poshtë. *Seksioni 1* jep një pasqyrë të situatës së përgjithshme socio-ekonomike në Kosovë, dhe më pas paraqet një përmbledhje të shkurtër të zhvillimit të sektorit privat në vend. *Seksioni 2* jep një përmbledhje socio-ekonomike të pesë rajoneve ekonomike në vend, duke u fokusuar veçanërisht në analizën SWOT, marrë nga strategjitë e zhvillimit rajonal. *Seksioni 3* jep një pasqyrë të përgjithshme të metodologjisë së hulumtimit të përdorur për të shqyrtuar temën e klimës së biznesit në Kosovë. *Seksioni 4* paraqet, diskuton dhe analizon gjetjet e anketës mbi performancën e bizneseve, pengesat në të bërit biznes, dhe mbi marrëdhëniet ndërmjet bizneseve dhe institucioneve, duke përfshirë Agjencitë për Zhvillim Rajonal (AZHR). *Seksioni 5* paraqet gjetjet e pesë diskutimeve në fokus grupe. Këto konstatime, të cilat janë të natyrës kualitative, në radhë të parë trajtojnë pengesat për të bërë biznes dhe marrëdhëniet bizneso-institucionale. Përveç kësaj, ky seksion tregon gjetjet që vlerësojnë zbatimin e prioritetëve të përfshira në strategjitë e zhvillimit rajonal. *Pjesa e fundit* përmbyll dhe jep rekomandime mbi gjetjet kryesore.

¹ Rajoni Qendër e përfshin komunën e Drenasit, Fushë Kosovës, Kastriotit/Obiliqit, Graçanicës, Lipjanit, Podujevës dhe Shtimes. Rajoni Jug e përfshin komunën e Dragashit, Malishevës, Mamushës, Prizrenit, Rahovecit dhe Therandës. Rajoni Lindje e përfshin komunën e Artanës, Kamenicës, Ferizajt, Gjilanit, Kaçanikut, Shtërpcës, Vitisë, Hanit të Elezit, Klllokotit, Ranillugës dhe Parteshit. Rajoni Perëndim e përfshin komunën e Burimit/Istogut, Deçanit, Junikut, Klinës, Pejës, Gjakovës. Rajoni Veri e përfshin komunën e Mitrovicës, Skenderajt, Vushtrrisë, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit.



Në krahasim me vendet fqinje, performanca ekonomike e Kosovës nuk është në nivel të kënaqshëm, pasi që BPV-ja për kokë banori është më e ulëta.”



1. KOSOVA NË NJË VËSHTRIM

Kosova është një vend relativisht i vogël që ndodhet në Evropën Juglindore. Ajo ka një popullsi prej rreth 1.8 milion banorësh, me 50.55 përqind meshkuj dhe 49.45 përqind femra; afërsisht 61 përqind e njerëzve jetojnë në zonat rurale (ASK, 2013). Në vend janë 163.2 banorë për kilometër katror dhe rreth 297.090 familje me 5.9 njerëz në çdo familje mesatarisht (ASK, 2013).

Profili ekonomik i Kosovës nuk duket shumë i shëndoshë. Kosova vazhdon të përballet me shkallë të lartë të papunësisë. Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2012 në Kosovë (2013) tregojnë se rreth 1.2 milion, ose dy të tretat e popullsisë së përgjithshme, janë në grupin e moshës së punës (njerëzit e moshës 15-64). Nga totali i grupit në moshën e punës, vetëm 36.9 përqind janë aktivë në fuqinë punëtore (438,544 persona). Nga numri i përgjithshëm i njerëzve aktivë në fuqinë punëtore, 69.1 përqind (302,844 persona) janë të punësuar dhe 30.9 përqind janë të papunë (135,700 persona) (ASK, 2013). I njëjti burim thekson se papunësia është shumë më e lartë tek femrat sesa tek meshkujt, 40.0 përqind, krahasuar me 28.1 përqind, respektivisht. Shifra më dekurajuese është norma e papunësisë së të rinjve (të moshës 15-24), e cila është më e larta në mesin e të gjitha grup-moshave me 55.3 përqind (ASK, 2013). Rreth 63.8 përqind e femrave të reja dhe 52.0 përqind e meshkujve të rinj të fuqisë punëtore janë të papunë (ASK, 2013).

Shkalla e lartë e papunësisë në mesin e popullatës rinore mund të ketë ndikuar deri në një masë në vetëbesimin e tyre, pasi atyre nuk u është dhënë një mundësi për t'i demonstruar aftësitë dhe talentet e tyre. Si rezultat, shumë prej tyre janë të dekurajuar dhe synojnë të punojnë jashtë Kosovës. Shkalla e lartë e papunësisë, për më tepër, ka çuar në një shkallë të lartë të varfërisë. Në Kosovë, rreth 34.5 përqind e popullsisë jeton në varfëri, dhe rreth 12.1 përqind jeton në varfëri të skajshme me më pak se 1 € në ditë (ASK, 2013). Arsyeja kryesore prapa këtyre shifrave dekurajuese është e lidhur me zhvillimin e dobët të sektorit privat dhe investimet e ulëta kapitale. Shumica e bizneseve të Kosovës ofrojnë vende pune që kërkojnë vetëm aftësi të nivelit të ulët – kjo gjithashtu ka efekt në motivimin e punëtorëve për të ndjekur arsimin e duhur (UNDP, 2012). Përveç kësaj, bizneset e pakta të cilat kërkojnë aftësi të avancuara raportojnë se universitetet dhe kolegjet në Kosovë nuk e lidhin programin e tyre në mënyrë efektive me aftësitë e kërkuara nga tregu; prandaj, studentët e pajisur me diploma nga këto institucione nuk i plotësojnë kërkesat e tyre.

Gjatë vitit 2013, ekonomia e Kosovës vlerësohet të jetë rritur me një normë prej 2.5 përqind me një PBV prej 5.15 miliard € në vlerë nominale dhe 2.794 € PBV për kokë banori (FMN, 2013). Në krahasim me vendet fqinje, performanca ekonomike e Kosovës nuk është në nivel të kënaqshëm, pasi që BPV-ja për kokë banori është më e ulët në mesin e tyre. Sipas Bankës Botërore (2014), në vitin

2012 PBV-ja më e lartë për kokë banori u regjistrua nga Mali i Zi (5,275 €), e ndjekur nga Serbia (3,930 €), Maqedonia (3,545 €), Bosnja dhe Hercegovina (3,429 €), Shqipëria (3,091 €) dhe e fundit me BPV-në më të ulët për kokë banori është Kosova (2,708 €). Si rezultat i shkallës së ulët të rritjes, e cila nuk ka qenë në gjendje të kënaqë nevojat e zhvillimit të vendit dhe të përmirësimit të standardet e jetesës të qytetarëve, Kosova mbetet vendi më i varfër në rajon, si dhe në Evropë.

Ngjashëm me vitet e mëparshme, në vitin 2013 ekonomia e Kosovës ka vazhduar të përballet me deficitin e lartë të llogarisë rrjedhëse, i cili është shkaktuar kryesisht nga deficitin e lartë tregtar. Sipas Doganave të Kosovës (2014), deficitin tregtar në vitin 2013 është 2.1 miliard €, duke shënuar një rënie prej 2.2 miliard € në vitin 2012. Disa nga partnerët kryesorë tregtarë janë Italia, Turqia, Shqipëria, Maqedonia, India, Gjermania, Mali i Zi, dhe Serbia². Gjatë vitit 2013, Kosova ka eksportuar kryesisht në Itali, me rreth 25 përqind të pjesës së përgjithshme të eksporteve, dhe ka importuar kryesisht nga Serbia me 12 përqind pjesëmarrje të totalit të importeve. Përveç afërsisë gjeografike dhe faktorëve historik, një arsye tjetër se pse Kosova është angazhuar kryesisht në tregti me vendet fqinje është Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), e cila u nënshkrua në vitin 2006 nga Kosova (me UNMIK-un si nënshkruese), Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, dhe Serbia (CEFTA, 2014).

IHD ka qenë më e larta në vitin 2007 (440.7 milion €) dhe ka shënuar një rënie të konsiderueshme çdo vit që nga ai vit. Në vitin 2008, IDH arriti në 366.4 milion €, në vitin 2009 – 287.4 milion €, në vitin 2010 – 365.8 milion €, në vitin 2011 – 393.8 milion € dhe në vitin 2012 – 228.6 milion € (BQK, 2014). Së fundi, në shtator të 2013-ës, IDH arriti në 204.9 milion €. Deri në fund të vitit, IDH pritet të ketë arritur 255 milion €, ose me fjalë të tjera një rritje prej 12 përqind (BQK, 2014). Një nga arsyet për rënie të konsiderueshme gjatë periudhës 2008-2010 mund t'i atribuohet krizës financiare globale. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se privatizimi i ndërmarrjeve publike zakonisht sjell sasi më të madhe të investimeve të huaja direkte; prandaj, rënia mund t'i atribuohet edhe fundit të valëve më të mëdha të privatizimit në vend. Megjithatë, e njëjta nuk mund të thuhet për periudhën 2011-2013. Arsyeja kryesore për rënien e IDH kryesisht mund t'i faturohet imazhit të keq të Kosovës, të krijuar nga niveli i lartë i korrupsionit (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit rendit Kosovën në vendin e 111 nga 177 pozicione me një rezultat 33/100), zhvatjes, krimit

² Italia (EKS: 25.0%; IMP: 10.0%), Turqia (EKS: 3.0%; IMP: 9.0%), Shqipëria (EKS: 15.0%; IMP: 5.0%), Maqedonia (EKS: 9.0%; IMP: 8.0%), India (EKS: 10.0%; IMP: 1.2%), Gjermania (EKS: 4.0%; IMP: 11.0%), Mali i Zi (EKS: 6.0%; IMP: 0.5%) dhe Serbia (EKS: 5.0%; IMP: 12.0%).

të organizuar dhe burokracisë dhe probleme të tjera të ngjashme. Sa i përket origjinës së IHD-ve, vendet e Bashkimit Europian (BE) vazhdojnë të jenë investitorët kryesorë në Kosovë. Sipas Raportit të Bilancit të Pagesave të BQK-së (2013), në vitin 2012, Turqia tejkaloi Britaninë e Madhe, duke u bërë investitori numër një në Kosovë me 28.3 përqind të totalit të IHD (BQK, 2013).³

Remitancat kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm gjatë gjithë viteve në përmirësimin e mirëqenies për qytetarët e Kosovës, pasi ato përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të të ardhurave për ta. Në vitin 2012, një përqindje prej 22.4 përqind të familjeve të Kosovës ka pranuar remitancë nga anëtarët e familjes që jetojnë jashtë vendit (ASK, 2013). Shifrat e hyrjeve kanë mbetur pozitive gjatë gjithë viteve me luhajtje të vogla për shkak të krizës ekonomike në vendet dhe sektorët ku pjesëtarët e Diasporës jetojnë dhe punojnë. Në vitin 2012, remitancat ishin 457 milion € dhe përfaqësonin 9.3 përqind të PBV-së (ASK, 2013). Deri në korrik 2013, remitancat arritën 272.4 milion €, dhe deri në fund të vitit, dërgesat pritet të kenë arritur 632 milion € (BQK, 2014). Këto shuma pozitive tregojnë se remitancat janë një nga komponentët më të rëndësishme të bilancit të pagesave dhe ndihmojnë uljen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Për më tepër, remitancat ndihmojnë në financimin dhe rritjen e konsumit në Kosovë pasi që shumica e fondeve të dërguara shpenzohen për konsum.

Edhe 15 vjet pas luftës, ekonomia e Kosovës ende vazhdon të mbështetet në burime të paqëndrueshme të rritjes, të tilla si importet e mallrave, shpenzimet qeveritare dhe remitancat. Sipas Bankës Botërore (2010), në mënyrë që Kosova të arrijë nivelin e të ardhurave në Shqipëri (vendi i dytë më i varfër në Ballkan) deri në vitin 2020, ajo do të duhet të ketë një rritje vjetore prej 10 përqind. Nga viti 2010 në 2013, Kosova nuk ka qenë e suksesshme në arritjen e këtij objekti, pasi PBV-ja u rrit çdo vit për vetëm 3.2 përqind, 4.4 përqind, 2.5 përqind dhe 2.5 përqind, respektivisht (FMN, 2013). Kjo performancë e dobët makro-ekonomike kryesisht mund t'i atribuohet zhvillimit të dobët të sektorit privat, i cili në vetvete është një pasqyrë e mjedisit në të cilin vepron.

1.1. Zhvillimi i sektorit privat në Kosovë

Siç u tha në fillim të këtij raporti, zhvillimi i sektorit privat është me rëndësi kritike pasi që krijon ndërmarrje që sjellin më shumë vende pune dhe fuqizimin, sjell teknologji të reja dhe inovacion, dhe si rezultat i kësaj rrit të ardhurave të vendit. Në të vërtetë, në shumë vende në zhvillim, sektori privat konsiderohet si motori

kryesor i rritjes ekonomike. Pavarësisht rolit të tij të rëndësishëm, shifrat e këtij sektori në Kosovë nuk janë shumë inkurajuese, sidomos kur krahasohen me vendet fqinje.

Kosova ka një numër shumë të ulët të bizneseve të reja të krijuara, dhe shumë nga ato dështojnë shpejtë pas themelimit të tyre. Për të qenë më specifik, densiteti i bizneseve të reja në Kosovë në 2012 (regjistrime të reja për 1000 njerëz të moshës 15-64) ishte 1.2 – që është për shembull tre herë më i ulët se i Maqedonisë fqinje (3.6) (Banka Botërore, 2013). Vlen të përmendet se 92 përqind e bizneseve të Kosovës janë mikro-ndërmarrje (1-9 punëtorë), biznese kryesisht në pronësi të familjes, kështu që ka mundësi të kufizuar për risi dhe për të arritur ekonominë e dobishme të shkallës. Shpërndarja gjeografike e bizneseve kosovare, për më tepër, është shumë e pabarabartë. Shumica dërrmuese (një e treta prej tyre) janë të përqendruara rreth Prishtinës, duke lënë pjesët e tjera të Kosovës më pak të zhvilluara.

Në mënyrë të ngjashme, performanca e bizneseve kosovare nuk duket të jetë e kënaqshme. Një anketë e Institutit Riinvest (2013) tregon se, në krahasim me vitin e kaluar, një mesatare prej 54 përqind të bizneseve ekzistuese të Kosovës kanë deklaruar se shitjet e tyre kanë rënë (një rënie prej 34 përqind), 21 përqind kanë deklaruar se shitjet u rritën (një rritje prej 22 përqind), dhe 25 përqind prej tyre kanë thënë se shitjet e tyre nuk kanë shënuar ndryshime. Për më tepër, studimi tregon se bizneset në Kosovë bëjnë pjesën më të madhe të shitjeve të tyre brenda vendit. Mesatarisht, 89 përqind e totalit të shitjeve janë bërë në Kosovë, ndërsa 11 përqind të mbetura janë bërë jashtë Kosovës.

Një gamë e pengesave të ndryshme kontribuojnë në fotografimin e pafavorshme të sektorit privat. Barrierat që lidhen kryesisht me nivelin jo të kënaqshëm të zbatimit të ligjit përbëjnë pengesat kryesore që vështirësojnë krijimin dhe zhvillimin e firmave të reja në sektorin privat. Më konkretisht, Instituti Riinvest (2013) tregon se pengesat të tilla si konkurrenca e pandershme (e shtyrë nga evazioni fiskal dhe informaliteti në përgjithësi), korrupsioni, krimi i organizuar, dhe një sistem jo-funksional gjyqësor janë perceptuar si pengesat më serioze nga bizneset. Vlen të përmendet këtu se, sipas anketës së Riinvest-it, për shkak të performancës së jo-eficiente të sistemit gjyqësor, 62 përqind e bizneseve të Kosovës deklaruan se nuk i besojnë gjykatave fare. Pengesa të tjera me të cilat përballen zakonisht bizneset përfshijnë qasjen e kufizuar në financa, koston e lartë të financave (OEK 2013; MTI 2013) dhe barrierat fiskale (Riinvest, 2013).

Bazuar në këtë fotografi, duket se Kosova është duke hequr për të krijuar një klimë të favorshme biznesore që do të krijonte para kushte për një sektor privat të shëndoshë dhe të qëndrueshëm, i cili do të sillte bizneseve të reja konkurrense, vende të reja punë, dhe një përmirësim në mirëqenien e përgjithshme socio-ekonomike të njerëzve.

3 Në 2011, Britania e Madhe printe me 20.3 përqind të totalit të Investimeve të Huaja Direkte. Gjermani vinte e dyta me rreth 21.5 përqind investime; Zvicra ishte e treta me rend sa i përket investimeve në Kosovë me 19 përqind; Britania e Madhe me 6.2 përqind; Shtetet e Bashkuara me 4.7 përqind; dhe Sllovenia me 4 përqind (BQK, 2013).



Shkalla e papunësisë së të rinjve (të moshës 15-24 vjeçare) është më e larta në mesin e të gjitha grup-moshave me

55.3%




Deficiti tregtar në 2013-ën është **2.1 miliard €**, duke shënuar një rënie prej **2.2 miliard €** sa ishte në 2012-ën.

IHD-të kanë qenë më të lartat në vitin 2007, 440.7 milion €, dhe kanë shënuar një rënie të konsiderueshme çdo vit që nga ajo kohë. Në 2013 IHD ishin 228.6 milionë €.



Ndërmarrjet
që veprojnë në
Kosovë janë
kryesisht me
pronarë meshkuj;
rreth 91.5 përqind
e bizneseve
në vend janë
në pronësi të
meshkujve,
ndërsa vetëm
8.5 përqind janë
në pronësi të
femrave.



2. PROFILET E PESË RAJONEVE EKONOMIKE TË KOSOVËS

Në mënyrë që të promovohet zhvillimi ekonomik rajonal dhe rural në Kosovë, një initiative e përbashkët e përberë nga Qeveria e Kosovës, Asociacionet Komunale dhe Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë i ka organizuar komunat në pesë rajone ekonomike (Veri, Lindje, Perëndim, Jug dhe Qendër). Secili rajon ka komunat e tij të caktuara dhe nga një Agjenci të Zhvillimit Rajonal që është përgjegjëse të koordinojë, mbështesë, planifikojë dhe lehtësojë aktivitetet e zhvillimit socio-ekonomik në rajonet e tyre. Ky seksion paraqet informata hyrëse në lidhje me pesë rajonet ekonomike në Kosovë.

Para se të paraqiten përparësitë dhe mangësitë e rajonit specifik, është me rëndësi të përmenden disa informata të përgjithshme rreth pesë rajoneve ekonomike. Rajoni Qendër prin me numrin më të madh të popullsisë – 497,907, pasuar nga Rajoni Jug – 387,828, Rajoni Lindje – 346,559, Rajoni Perëndim – 314,894 dhe Rajoni Veri – 232,833. Numri i popullsisë për Rajonin Veri është një vlerësim i përafëruar, bazuar në regjistrimin zyrtar të popullsisë të 195,637, dhe 40,196 njerëz të parashikuar që jetojnë në 3 komunat e veriut të populluara me Serbe Kosovare (KAS, 2013).

Numri i bizneseve në secilin rajon ekonomik dhe struktura e tyre është si në vazhdim. Rajoni Qendër prin përsëri me numrin më të madh të bizneseve të regjistruara (19,659) pasuar nga Rajoni Lindje me (12,441), Rajoni Perëndim (9,614), Rajoni Jug (9,432) dhe Rajoni Veri (8,103) (KTA, 2012). Siç mund të shihet në Figurën 1, Rajoni Qendër e ka përqindjen më të madhe 33, pasuar nga Rajoni Lindje (21 përqind), Rajoni Perëndim (16 përqind), Rajoni Jug (16 përqind) dhe Rajoni Veri (14 përqind).

Struktura e bizneseve në secilin rajon ekonomik është e njëjtë me strukturën e përgjithshme të bizneseve në Kosovë. Mikro-ndërmarrjet me 1 deri 9 punëtorë përbejnë pjesën më të madhe në secilin rajon (Rajoni Qendër – 17,482; Rajoni Lindje – 11,311; Rajoni Perëndim – 8,930; Rajoni Jug – 8,869; Rajoni Veri – 7,597), pasuar nga ndërmarrjet të vogla me 10 deri 49 punëtorë (Rajoni Qendër – 1,932; Rajoni Lindje – 680; Rajoni Perëndim – 644; Rajoni Jug – 41; Rajoni Veri – 34). Ndërmarrjet e mëdha me më shumë se 250 punëtorë përbejnë numrin më të vogël në secilin rajon (Rajoni Qendër – 40; Rajoni Lindje – 10; Rajoni Perëndim – 6; Rajoni Jug – 2; Rajoni Veri – 3) (Shih Tabelën 1). Kjo strukturë e bizneseve konfirmon përsëri se strategjia e qeverisjes lokale dhe qendrore drejt zhvillimit të sektorit privat dhe krijimit të punës kryesisht ka asistuar në krijimin e mikro-ndërmarrjeve të cilat punësojnë njerëz me shkathtësi mesatare dhe bazike (UNDP, 2012). Për më tepër, numri i vogël i ndërmarrjeve me më shumë se 250 punëtorë është një indikator i nivelit të vogël të investimeve kapitale në secilin rajon.

Sa i përket statusit legal, bizneset individuale i dominojnë pesë rajonet ekonomike (Rajoni Qendër – 84 përqind; Rajoni Lindje – 91 përqind; Rajoni Perëndim – 87.5 përqind; Rajoni Jug – 93.5 përqind; Rajoni Veri – 92.5 përqind). Këto biznese pasohen nga ortakëritë, të cilat qëndrojnë në përqindje të ngjashme në të gjitha rajonet (Rajoni Veri – 6 përqind; Rajoni Lindje – 6 përqind; Rajoni Perëndim – 8 përqind; Rajoni Jug – 5 përqind; Rajoni Veri – 6 përqind) dhe ndërmarrjet me përgjegjësi të kufizuara, të cilat kryesisht përbejnë një përqindje shumë të vogël (Rajoni Qendër – 6 përqind; Rajoni Jug – 3 përqind; Rajoni Lindje – 3 përqind; Rajoni Veri – 1 përqind). Se fundi, ndërmarrjet aksionare përbejnë një proporcion jo shumë të rëndësishëm – me pak se 1 përqind në shumicën e rajoneve.

Tabela 1.

Struktura e bizneseve në bazë të madhësisë së tyre sipas rajoneve (në %)

	Mikro-ndërmarrjet (1-9)	Ndërmarrjet e vogla (10-49)	Ndërmarrjet e mesme (50-249)	Ndërmarrjet e mëdha (250+)
Qendër	89.0%	9.8%	0.9%	0.2%
Veri	93.8%	5.8%	0.4%	0.0%
Perëndim	92.9%	6.7%	0.4%	0.1%
Jug	94.0%	5.5%	0.4%	0.0%
Lindje	94.1%	5.5%	0.3%	0.1%

BURIMI: ATK, 2012

FIGURA 1: BIZNESET NË SECILIN RAJON (NË %)

BURIMI: ATK, 2012




Tabela 2.

Shpërndarja e ndërmarrjeve në bazë të periudhave të themelimit (në %)

	Para 1999	2000-2008	2008-2014
Qendër	21.0%	53.5%	25.5%
Veri	22.5%	54.5%	23.0%
Perëndim	25.0%	57.0%	18.0%
Jug	28.0%	48.0%	24.0%
Lindje	26.5%	62.5%	11.0%

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Shumica e bizneseve në funksion janë themeluar në mes të viteve 2000-2008 (Rajoni Qendër – 53.5 përqind; Rajoni Veri – 54.5 përqind; Rajoni Perëndim – 57 përqind; Rajoni Jug – 48 përqind; Rajoni Lindje – 62.5 përqind). Proporcioni i bizneseve të themeluara gjatë periudhave para 1999 dhe pas 2008 qëndron në nivel të njëjtë. Përqindja shtrihet nga 21 në Rajonin Qendër në 28 në Rajonin Jug për periudhën paraprake, dhe nga 11 në Rajonin Perëndim në 25.5 në Rajonin Qendër deri 28 në Rajonin Jug për periudhën e mëvonshme (për informata me të detajuara, shih Tabelën 2).

Ndërmarrjet që veprojnë në Kosovë janë të dominuara nga pronaret meshkuj. Përkatësisht, përreth 91.5 përqind e bizneseve kombëtare janë në pronësi të meshkujve, kurse vetëm 8.5 përqind janë në pronësi të femrave. Rajoni ekonomik me përqindjen më të vogël të ndërmarrjeve me pronësi të femrave është Rajoni Lindje me 4 përqind, kurse rajoni me përqindjen më të madhe është Rajoni Qendër me rreth 12 përqind (për informata më të detajuara, shih Figurën 2). Vendet fqinje qëndrojnë përkrahë kësaj përqindje. Për shembull, në Mal të Zi gratë janë pronare të jo më shumë se 10 përqind të ndërmarrjeve (Federata e Punëtorëve Malazeze, 2013). Për më tepër, shumica mesatare e ndërmarrjeve të femrave është më e vogël në krahasim me ndërmarrjet e meshkujve, pasi që të

parat, mesatarisht, punësojnë rreth 50 përqind me pak punëtorë se sa të dytat.

Mosha mesatare e pronareve të ndërmarrjeve në Kosovë është 43.5 vjeç. Mosha ndërron nga 42.3 vjeç në Rajonin Qendër deri 47.1 vjeç në Rajonin Perëndim. Kjo shtrirje korrespondon, deri në një masë (edhe pse anon më shumë nga vlera më e lartë), me moshën e ndërmarrësve në gjithë botën, ku gjysma shtrihen në mes të moshës 25 dhe 44 vjeçare (GEM, 2012). Për më tepër, sa i përket kualifikimit arsimor të pronareve të ndërmarrjeve, Rajoni Qendër dominon me rreth 42.5 përqind, në krahasim me pronaret e rajoneve të tjera, ku përqindja është rreth 30.

Për qëllim të këtij studimi, është e rëndësishme që të paraqiten burimet e para të të ardhurave për popullsinë në secilin rajon. Sipas ASK (2013), rreth 57 njerëz që jetojnë në Rajonin Qendër marrin ndihma nga persona të tjerë. Në anën tjetër, 23 përqind raportuan se paga ose format tjera të kompensimeve janë burimet kryesore të të ardhurave, me pak se 1 përqind deklaruan se burimi kryesor i të ardhurave për ta është lëshimi me qira i shtëpisë, banesës, tokës, dyqaneve ose investimet pronësore. Përreth 6 përqind e njerëzve në të njëjtin rajon deklaruan se pensioni është burimi kryesor i të ardhurave, 5 përqind marrin asistencë sociale, më pak se 1 përqind marrin forma të tjera të ndihmave, siç është pushimi i shtatzënisë, 3 përqind varen nga të ardhurat nga jashtë si burim kryesor i të ardhurave të tyre dhe 6 përqind deklaruan se ata kanë burime të tjera të të ardhurave (KAS, 2013). Është me rëndësi të ceket se në të pesë rajonet, shumica e të anketuarve treguan se nuk kanë ndonjë burim vetanak të të ardhurave dhe se mbështeten nga anëtarët e familjes me të cilët jetojnë (për informata të detajuara në secilin rajon dhe prezantim numerik të dhënave, shih Tabelën 3).

Për faktin se secili rajon ka karakteristika specifike ekonomike, ishte konsideruar e rëndësishme krijimi i nen-seksionit të radhës dhe prezantimi i karakteristikave korresponduar me secilin rajon.

Tabela 3.


Burimi primar i të ardhurave tek popullsia vendase sipas rajonit (në €)

	Puna	Investimi në pronë	Pensioni	Asistenca sociale	Asistencat tjera	Remitanca	Mbështetja nga të tjerët	Burime tjera
Qendër	114,493	2,259	30,614	24,109	1,363	13,306	283,079	28,684
Veri	39,026	513	16,910	16,449	785	7,464	98,854	12,636
Perëndim	75,655	1,312	21,365	15,885	1,733	19,307	160,556	19,081
Jug	88,599	1,058	21,449	12,954	858	35,926	191,268	35,716
Lindje	72,508	1,188	21,682	15,286	2,363	16,314	188,707	28,511

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS, 2013

FIGURA 2: PRONARËT E BIZNESEVE SIPAS GJINISË (NË %)

BURIMI: KALKULIMET E
AUTORËVE NGA TË DHËNAT E
ANKETËS



Aktiviteti ekonomik i **Rajonit Veri** fokusohet kryesisht në tregti, shumë pak në transport dhe telekomunikacion, hotele dhe restorante, miniera dhe ndërtimtari. Rajoni Jug është i fokusuar në tregti me shumicë dhe pakicë.

Aktiviteti ekonomik i **Rajonit Jugu** është kryesisht i fokusuar në tregti me shumicë dhe pakicë

Aktiviteti ekonomik në **Rajonin Qendër** është fokusuar në tregti, me shumicë dhe pakicë; dhe shërbime, kryesisht restorante dhe institucione financiare.

Aktiviteti ekonomik i **Rajonit Lindje** është kryesisht i fokusuar në tregti, shërbime dhe akomodim.

Shumica e aktivitetit ekonomik në **Rajonin Perëndim** është fokusuar në agrobiznes për shkak të kësteve të favorshme lokale dhe traditës se kahershme.

RAJONI VERI

Rajoni Veri përfshin rreth 20.36 përqind të territorit të Kosovës. Aktiviteti ekonomik kryesisht fokusohet në tregti, dhe shumë pak në transport dhe telekomunikacion, hotele dhe restorante, miniera dhe ndërtimtari. Potencialet e zhvillimit shihen në resurse natyrore, turizëm, agrikulturë, dhe prodhimi i formave alternative të energjisë (AZhR Veri et al., 2010). Disa nga forcat kryesore janë: avantazhi i pozitës gjeografike për zhvillim ekonomik dhe lidhje kontaktesh; disponueshmëria e burimeve natyrore dhe potenciali turistik; kultivimi ekologjik dhe prodhimi agrikulturës i shëndetshëm; fuqia punëtore e lire; dhe potenciali për prodhim në formave alternative të energjisë. Disa nga mangësitë përfshijnë: mungesa e të mirave financiare për projekte të zhvillimit të qëndrueshmërisë; përdorimi i vogël i linjave hekurudhore; sistemi jo efikas i menaxhimit të humbjeve; shërbimi publik joadekuat; rrugët infrastrukturore jo të përshtatshme për ekonominë; zhvillimi jo i mjaftueshëm i NVM-ve dhe mungesa e njohurive dhe eksperiencës në programe të BE-se dhe të donatorëve të tjerë internacional (AZhR Veri et al., 2010).

RAJONI QENDËR

Rajoni Qendër përfshin rreth 20.5 përqind të territorit të Kosovës. Potencialet dhe mundësitë e zhvillimit të këtij rajoni janë parë në industrinë e përpunimit të mineraleve, përpunimit të ushqimit, plastikës dhe letrës, agrobiznes - kryesisht në prodhimin dhe përpunimin e frutave dhe perimeve, prodhimet e qumështit dhe ushqimi i kafshëve dhe në ICT (AZhR Qendër et al., 2010). Shumica e aktivitetit ekonomik është i fokusuar në tregti, atë me shumice dhe pakice; shërbime, kryesisht restorante dhe institucione financiare; dhe shumë pak në prodhimtari (AZhR Qendër et al., 2010). Disa nga forcat kryesore përfshijnë prezencën e resurseve natyrore siç janë linjiti, nikeli, plumbi, zinku dhe hekuri dhe ujërat termale; infrastruktura e bazuar në rrugët kryesore që kalojnë këtë zonë; pozita gjeografike; dhe treg më i madh për shkak të numrit me të madh të popullsisë. Disa nga dobësitë përfshijnë ndotje ajri të jashtëzakonshme; menaxhim mjedisi joadekuat; administratë publike joefikase dhe fuqizimi i dobët i ligjit; dhe papunësi e lartë dhe force punëtore e paafte (AZhR Qendër et al., 2010).

RAJONI PERËNDIM

Rajoni Perëndim përfshinë rreth 21 përqind në territorin e Kosovës. Shumica e aktivitetit ekonomik është e fokusuar në agrobiznes për shkak të kushteve të favorshme lokale dhe traditës së kamotshme. Përveç agrikulturës, mundësitë dhe potencialet e zhvillimit janë parë në sektorin e turizmit për shkak të pozitës gjeografike (AZhR Perëndim et al., 2010). Disa nga forcat kryesore përfshijnë: nivelin e ulët të eksperiencës në qëndrueshmërinë e menaxhimit të resurseve natyrore; degradimin e mjedisit; procesin e ngadalshëm të kooperimit ndërkufitar; dhe menaxhimin joefektiv të përdorimit të tokës (AZhR Perëndim et al., 2010).

RAJONI JUG

Rajoni Jug përfshin rreth 19 përqind të territorit. Aktiviteti ekonomik kryesor është i fokusuar në tregti me shumice dhe pakice, me shumë pak industri përpunimi, hotele dhe restorante, dhe transport. Sektorët me potencial rritje janë turizmi, agrikultura dhe industria e përpunimit të ushqimit, saktësisht vreshtat si dhe të korrat e frutave dhe perimeve kualitative (AZhR Jug et al., 2010). Disa nga forcat kryesore janë: pozicioni favorites; disponueshmëria e burimeve lidhur me mjedisin natyror, duke përfshirë tokës se punueshme dhe ujësjellësi i bollshëm; fuqi punëtore relativisht të aftë për nivele krahasuese; trashëgimi të pasur të monumenteve historike dhe kulturore të regjistruara dhe të mbrojtura; dhe mundësi për zhvillim turizmi. Disa dobësi përfshijnë: jo balancim i dukshëm i strukturës ekonomike dhe pamundësia e transferimit të fuqisë punëtore përgjatë sektorëve; institucionet e qeveris lokale jo komplet të përgatitura të mbështesin aktivitetet e ndërmarrësisë; sistemi hekurudhor jo funksional; përdorimi jo-adekuat i tokave pjellore; dhe nivel i ulët i prodhimit të prodhimeve të agrikulturës dhe përpunimi i ushqimit i pazhvilluar (AZhR Jug et al., 2010).

RAJONI LINDJE

Rajoni Lindje përfshinë rreth 27 përqind të territorit të Kosovës. Aktiviteti ekonomik në këtë rajon është kryesisht i fokusuar në tregti, shërbime, akomodim dhe shumë pak në prodhim (AZhR Lindje et al., 2010). Sektorët me potencial janë zhvillimi rural si në: agrikulturë, pylltari, turizëm dhe miniera (AZhR Lindje et al., 2010). Disa nga forcat kryesore janë: pozita gjeografike e favorshme; ekzistimi i resurseve natyrore siç është uji termal, zbulimi i mineraleve dhe xeheve, barishtet mjekësore dhe frutat e egra; afër Prishtinës dhe Shkupit; lidhjet e forta me Evropën nga diaspora dhe studentët që studiojnë në vendet e BE-së. Disa nga dobësitë përfshijnë: shfrytëzimin e pamjaftueshëm të burimeve natyrore; jo balancimin në baza ekonomike të rajoneve për shkak të nivelit të ulët të bizneseve prodhuese; mungesën e kapaciteteve të përpunimit; mungesën e mjedisit mbështetës të NMV-ve; dhe kualifikimin jo adekuat të fuqisë punëtore për nevojat e tregut (AZhR Lindje et al., 2010).



Të dhënat
thelbësore të
këtij studimi
janë mbledhur
nga një anketë
që përfshinte
1,000 biznese
- 200 biznese
për secilin rajon
ekonomik.



3. METODOLOGJIA

Në këtë seksion, ekipi i Riinvest-it paraqet një përshkrim të përgjithshëm të metodologjisë të përdorur në këtë studim. Në mënyrë që të shqyrtohet klima e bizneset në pesë rajonet ekonomike të Kosovës, ekipi u mbështet kryesisht në anketimin e bizneseve dhe diskutimet e fokus grupeve me hisedarë të ndryshëm rajonal. Duke i kombinuar këto dy teknika, ekipi mbledhi të dhëna kuantitative dhe kualitative.

Të dhënat kryesore janë mbledhur nga anketa që ka përfshirë 1,000 firma – 200 biznese për secilin rajon ekonomik të Kosovës. Bizneset janë nxjerrë nga baza e të dhënave e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), e cila përfshinë gjithsej 65,000 biznese aktive. Baza e të dhënave përmban informata të mjaftueshme për secilin biznes, përfshirë sektorin, madhësinë e biznesit dhe lokacionin – në bazë të së cilave është bërë edhe stratifikimi. Një mostër prej 200 bizneseve për rajon është mjaft e madhe për të ofruar rezultate reprezentative statistikore me 99 përqind nivelit të besueshmërisë.

Procesi i përpilimit të pyetësorit e ka përfshirë ekipin hulumtues të Riinvest-it si dhe ekspertët nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Pyetësi përfshinë tri seksione kryesore, të fokusuara në: (1) relacionet në mes bizneseve dhe institucioneve; (2) performacën dhe barrierat e bizneseve; dhe (3) në pyetjet e tjera relevante me klimën investuese në vend. Para se anketa të lëshohej e tëra në terren, fillimisht ishte testuar me 50 biznese në mënyrë që të shikohej nëse pyetësi kishte ndonjë 'defekt' vizual, ose nëse pyetje të caktuara duhej të modifikoheshin. Për më tepër, ekipi e testoi kohëzgjatjen e anketës, e cila zgjati rreth 20 minuta.

Ekipi i Riinvest-it i ka rekrutuar studentët më të mirë të Kosovës si anketues. Të gjithë iu nënshtruan një trajnimit të nevojshëm që i ka përgatitur ata për mbledhjen e të dhënave, përshkrimin e pyetësorëve dhe për pika tjera të nevojshme. Më saktësisht, anketuesve iu dha nga një manual trajnues për anketim që e përshkruan rëndësinë dhe qëllimet e përgjithshme të anketës. Për më tepër, secila pyetje në pyetësorë i kishte sqarimet e nevojshme. Grupe të vogla prej 2-5 anketues punuan nën mbikëqyrjen e një lideri të grupit. Lideri i grupit i ka vizituar 15 përqind të të anketuarve nga secili anketues, për t'i falënderuar për bashkëpunim. Gjatë këtyre vizitave, pyetje të caktuara që konsideroheshin më të rëndësishme për hulumtimin ishin përsëritur sa për verifikim. Përveç monitorimit në terren, verifikime të ngjashme janë bërë edhe me telefon nga ekipi hulumtues dhe lideri i projektit. Rreth 40 përqind të anketave, të zgjedhura me metodën e rastit, janë verifikuar nga ekipi hulumtues i Institutit Riinvest, të cilët i telefonuan të anketuarit dhe u siguruan që përgjigjet korrespondojnë me ato të dhëna nga anketuesit. Më pas, secili pyetësor është verifikuar nga hulumtuesit që të shikohet nëse ka ndonjë përgjigje jo racionale krahasuar me të dhënat e mbledhura më herët.

Pas mbledhjes, të dhënat janë futur në sistem nga një personel me përvojë, duke e përdorur programin e EXCEL-it. Pastaj, të dhënat janë analizuar dhe përpunuar me SPSS për të identifikuar përgjigjet jashtë vlerave të pritura, përfshirë edhe mospërputhjet në mes vlerave. Janë bërë ndryshimet e duhura, kur është nevojitur. Për më tepër, kontrollimet periodike janë bërë nga lideri i projektit, fillimisht duke i krahasuar mesataret e variabëlve dhe distribuimin e tyre nëpër fajlla, për të siguruar se të dhënat nuk kanë pësuar ndryshime, me apo pa qellim. Analizat hulumtuese në këtë raport janë kryesisht të bazuara në statistika përshkruese duke i përdorur teknikat e kryqëzimit.


Përveç anketimit kuantitativ, Instituti Riinvest i ka realizuar pesë fokus grupe (një për secilin rajon) të përbëra nga 10-12 pjesëmarrës për secilit. Diskutimet e fokus grupeve kanë pasur për synim që: (i) të mbledhin të dhëna kualitative – të cilat normalisht nuk mund të vëzhgohet dhe mbledhet me anketa kuantitative; dhe (ii) t'i marrin perceptimet e hisedarëve të tjerë të biznesit. Takimet e fokus grupeve përfshinin hisedarë të ndryshëm, siç janë drejtorët komunal për zhvillim ekonomik, ekspertët ekonomik lokal, si dhe përfaqësuesit e OJQ-ve, Agjencive për Zhvillim Rajonal (AZhR), Bankave, Qendrave për Mbështetje të Biznesit, dhe prej institucioneve të tjera relevante që merren me çështje ekonomike.

Diskutimet e fokus grupeve janë strukturuar rreth pyetjeve që lidhen me barrierat e të bërit biznes, me relacionet e bizneseve me institucionet, me strategjitë e zhvillimit rajonal dhe me të ardhmen e sektorit ekonomik. Pyetjet u bënë në mënyrë grupore ku pjesëmarrësit ishin të lirë të bashkëbisedojnë. Moderator i qëndroi mbrapa në fillim, duke i dhënë kështu hapësirë një "përgjimi strukturor". Më pastaj, moderatori filloi me një stil më dominues, duke e shtyrë debatin të vazhdojë përtej kornizave që do mund të përfundonte, duke i inkurajuar pjesëmarrësit që t'i diskutojnë kontradiktat në mes tyre dhe mendimeve të vet tyre. Mos-pajtueshmëritë në mes grupit janë përdorur si inkurajim për pjesëmarrësit që t'i qartësojnë më tepër pikëpamjet e tyre. Secili takim është inçizuar, transkriptuar dhe analizuar thellësisht. Kohëzgjatja e secilit fokus grup ishte pothuajse dy orë.



~74%

e bizneseve
i gjenerojnë më
pak se 50,000 €
në vit. Rajoni Jug
dhe Rajoni Lindje
ka më së shumti
biznese të vogla,
përderisa bizneset
e mëdha janë të
koncentruara në
Rajonin Qendër.



4. GJETJET E ANKETËS

Ky seksion i raportit i prezanton dhe analizon të gjeturat e anketës. Saktësisht, seksioni 4.1 shpjegon se si NVM-të kanë performuar në të kaluarën dhe cilat janë pritjet e tyre për të ardhmen. Seksioni 4.2 dhe 4.3 e prezantojnë vlerësimin e përgjithshëm të barrierave në zhvillimin e NVM-ve dhe i analizojnë ato sipas rajoneve. Seksioni 4.4 i prezanton indikatorët e të ardhmes. Seksioni 4.5 i paraqet perspektivat e bizneseve në lidhje me institucionet.

4.1 Performanca e NVM-ve

Performanca e bizneseve kosovare ka qenë jo kënaqshme. E ardhmja, megjithatë, është jo shumë premtuese. Në vazhdim janë prezantuar gjetjet rreth performancës së bizneseve në Kosovë, si dhe nëpër rajone.

Tregu kosovar karakterizohet kryesisht nga bizneset e vogla, nëse si kriter i madhësisë së tyre është vlera e shitjeve të realizuara. Rreth 74 përqind të bizneseve gjenerojnë shitje më pak se 50,000 € në vit. Rajoni Jug dhe Rajoni Lindje janë kryesisht të përbëra nga bizneset e vogla, përderisa bizneset e mëdha janë të koncentruara në Rajonin Qendër, i cili e përfshin edhe kryeqytetin. Rajoni Jug ka numrin më të madhe të bizneseve shumë të vogla, 44 përqind e bizneseve që gjenerojnë më pak se 10,000 € të hyra. Vetëm një përqindje e vogël e bizneseve të Rajonit Jug, 12 përqind, realizojnë shitje me vlerë mbi 100,000 €. Rajoni Lindje

është gjithashtu i përbërë nga bizneset e vogla, ku 90 përqind e tyre gjenerojnë të hyra më pak se 100,000 €.

Rajoni Perëndim, në anën tjetër, është i vetmi rajon me më shumë se gjysmën e bizneseve të shtrira në kategorinë prej 10,000 € deri në 50,000 €. Pothuajse gjysma e bizneseve që realizojnë më shumë se 100,000 € në shitje janë të vendosura në Rajonin Qendër dhe Rajonin

Veri. Më shumë se gjysma e bizneseve që gjenerojnë më shumë se 500,000 € në shitje për vit janë të vendosura në Rajonin Qendër. Arsyeja pse shumica e bizneseve janë të vendosura në Rajonin Qendër dhe Rajonin Veri është eficaenca e pasjes së zyreve qendrore afër kryeqytetit për procedura burokratike dhe procedura të bizneseve. Kjo nuk domethënë se këto biznese operojnë ekskluzivisht në rajonet ku zyret qendrore të tyre janë të vendosura (për rezultate më të detajuara, shih Tabelën 4).

Për arsye të këtij studimi, performanca e bizneseve është vlerësuar në bazë të shitjeve të firmës, marzhës neto të fitimit, numrit të punëtorëve dhe trendit të pagave. Rreth 56 përqind e bizneseve deklaruan se shitjet e tyre ose janë ngritur ose kanë qëndruar të njëjta për katër vitet e fundit. Më shumë se 44 përqind deklaruan se shitjet kanë pësuar rënie.

Megjithatë, ato biznese që kanë shënuar rritje nuk përputhen me intensitet të përqindjes me ato që kanë pësuar rënie në shitje. Rritja mesatare e shitjeve tek bizneset që kanë performuar më mirë ka qenë 18.9 përqind gjatë katër vjetëve të fundit. Rënia mesatare e shitjeve për bizneset që kanë performuar më keq ka qenë 25.43 përqind.



56%

e bizneseve deklaruan se shitjet e tyre ose janë ngritur ose kanë qëndruar të njëjta për katër vitet e fundit. Më shumë se 44 përqind deklaruan se shitjet kanë pësuar rënie.

Tabela 4.

Mesatarja e shitjeve totale sipas rajoneve (në %)

Rajoni	0 - 10,000 €	10,000 - 50,000 €	50,000 - 100,000 €	100,000 - 200,000 €	200,000 - 500,000 €	500,000 - 1,000,000 €	1,000,000 ose më shumë €
Jug	44%	36%	10%	5%	3%	3%	1%
Lindje	35%	44%	11%	4%	2%	2%	3%
Perëndim	24%	51%	13%	9%	2%	1%	1%
Qendër	31%	36%	11%	6%	5%	5%	7%
Veri	31%	39%	10%	10%	8%	2%	1%
Mesatarja shtetërore	33%	41%	11%	6%	4%	2%	2%

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Tabela 5.

Trendët e shitjeve gjatë katër viteve të fundit (në %)

	Jug	Lindje	Perëndim	Qendër	Veri	Totali
Rritja	20.50%	28.00%	15.50%	33.00%	39.70%	27.40%
Përqindja e rritjes	17.66	19.74	22.04	19.68	17.69	19.05
Rënia	45.50%	45.00%	52.50%	44.00%	36.20%	44.60%
Përqindja e rënjes	28.59	30.05	23.6	23.64	20.58	25.44
Pa ndryshime	34.00%	27.00%	32.00%	23.00%	24.10%	28.00%

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Tabela 6.

Trendët e shitjeve për katër vitet e ardhshme (në %)

	Jug	Lindje	Perëndim	Qendër	Veri	Totali
Rritja	33.20%	39.30%	40.40%	46.70%	62.20%	44.40%
Përqindja e rritjes	22.46	22.08	17.83	18.19	21.18	20.33
Rënia	23.30%	33.20%	25.80%	24.40%	12.20%	23.80%
Përqindja e rënjes	22.76	20.19	21.38	19.61	14.67	20.17
Pa ndryshime	43.50%	27.60%	33.80%	28.90%	25.50%	31.80%

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Në lidhje me këtë, Rajoni Veri dhe Rajoni Qendër kanë performuar më së miri, përderisa Rajoni Jug dhe Rajoni Lindje dhe posaçërisht rajoni Perëndim kanë performuar më dobët. Rajoni Jug ka rezultuar me numrin më të madh të bizneseve që kanë raportuar “pa ndryshime” ose shitje të stagnuar (34 përqind), një numër mbi mesatare që kanë përjetuar rënie të shitjeve (45.5 përqind) dhe një numër shumë të vogël të bizneseve më ngritje të shitjeve në katër vitet e fundit (20.5 përqind). Rajoni Perëndim, gjithashtu, ka performuar shumë dobët me një numër shumë të vogël të bizneseve që kanë raportuar rritje të shitjeve (15.5 përqind) dhe të tjerët që kanë raportuar ose rënie ose stagnim të shitjeve (52.5 përqind respektivisht 32 përqind). Megjithatë, për bizneset e Rajonit Perëndim që kanë shënuar rritje të shitjeve, norma e rritjes është më e madhja në Kosovë me rreth 22 përqind. Arsyeja e ngecjes mbrapa të këtyre dy rajoneve nuk është lehtë për t’u artikuluar. Rajoni Qendër dhe Rajoni Veri, ku bizneset e mëdha janë te vendosura, kanë shënuar rritjen më të madhe të shitjeve (33 përqind respektivisht 39.7 përqind). Prapë se prapë, trendi rënës së shitjeve në katër vitet e fundit nuk duket t’i ketë penguar bizneset së shpresuari për të ardhmen. Rreth 44.4 përqind të bizneseve të anketuara besojnë se shitjet do të kenë

ngritje në katër vitet e fundit dhe vetëm 23.8 përqind besojnë se do të kenë rënie. Mirëpo, jo domosdo të gjitha këto rezultate duhet të shihen me pesimizëm, pasi që bizneset të cilat nuk kanë pësuar asnjë ndryshim në shitjet e tyre nuk janë gjithmonë të pakënaqura. Nëse ia kanë dalë të mbeten në biznes kjo do të thotë se akoma janë fitimprurëse. Në këtë mënyrë, numrat mund të interpretohen në dy kategori: bizneset që kanë pasur rritje të shitjeve ose që nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, si dhe bizneset që kanë përjetuar rënie të shitjeve (për rezultate të detajuara, shih Tabelën 5).

Kjo, gjithashtu, domethënë se 76.2 përqind të bizneseve besojnë se ato do të operojnë në të ardhmen me ritëm të njëjtë ose më të lartë se sa që janë tani. Rreth 23 përqind presin rënie të shitjeve, mirëpo kjo nuk duhet injoruar, pasi që domethënë se pothuajse çereku i bizneseve presin rënie. Prapë se prapë, është inkurajues fakti se gjysma e bizneseve presin jo vetëm të mbajnë nivelin e tanishëm të shitjeve, por edhe ta përmirësojnë atë. Duhet të përmendet se Rajoni Veri pritet të performojë më së miri në krahasim me rajonet e tjera në këtë pikë (për rezultate më të detajuara, shih Tabelën 6).




76.2%

të bizneseve besojnë se ato do të operojnë me ritëm të njëjtë ose më të lartë të shitjeve në të ardhmen.

Figura 3.

Trendët e shitjeve të bazuara në madhësinë e bizneseve gjatë katër viteve të kaluara




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Për më tepër, bizneset e vogla duken të jenë më ndikuarat nga performanca e dobët; mund të shihet qartë se përqindja e bizneseve që kanë shënuar ngritje të shitjeve është më e madhe për bizneset më të mëdha. Në anën tjetër, pothuajse gjysma e bizneseve të vogla raportuan se shitjet e tyre kanë rënë, përderisa kjo rënie është progresivisht më e vogël për bizneset më të mëdha, me vetëm 20 përqind të bizneseve të mëdha që përjetuan rënie të shitjeve. Kjo tregon se bizneset e mëdha lulëzojnë përderisa bizneset e vogla ngecin në shitje. Kjo fotografi tregon se aktiviteti i biznesit është më shumë i koncentruar tek një numër i vogël i firmave të mëdha se sa i shpërndarë në shumë biznese të vogla. Rreziku është se kjo e dëmton konkurrencën dhe se në aspekt afatgjatë disa kompani fitojnë përparësi jo-proporcionale në treg. Kjo potencialisht në afatgjatë mund të jetë e dëmshme për bizneset e mëdha dhe të vogla pasi që ekonomia do të vuajë nga mungesa e konkurrencës. Ky rezultat gjithashtu tregon se pse bizneset më të mëdha janë më optimiste për shitjet e së ardhmes. Rezultatet e tregojnë një realcion pozitiv ndërmjet madhësisë së bizneseve dhe parashikimit të shitjeve (shih Figurën 3 dhe 4).

Marzha mesatare e fitimit neto për bizneset e Kosovës për periudhën e tanishme është 22.2 përqind, me rreth 70 përqind të bizneseve që arrijnë një marzhë në mes të 8 dhe 36 përqind. Të gjitha rajonet dolën të jenë të nivelit të njëjtë në raportimin e normës së profitit për bizneset e njëjta me të tyret. Një vlerë më e madhe e fitimit neto është raportuar nga bizneset e Rajonit Perëndim (24.8 përqind). Bizneset më të vogla, pavarësisht faktit se pësuan rënie në shitje gjatë katër vjetëve të fundit dhe faktit që demonstuan më pak optimizëm

Figura 4.

Trendët e shitjeve të bizneseve për katër vitet e ardhshme



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS


për parashikimet e shitjeve, ato e kanë marzhën e fitimit neto më të madhe. Një sqarim i mundshëm për këtë është se ato kanë kosto fikse më të vogla dhe janë më të lehta për t'u mbajtur. Bizneset më të mëdha kanë më shumë kosto fikse, ndonëse janë më adaptuese sa i përket shitjeve, marzha neto e fitimit të tyre është më e vogël. Sigurisht, bizneset e mëdha janë më të fokusuara në ngritjen e kapitalit të tyre se sa vetëm në profitet afatshkurta. (Për rezultate më të detajuara, shih Tabelën 7).

Siç edhe pritej, shumica e shitjeve ndodhë në rajonin ku vetë biznesi vepron. Afër 98 përqind të bizneseve shesin në tërë Kosovën dhe vetëm një përqindje e vogël eksportojnë përtej kufijve të vendit. Është shqetësuese se vetëm një proporcion kaq e vogël e shitjeve vjen nga eksporti. Nuk është për tu habitur kur dihet se sektori i tregtisë dominon në ekonominë kosovare. Shumica e kërkesës vendore është e mbuluar me industrinë e tregtisë e cila importon produkte dhe pjesa e vogël e mbetur me sektorin tonë të vogël të prodhimit (Për rezultate më të detajuara, shih Figurën 5).

Tani për tani, numri mesatar i punëtorëve për biznese në Kosovë është 6.8. Kjo është një rritje e lehtë nga 2009-ta, kur mesatarja ishte 5.8. Rajoni Qendër ka një mesatare jo-proporcionale më të madhe, me përparësinë e të pasurit biznese më të mëdha të vendosura atje, posaçërisht në kryeqytet dhe në vendet fqinje. Një ngritje e mesatares së numrit të punëtorëve nuk nënkupton që papunësia ka rënë. Kjo thjeshtë domethënë se kompanitë që kanë vepruar në katër vitet e fundit kanë rritur stafin e tyre; kjo nuk ofron asnjë informata lidhur me bizneset që nuk arritën të mbijetojnë. Nëse pritjet e menaxherit

Tabela 7.

Marzha neto e fitimit sipas madhësisë së firmës (në %)



janë indikator, kjo mesatare do rritet për 2 në 8.7 punëtorë në katër vitet e ardhshme – rritje e dyfishtë krahasuar me atë të para katër vjetëve. Prandaj, Rajoni Qendër veçohet për mesataren shtetërore prej 10.27 punëtorë për firmë në 2009-ën, 10.27 në 2013-ën, dhe 11.20 në 2017-ën (për rezultate më të detajuara, shih Tabelën 8).

Pagat janë një tregues jo vetëm i ofertës së punëtorëve, por edhe mundësisë dhe vullnetit të kompanive që t'i paguajnë punëtorët e tyre denjësisht. Paga mesatare që punëdhënësit paguajnë është 228.3€ (Mediana: 200) me një devijim standard të vogël. Paga mesatare për sektorin private ndryshon shumë pak nga e fundit (2012) e pagës mesatare të sektorit publik e cila është 372€. Jo-ngjashmëria në mes të sektorit privat dhe atij publik, e nxituri kryesisht nga ngritjet e fundit të pagave gjatë periudhës zgjedhore, mund të ndikojë në shtytjen e punëtorëve për të gjetur punë në sektorin privat.

Paga mesatare rritet me madhësinë e firmës. Kompanitë e vogla me pak punëtorë janë zakonisht të menaxhuara në mënyrë individuale ose janë ortakëri, përderisa firmat e mëdha punësojnë menaxherë të cilët ngritin mesataren e pagës (për rezultate më të detajuara, shih Figurën 6).

Shumica e bizneseve, 52 përqind, pohuan se nuk ka pasur ndonjë ndryshim në nivelin e pagave në katër vitet e fundit. Shumë pak prej tyre, 12 përqind, i kanë ulur pagat e punëtorëve dhe më shumë se një e treta, 35 përqind, i kanë ngritur pagat e punëtorëve në katër vitet e fundit. Bizneset të cilat ishin të shtyra t'i ulin pagat, në mesatare, e zbriten pothuajse një të tretën e pagës së punëtorëve të tyre, rreth 24 përqind. Për bizneset që në mënyrë progresive i ngritën pagat, mesatarja e ngritjes ishte 17 përqind. Bizneset e Rajonit Qendër dhe

Tabela 8.

Numri mesatar i punëtorëve

	2009	2013	2017 (parashikim)
Jug	5.55	6.54	7.93
Lindje	6.04	6.86	9.61
Perëndim	4.17	4.83	6.82
Qendër	9.19	10.27	11.29
Veri	4.27	5.36	7.77
Mesatarja shtetërore	5.82	6.78	8.72

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS


Rajonit Veri i bënë ngritjet më të larta, si në numrin e bizneseve që ngritën pagat e tyre, ashtu edhe në përqindje (për rezultate të detajuara, shih Tabelën 9).

Bizneseve, gjithashtu, iu ishte kërkuar që t'i parashikojnë trendet e së ardhmes. Përreth 46.7 përqind të bizneseve deklaruan se do t'i mbajnë pagat në nivel të njëjtë për katër vitet e ardhshme; përderisa 44.50 përqind deklaruan se pagat do të ngritën për 18 përqind. Saktësisht, 9 përqind e bizneseve të anketuara besojnë se do të jenë të detyruara të ulin pagat në katër vitet e ardhshme për 20 përqind. Rajoni Qendër duket të jetë rajoni me përqindjen më të madhe të bizneseve që presin t'i ulin pagat (për rezultate të detajuara, shih Tabelën 10).

Figura 5.

Destinacioni i shitjeve sipas rajonit (në %)

	Brenda komunës	Në rajone tjera të Kosovës	Eksport
Jug	89.9%	8.2%	1.9%
Lindje	84.8%	12.3%	2.4%
Perëndim	90.0%	8.5%	1.0%
Qendër	81.0%	16.2%	2.3%
Veri	91.1%	7.9%	1.1%
Mesatarja shtetërore	87.4%	10.6%	1.7%




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 6.

Paga mesatare sipas madhësisë së firmës (në €)

**Pagat mesatare
(Devijimi standard)**

Jug	224.4 (63)
Lindje	228.9 (63)
Perëndim	227.1 (73)
Qendër	252.1 (85)
Veri	208.8 (52)
Mesatarja	228.3 (70)

Pagat mesatare, sipas madhësisë së firmës

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS



Paga mesatare mujore që
punëdhënësit e biznesit
paguajnë është

€228.3



Marzha neto e fitimit
për bizneset kosovare
në periudhën e
tanishme është

22.2%

52%

e bizneseve raportuan
se nuk ka pasur
ndonjë ndryshim në
nivelin e pagave në
katër vitet e fundit.

Tabela 9.

Trendi i pagave gjatë katër viteve të fundit (në %)

	Jug	Lindje	Perëndim	Qendër	Veri	Mesatarja Shtetërore
Rritja	33.00%	33.00%	23.00%	43.00%	41.21%	34.63%
Përqindja e rritjes	16.97	17.1	14.02	19.71	15.47	16.89
Rënia	10.00%	12.50%	18.00%	15.00%	9.05%	12.91%
Përqindja e rënjes	24.72	25	24.41	24.29	21.88	24.19
Pa ndryshime	57.00%	54.50%	59.00%	42.00%	49.75%	52.45%

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Tabela 10.

Parashikimi i pagave për katër vitet e ardhshme (në %)

	Jug	Lindje	Perëndim	Qendër	Veri	Mesatarja Shtetërore
Rritja	29.00%	47.50%	47.50%	50.50%	48.00%	44.50%
Përqindja e rritjes	17.14	21.61	18.37	18.02	15.82	18.28
Rënia	8.00%	9.50%	8.50%	13.50%	4.50%	8.80%
Përqindja e rënjes	20.42	16.79	21.79	22.2	16.67	20.14
Pa ndryshime	63.00%	43.00%	44.00%	36.00%	47.50%	46.70%

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

4.2 Lista e përgjithshme e barrierave në të bërit biznes

Një prej qëllimeve kryesore të këtij studimi është që të kuptohen barrierat me të cilat bizneset në Kosovë ballafaqohen. Në mënyrë që ky synim të arrihej, anketa me 1000 përfaqësues të bizneseve nëpër Kosovë ka provuar ta testojë seriozitetin e 23 barrierave potenciale për nisje dhe zhvillim të biznesit në të kaluarën (2009), të tashmen (2013) dhe të ardhmen (2017). Prej bizneseve kosovare është kërkuar që ta vlerësojnë çdo pengesë në terme të intensitetit. Pikët për çdo pengesë, mund të ndryshojnë nga një minimum prej 20 pikësh deri tek një maksimum prej 100 pikësh, ku pikët më të lartë shfaqin nivel më të lartë të ndikimit negativ në biznese.⁴ Përkufizime të detajuara për secilën barrierë janë dhënë në Aneksin A1.

Rezultatet e përgjithshme të anketës tregojnë që *'kostoja e lartë e financimit'* i prin listës së barrierave të perceptuara në 2009-ën me 84.2 pikë, përcjellë nga *'korrupsioni'* (82), *'mungesa e subven-*

cioneve shtetërore' (82.3), *'konkurrenca jo-fer'* (80.2) dhe *'sistemi gjyqësorë jo-funksional'* (77.8). Gjetjet po ashtu tregojnë se këto pesë barrierat e udhëheqin listën e barrierave të perceptuara në periudhën e tashme serish, ndonëse me pikë lehtësisht më të ulëta të intensitetit (rreth 1 pikë diferencë në mesatare).

Rezultatet e gjeneruara për të ardhmen e pengesave të perceptuara tregojnë se radhitja e pesë top barrierave është perceptuar të mbetet e pandryshuar; megjithatë, rezultatet tregojnë se intensiteti i tyre pritet të ulet. Për të qenë më specifik, *'kostoja e lartë e financimit'* pritet t'i pranojë 72 pikë; *'korrupsioni'* – 71.7; *'mungesa e subvencioneve shtetërore'* – 70.1; *'konkurrenca jo-fer'* – 68.9; *'sistemi gjyqësor jo-funksional'* – 67.9. Tabela 11 e paraqet radhitjen së bashku me pikët e intensitetit për barrierat tjera për të tri periudhat. Radhitja e barrierave sipas rajoneve ekonomike është shfaqur në Aneksin A2 – A6.

Një e veçantë e renditjes së përgjithshme është se – përgjatë katër vjetëve – barrierat si *'mungesa e energjisë elektrike'* dhe *'infrastruktura jo-adekuate e transportit'* janë përmirësuar më së shumti. E para ka shënuar 70 pikë në 2009-ën, ndërsa 42.8 pikë në 2013-ën; barrierat e dyte ka shënuar 53.5 pikë në 2009-të, ndërsa 44.5 në 2013-ën. Përmirësimi i theksuar i këtyre barrierave duhet t'i atribuohet një sërë politikash qeveritare në dy mandatet e kaluara, të cilat e kanë pasur cak infrastrukturën dhe sektorin energjetik në Kosovë. Paragrafët në vazhdim i grupojnë barrierat për nga natyra, i sjellin rezultatet e tyre dhe njëkohësisht i analizojnë për nga ashpërsia e tyre.

4 Për çdo barrierë, renditja e dhënë nga çdo ndërmarrje (prej 1-5) shumëzohet me një pesë të barabartë me renditjen (gjithashtu 1-5), p.sh., barrierat më serioze marrin pesë më të madhe. Mesatarja e pon-deruar pastaj pjesëtohet me 5 (renditjen maksimale) dhe shumëzohet me 100 në mënyrë që rezultati të kthehet në përqindje e cila tregon se sa afër renditjes maksimale gjendet renditja mesatare. Thënë ndryshe, rezultati është kalkuluar si në vijim: $s = (w_i x_i / n) * 100 / 5$, ku $w_i = x_i$; s është rezultati i intensitetit për çdo barrierë, w është pesha, x është renditja e dhënë nga çdo respondent dhe $i = 1, 2, \dots, n$ përfaqëson secilin respondent

TABELA 11: RENDITJA E BARRIERAVE NË TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË (SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE
NGA TË DHËNAT E ANKETËS

	Tani	Para 4 vjetëve	Pas 4 vjetëve
#01 Kostoja e lartë e financimit	83.7	84.2	71.2
#02 Korrupsioni	81.2	82.0	71.7
#03 Mungesa e subvencioneve shtetërore	81.1	82.3	70.1
#04 Konkurrenca jo-fer	80.1	80.2	68.9
#05 Sistemi gjyqësor jo-funksional	76.2	77.8	67.9
#06 Taksat e larta	74.8	76.3	64.6
#07 Krimi i rrugës, vjedhja dhe mungesa e rregullit	71.0	72.7	63.4
#08 Problemet që lidhen me parkimin	69.8	70.8	62.8
#09 Tregu i vogël	68.8	67.8	60.1
#10 Qasja e kufizuar në financa	65.7	67.5	55.1
#11 Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare	64.4	65.9	55.7

	Tani	Para 4 vjetëve	Pas 4 vjetëve
#12 Qasja e kufizuar në tokë	61.9	63.5	55.7
#13 Vështirësitë në mbledhjen e borxhit	60.3	61.1	51.3
#14 Mungesa e motivit tek punëtorët	54.2	53.9	47.0
#15 Administrata tatimore jo-eficiente	52.2	54.6	47.0
#16 Ligji i pafavorshëm i punës	52.2	53.4	45.9
#17 Mungesa e punëtorëve të arsimuar dhe të shkathët	47.7	51.6	40.6
#18 Shkelja e kontratave nga klientët dhe furnizuesit	47.4	49.2	41.3
#19 Licencimi jo-efiçent i bizneseve dhe procedurat e lejes	47.2	50.9	42.3
#20 Infrastruktura jo-adekuate e transportit	44.5	53.5	38.5
#21 Zhvatja	44.1	44.9	40.1
#22 Mungesa e energji së elektrike	42.8	70.0	36.6
#23 Telekomunikacioni jo-adekuat	35.9	45.2	32.1

4.3 Analizë e detajuar e barrierave zhvillimore të NVM-ve

Ky paragraf krahason dhe analizon barrierat e vlerësuara, të cilat janë të ndara në tetë grupe: (a) barrierat financiare, *'kostoja e lartë e financimit', 'qasja e kufizuar në financa'* dhe *'vështirësitë në mbledhjen e borxheve'*; (b) barrierat e ndërlidhura me informalitet, *'korrupsioni', 'konkurrenca jo-fer'* dhe *'zhvatja'*; (c) barrierat fiskale, *'taksat e larta', 'administrata tatimore jo-eficiente'* dhe *'tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare'*; (d) barrierat ligjore, *'mos funksionimi i sistemit gjyqësor', 'shkeljet e kontratave nga konsumatorët dhe furnizuesit'* dhe *'ligji jo i favorshëm i punës'*; (e) barrierat institucionale, *'licencimi jo-eficient për bizneset dhe procedurat e dhënies'* dhe *'mungesa e subvencioneve shtetërore'*; (f) barrierat e ndërlidhura me fuqinë punëtore, *'mungesa e punëtorëve të shkolluar dhe të aftë'* dhe *'mungesa e motivit tek punëtorët'*; (g) barrierat infrastrukturore, *'telekomunikacioni jo-adekuat', 'infrastruktura jo-adekuate transportit'* dhe *'mungesa e energjisë elektrike'*; dhe (h) barrierat tjera, *'tregu i vogël', 'qasja e kufizuar në tokë'* dhe *'krimi rrugor, vjedhja, dhe mungesa e rregullit'*.

a) Barrierat financiare

Barrierat financiare janë perceptuar të jenë ndër çështjet më shqetësuese për bizneset. Siç është deklaruar më parë, *'kostoja e lartë e financimit'* ka dalë të jetë barriera më problematike në listën e barrierave, më së shumti për shkak të normave të larta të interesit të aplikuara nga institucionet financiare. Kjo barrierë mendohet të ketë qenë më shumë e theksuar në Rajonin Jug dhe Lindje. Dy barrierat tjera, *'qasja e kufizuar në financa'* dhe *'vështirësitë në mbledhjen e borxheve'* bien diku në mes të listës. Sa i përket *'qasjes së kufizuar në financa'*, nuk janë gjetur dallime të mëdha nëpër rajone, përderisa kur vjen puna tek *'vështirësitë në mbledhjen e borxheve'*, Rajoni Veri duket se vuan më së shumti. Ja vlen të përmendet që pavarësisht faktit që nuk janë perceptuar që të përmirësohen gjatë katër vjetëve të fundit, bizneset presin që të tri barrierat të jenë më pak sfiduese në vitet e ardhshme.

Rezultatet e anketës sugjerojnë që *'kostoja e lartë e financimit'* është perceptuar të jetë barriera shumë serioze për krijimin dhe zhvillimin e NVM-ve në 2009-ën. Në këtë periudhë intensiteti për këtë barrierë del të jetë 84.2. Rezultatet po ashtu tregojnë që kjo barrierë ende qëndron në një nivel të përafërt intensiteti në 2013-ën, edhe pse me një rënie të lehtë pikësh për 0.5 (83.7). Duket që normat e larta të interesit, rreth 13 përqind në mesatare, kanë kufizuar bizneset kosovare duke mos u ofruar mundësinë që të zgjerojnë aktivitetin e tyre biznesor, të gjenerojnë vende të reja të punës dhe të zvogëlojnë përqindjen e lartë të papunësisë dhe nivelin e varfërisë. Thënë ndryshe, duket se kjo pengesë ka ndikuar negativisht në kapacitetet e kompanive

kosovare për të investuar në kapitalin e punes dhe asetet fikse — dy faktorë vendimtar për zhvillimin e tyre. Arsyeja pse normat e interesit mbesin të larta në Kosovë është pjesërisht për shkak të sistemit të ndjeshëm gjyqësor, mungesës së konkurrencës në sektorin bankar dhe problemeve me kadastra.

Kur janë pyetur për ndikueshmerinë për këtë barrierë në të ardhmen (2017-ën), bizneset e anketuara duken të jenë shumë më optimiste. Sipas përgjigjeve të tyre, intensiteti pritjet të bie rreth 12.6 pikë. Kjo qasje pozitive ndaj kësaj pengese në të ardhmen, mund t'i atribuohet pjesërisht skemës garantuese — e cila do të fillojë së shpejti nga Qeveria e Kosovës. Kjo skemë, ka për qëllim të kompensojë institucionet financiare nga risku potencial që mund të vjen prej huamarrësve me histori të dobët kredituese ose me kolateral të pamjaftueshëm. Marrë parasysh këtë, normat e interesit sipas të gjitha gjasave do të ulen, duke shpjeguar kështu pritjet optimiste për të ardhmen të bizneseve të intervistuar. Po ashtu, kjo mund të shpjegohet nga pritjet e përgjithshme të bizneseve për të ardhmen, sipas të cilave mjedisi i biznesit do të ketë rrezikshmëri më të vogël dhe si rezultat i kësaj normat e interesit do të ulen.

Përveç Rajonit Qendër, i cili ka rezultuar në vlera dukshëm më të ulëta të intensitetit për këtë barrierë, krahasuar me mesataren e Kosovës në 2009-ën, rajonet tjera të shtetit kanë pranuar pikë të intensitetit që nuk dallojnë shumë nga mesatarja e përgjithshme. Për të qenë më specifik, në mesin e rajoneve që janë më afër mesatares shtetërore, Rajoni Jug duket të qëndrojë më së "keqi" me intensitet 90.9, i ndjekur nga Rajoni Lindje (89.2), Rajoni Perëndim (89.2) dhe Rajoni Veri (82.2). Në anën tjetër, Rajoni Qendër, siç u tha, është perceptuar të qëndrojë dukshëm më mirë, në krahasim me rajonet tjera ekonomike, pasi që mori 78 pikë të intensitetit. Devijimi i madh i intensitetit prej mesatares shtetërore i Rajonit Qendër lidhet me numrin më të madh të kompanive të mëdha që operojnë në këtë rajon, më së shumti në Prishtinë, ndaj të cilave institucionet financiare aplikojnë norma interesi më të përbalueshme. Megjithatë, është jetike për bizneset e vogla, gjithashtu, që të kenë qasje në kredi me norma më të ulëta të interesit, pasi që këto biznese, duke qenë fleksibile dhe inovative, shihen si kontribuuese të mëdha në zhvillimin e sektorit privat.



"Kostoja e lartë e financimit" është perceptuar të jetë barriera shumë serioze për krijimin dhe zhvillimin e NVM-ve në Kosovë.


Nëse shikojmë të dhënat për rajone ndaras, shohim se bizneset ndajnë perceptime pakës më të mira për periudhën e tanishme (2013). Përsëri radhitja e rajoneve është e njëjte, duke filluar nga Rajoni Jug si më i keqi për nga intensiteti (90.6) dhe duke përfunduar me Rajonin Qendror si më i miri (76.4). Është interesante që përqindja e ndryshimit në perceptimin e *'kostos së lartë të financimit'* është pak a shumë e njëjtë me ndryshimin e normave mesatare të interesit për kreditë në Kosovë, duke treguar që

bizneset në Kosovës janë shumë të vetëdijshme për ndryshimet që ndodhin në sektorin bankar, sidomos kur bëhet fjalë për norma të interesit.

Në 2017-ën, duke përjashtuar Rajonin Jug, *'kostoja e lartë e financimit'* është projektuar që të jetë më pak e rëndë për katër rajonet tjera

Figura 07.

'Kostoja e lartë e financimit' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

ekonomike. Të dhënat tregojnë që diferenca mes rezultateve të tashme dhe rezultateve të pritura në Rajonin Jug është vetëm 4.4 pikë intensiteti. Me fjalë tjera intensiteti pritet të bie nga 90.6 në 86.2 pikë. Në anën tjetër, rënia për katër rajonet tjera ndryshon prej 12.3 pikëve të intensitetit në Rajonin Qendër deri në 18.5 pikë të intensitetit në Rajonin Lindje. Prej këtyre katër rajoneve, për këtë periudhë gjithashtu, Rajoni Qendër prin për të mirë me 64.1 pikë, i ndjekur nga Lindja (70.3), Veriu (70.6) dhe Perëndimi (72.4) (për paraqitje vizuale, shih Figurën 7).


Edhe pse në përgjithësi problematike, krahasuar me *'koston e lartë të financimit'*. *'qasja e kufizuar në financa'* është perceptuar të jetë çështje më pak shqetësuese, sidomos në dy periudhat e para. Për të qenë më specifik, të dhënat e mbledhura gjatë anketimit, tregojnë që gjatë periudhës së kaluar dhe të tashme, kjo barrierë morri 67.5 pikë respektivisht 65.2 pikë. Këto pikë tregojnë se është një pjesë e madhe e bizneseve që kanë aplikuar për kredi, por janë refuzuar, si dhe një përqindje e lartë e tyre nuk ka aplikuar, për shkak të frikës nga një refuzim i mundshëm. Arsyeja pse institucionet financiare janë restriktive ndaj bizneseve, është e lidhur pjesërisht me mos-aftësinë e bizneseve për të siguruar kolateral, i cili lehtësisht do të shndërrohej në kesh. Pikët e intensitetit për këtë barrierë, priten të bien në 55.1 në 2007-ën. Treni deri diku pozitiv i kësaj barrierë mund t'i atribuohet përsëri skemës së garancioneve të lartë-përmendur, e cila siç duket do t'i bëjë kreditorët më tolerant kur vjen puna tek kriteret e tyre të kredive.

Kur rezultatet e dala krahasohen në pesë rajonet ekonomike, duket që për periudhën e 2009-ës, Rajoni Qendër dhe Veri bien nën mesataren shtetërore me 62.4 pikë, përkatësisht 65.2 pikë të intensitetit; përderisa Rajoni Jug, Perëndim dhe Lindje janë të pozicionuara mbi mesatare me 69, 71.5 dhe 72.8 pikë të intensitetit. Rezultatet për periudhën e tashme tregojnë që kjo barrierë është zvogëluar për Rajonin Qendër (61.9), Rajonin Perëndim (68.2) dhe Rajonin Lindje (70.7) në njërën anë, dhe mjaft ndjeshëm për Rajonin Veri (54.4) në anën tjetër. Është interesante se Rajoni Jug tregon ngritje në perceptimin e intensitetit për 1.9 pikë, krahasuar me periudhën e kaluar. Ky trend i kundërt, mund t'i atribuohet ndonjë gabimi të mundshëm statistikor, duke e marrë parasysh diferencën marginale.

Katër vite prej sot, të dhënat tregojnë se *'qasja e kufizuar në financa'* pritet të përmirësohet (të ketë rënie të intensitetit) në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha rajonet ekonomike, përveç Rajonit Jug. Rajoni Jug është vlerësuar me pikët më larta të intensitetit, 65.1 pikë, krahasuar me Rajonin Lindje me 56.7 pikë, Rajonin Perëndim me 55.9 pikë, Rajonin Qendër me 51.8 pikë dhe Rajoni Veri me 48.2 pikë (për paraqitje vizuale, shih Figurën 8). Një shpjegim potencial për intensitetin e lartë në Rajonin Jug mund të jetë i lidhur me mashtrimet e disa konsumatorëve të cilët po ndodhin kohëve të fundit në këtë rajon – në fakt kjo i bën institucionet financiare që të jenë më kushtëzuese në raport me huamarrësit.

Figura 08.


‘Qasja e kufizuar në financa’
sipas rajoneve
(në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 09.

‘Vështirësitë në mbledhjen e
borxhit’ sipas rajoneve
(në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

‘Vështirësitë në mbledhjen e borxhit’ duket të jetë më pak sfiduese për bizneset kosovare, pavarësisht periudhës. Më saktësisht, të dhënat për vitin 2009, sugjerojnë që bizneset e intervistuar e vlerësojnë këtë pengesë në mënyrë të moderuar, duke e vlerësuar me notën 60.3. Katër vite prej sot efekti i *‘vështirësisë në mbledhjen e borxheve’* në zhvillimin e NVM-ve, sipas bizneseve të anketuara, pritet të jetë më pak sinjifikant, meqë intensiteti pritet që të bie në 51.3 pikë. Nëse kjo pengesë do të jetë e intensitetit më të ulët, siç parashikojnë bizneset në anketë, NVM-të do të kenë më shumë para në dispozicionin e tyre, para të cilat do të mund t’i ndanin për investime në teknologji të reja dhe për implementimin e ideve inovative, të cilat si rezultat do ta përmirësonin performancën e përgjithshme të NVM-ve. Me fjalë tjera, duke u siguruar që rrjedha e keshit do të jetë e parashikueshme, kompanitë sipas të gjitha gjasave do të rrisin aktivitetet e tyre biznesor dhe do të jenë shumë më dinamike në gjenerimin e shitjeve të reja.

Kur kjo barrierë shqyrtohet përgjatë pesë rajoneve ekonomike, del se bizneset e Rajonit Veri janë përballur me më shumë vështirësi gjatë mbledhjes së borxheve, krahas katër rajoneve tjera ekonomike. Intensiteti i kësaj pengese në këtë rajon është menduar të jetë rreth 13 herë më i lartë se sa mesatarja shtetërore (61.1) në 2009-tën. Diferenca rritet edhe më shumë në 2013-ën dhe 2017-ën, 16 respektivisht 17 përqind më e lartë se mesatarja shtetërore. Mungesa e një sistemi funksional juridik dhe gjyqësor, si pasojë e tensioneve ndëretnike, mund të jetë arsyeja se pse bizneset e këtij rajoni hasin në vështirësi më të mëdha gjatë grumbullimit të borxheve të tyre. Pësia e kësaj barrierë në rajonet tjera ekonomike nuk devijon shumë prej mesatares shtetërore. Rajoni Jug duket të ketë intensitetin më të ulët (57.4 pikë në 2009-ën; 54.7 në 2013-ën; dhe 51.4 në 2017-ën), përderisa Rajoni Qendër më të lartin, pas Rajonit Veri (58.9 në 2009-tën; 59.7 në 2013-tën; dhe 50.8 në 2017-tën) (për reprezentim vizual, shih Figurën 9).

Trendi i intensitetit në rënie tek kjo barrierë është më së shumti i lidhur me themelimin e Tribunalin Permanent të Arbitrazhit të Kosovës – i cili shërben si mjet alternativ/jo-burokratik për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve biznesore, duke përfshirë mosmarrëveshjet rreth borxheve biznesore. Po ashtu, mund të jetë e ndërlidhur me faktin që Ministria e Drejtësisë i ka lëshuar 15 licenca për përmbauesit privat, roli i të cilëve është që t’i ndihmojnë gjykatat kosovare që t’i zgjidhin mosmarrëveshjet biznesore.

b) Barrierat që lidhen me informalitetin

Barrierat që lidhen me informalitetin dolën të jenë në mesin e barrierave më serioze me të cilat ballafaqohen bizneset e anketuara. Nga tri barrierat e këtij grupi, *‘korrupsioni’* dhe *‘konkurrenca jo-fer’* janë

renditur në top pesë barrierat më të ashpra. Ndikimi negativ i lartë në të bërit biznes ka mbetur pothuajse i pandryshuar në krahasim me vitin 2009. Situata duket të jetë pothuajse e njëjtë në të gjitha rajonet ekonomike. Që të dyja janë mjaft të dëmshme për bizneset meqë ndikojnë negativisht në kostot operative, rrisin rrezikun dhe e pengojnë konkurrencën e shëndetshme të tregut. Gjatë katër vjetëve të ardhshme, këto dy barrierat priten të ulen, ndonëse jo në nivelin që do mund të konsideroheshin të padëmshme për bizneset. Në anën tjetër, përkundër perceptimit të njerëzve se zhvatja është një fenomen shumë i përhapur në Kosovë, bizneset në përgjithësi e konsiderojnë atë si çështje si jo shumë problematike për asnjërën periudhë. Megjithatë, për dallim nga bizneset e rajoneve të tjera, bizneset e Rajonit Perëndim duket të jenë sfiduar shumë më shpesh nga kjo praktikë joformale.

Prej barrierave joformale, *‘korrupsioni’* është konsideruar si barrierë më e ashprë në katër vitet e fundit. Rezultatet e anketës tregojnë se kësaj pengese i është dhënë një intensitet prej 82 pikësh për periudhën e 2009-ës. Bizneset e intervistuar konsideruan se kjo barrierë

nuk ka shënuar përmirësim, pasi që është ulur për vetëm 0.8 pikë në periudhën e tanishme. E ardhmja duket të jetë shpresëdhënëse në këtë çështje. Më saktësisht, përgjigjet e bizneseve sugjerojnë se ndikimi i *‘korrupsionit’* në NMV në 2017-ën do të jetë më i ulët krahasuar me periudhën e tanishme për rreth 13 përqind. Udhëheqja e një firme është kryesisht aktivitet i sektorit privat i orientuar drejt ofertuesëve dhe konsumatorëve, por aktivitetet tregtare gjithashtu kërkojnë interakcion të shpeshtë edhe me zyrtarët publik për çështje të ndryshme, siç janë: doganimi i mallit, lejet e ndërtimit, taksat dhe inspektorati për punë etj. Të dhënat e lartpërmendura tregojnë se gjatë katër vjetëve të fundit,


bizneset janë ballafaquar me zyrtarë publik të korruptuar dhe/ose rregullore joefikase që e kanë bërë ryshfetin si akt të pashmangshëm për të kryer punë. Me fjalë të tjera, këto të dhëna implikojnë se bizneset duhet të ndajnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve të tyre për t’i paguar “privatisht” zyrtarët në mënyrë që të sigurojnë shërbimet e tyre. Këto ryshfete mund të konsiderohen ‘taksa jo formale’ të shtuara tek bizneset, dhe rrjedhimisht një barrë e shtuar që e pengon rritjen e tyre. Është e rëndësishme të përmendet se korrupsioni vlerësohet si një fenomen shumë i përhapur nga çdo burim i besueshëm, jo vetëm nga ato burime që merren me perceptime të bizneseve. Për shembull, në 2013-ën Kosova shënoi 33 pikë në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (CPI) (0 – më e korruptuara; 100 – më e pa korruptuara) dhe ishte renditur e 111-ta nga 177 vende të përfshira nga Transparency International – që do të thotë se qëndron me keq se sa Maqedonia, e cila radhitet e 67-ta, Mali i Zi (gjithashtu i 67-ti), dhe Serbia (e 72-ta).

Analiza e pesë rajoneve ekonomike lidhur me *‘korrupsionin’*, tregon se Rajoni Perëndim dhe Jug e kanë marrë intensitetin më të lartë gjatë katër vjetëve të fundit, në krahasim me rajonet e tjera ekonomike. Kjo pengesë mori një intensitet prej 92.4 pikëve për periudhën e 2009-ës në Rajonin Perëndim dhe 86.9 pikë intensiteti në Rajonin Jug. Këto intensitete tregojnë se *‘korrupsioni’* në këto dy rajone është më i përha-


‘Korrupsioni’ dhe ‘konkurrenca jo-fer’ janë renditur në mesin e top pesë barrierave shqetësuese për bizneset

Figura 10.

'Korrupsioni' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

pur në krahasim me tri rajonet tjera. Në anën tjetër, nga tri rajonet tjera, bizneset e Rajonit Qendër duken të kenë qenë më pak të konfrontuara nga 'korrupsioni' në 2009-ën, pasi që kjo pengesë shënoi 75.8 pikë. Dy rajonet e tjera qëndrojnë në mes: Rajoni Lindje merr 83 pikë dhe Rajonin Verior 77.7 pikë. Intensiteti i 'korrupsionit' pëson rënie në 2013-ën, por ulja është pothuajse e neglizhueshme (rreth 1 pikë intensiteti për secilin rajon), duke treguar kështu se bizneset janë akoma duke u ballafaquar me këtë barrierë.

Në katër vitet e ardhshme, intensiteti parashihet të ketë rënie, në krahasim me periudhat e mëparshme, ndonëse me një normë të ngadalshme (Rajoni Qendër – 64.2; Rajoni Veri – 68.6; Rajoni Lindje – 71.4; dhe Rajoni Perëndim – 77.4). Vetëm Rajoni Jug bën përjashtim në këtë rast, për shkak se bizneset e intervistuar presin që intensiteti të mos ndryshojë shumë nga periudha e tanishme (84.2 pikë intensiteti) (për paraqitje vizuale, shih figurën 10). Këto të pritura kryesisht pozitive mund t'iu atribuohen zgjedhjeve lokale të mbajtura në fund të 2013-ës, ku politikanët të rinj kanë ardhur në pushtet, kryesisht të perceptuar si më pak të korruptuar dhe me të gatshëm ta luftojnë korrupsionin. Për më tepër, pritjet pozitive mund të jenë nga fakti se Kosova së fundi ka forcuar kornizat legjislative të saja, ka nisur hetimet, si dhe ka shtrënguar bashkëpunimin e saj me EULEX-in (Raporti i Progresit, 2013) – secila nga këto të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit.




Për dallim nga bizneset e rajoneve të tjera, bizneset e Rajonit Perëndim duket të jenë më se shumti të konfrontuara me zhvatjen.

'Konkurrenca jo-fer', e shkaktuar nga evazioni fiskal dhe praktikat tjera jo formale, është shumë e dëmshme për zhvillimin e sektorit privat. E njëjta krijon ambient që i pengon firmat e reja, legale, dhe inovative të rriten dhe të krijojnë vende të reja pune në treg. Për më tepër, kjo dërgon sinjale shqetësuese tek investitorët e huaj, duke i dekurajuar ata për të investuar në Kosovë. Fatkeqësisht, duket se ky fenomen është shumë i shprehur në tregun kosovar. Rezultatet paraqesin se 'konkurrenca jo-fer' ka penguar jashtë mase rritjen dhe zhvillimin e bizneseve në katër vitet e fundit në Kosovë. Bizneset e anketuara dhanë një intensitet të lartë për këtë pengesë me 80.1 pikë për periudhën e kaluar dhe 80.2 pikë për periudhën e tanishme. Në anën tjetër, për periudhën e 2017-ës, bazuar në përgjigjet e bizneseve, intensiteti e kësaj pengese pritet të ulet në 68.9 pikë. Intensiteti i lartë ndër vite mund të jetë pjesërisht si pasojë e numrit të vogël të inspektorëve, dënimeve e dobëta dhe kulturës së përgjithshme në të bërit biznes në vend. Sipas Bankës Botërore (2012), politikanët kanë dorë në 'konkurrencë jo-fer' përmes një prezence të drejtpërdrejt, me qëllim që t'i shtyjnë interesat e tyre personale që i kanë me biznese të ndryshme kosovare.

Intensiteti i kësaj pengese del të jetë i ndryshëm në pesë rajonet ekonomike. Nga gjithë rajonet, Rajoni Qendër është vlerësuar me intensitetin më të ulët për periudhat 2009 dhe 2013, me 73.5 dhe 73.4 pikë, res-

Figura 11.


'Konkurrenca jo-fer' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 12.

'Zhvatja' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

pektivisht; kjo është rreth 8 përqind më pak se sa mesatarja shtetërore për vitin përkatës. Kjo mund të jetë pjesërisht si rezultat i numrit të madh të inspektoreve të angazhuar në këtë rajon. Ndryshe, Rajoni Jug qëndron shumë më keq sa i përket parashikimeve të 2017-ës, me një intensitet prej 86.5 pikësh për të dy periudhat – i cili është përreth 8 përqind mbi mesataren në nivel vendi. Rajonet tjera renditen në mes, me shumë pak ndryshim në intensitet për dy periudhat e para – rreth 1 pikë intensiteti ndryshim. Bizneset që presin që kjo pengesë të ulët më së shumti në 2017-ën janë ato të Rajonit Qendër. Këto biznese vlerësojnë se rënia e *'konkurrencës jo-fer'* të jetë për 15.5 pikë të intensitetit më pak, përcjellë nga Rajoni Lindje me 12.8, Rajoni Veri me 11.6 dhe Rajoni Perëndim me 10.4. Jo shumë shpresues për përmirësimin e kësaj pengese janë bizneset e Rajonit Jug, duke thënë se presin të ulët për vetëm 3.3 pikë të intensitetit (për paraqitje vizuale, shih Figurën 11).

Te dhënat për tri periudhat e mbuluara nga anketa e Riinvest-it tregojnë se NMV-të, në mesatare, nuk kanë qenë dhe nuk do të jenë as në të ardhmen subjekt i *'zhvatjes'*. Bizneset, më saktësisht, i dhanë 44.9 pikë të intensitetit për këtë pengesë për vitin 2009, 44.1 për vitin 2013 dhe 40.1 për vitin 2017. Pavarësisht zërave publik për nivelin e lartë të reketit që bizneset Kosovare duhet ta paguajnë, vetë bizneset dalin të kenë perceptim të kundërt, së paku në këtë anketim.

Kur të dhënat ndahen në bazë të pesë rajoneve ekonomike, del se bizneset e Rajonit Perëndim janë ballafaquar kryesisht me më shumë zhvatje krahasuar me mesataren shtetërore; i njëjti problem pritet të mbetet edhe më tutje. Dukshëm, dallimi i intensitetit në mes të Rajonit Perëndim dhe mesatares shtetërore është 53 përqind për 2009-ën, 55 përqind për 2013-ën, dhe rreth 27 përqind për 2017-ën (për paraqitje vizuale, shih Figurën 12). Vërehet se palët kompetente në këtë rajon, më saktësisht ato të Pejës dhe Gjakovës, kanë dështuar të krijojnë sigurinë e nevojshme për bizneset; kështu që, rreziku i dhunës, siç është zhvatja, është bërë praktikë e rregullt për të nxjerrë pagesa nga bizneset e këtij rajonit, duke e bërë më të vështirë zhvillimin e aktiviteteve të tyre operative.

c) Barrierat fiskale

Barrierat fiskale mendohen të jenë deri diku sfiduese për firmat e intervistuar. Përveç barrierës së *'taksat e larta'*, e cila është radhitur e 6-ta në radhitjen e përgjithshme të pengesave, *'tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare'* dhe *'administrata tatimore jo-eficiente'* përfunduan në mes të tabelës (në vendin e 11-të dhe 15-të, respektivisht). Rajoni Qendër qëndron, deri në një masë, më mirë vis-a-vis rajoneve tjera. Tri pengesat fiskale besohet të kenë intensitet më të ulët pas katër vjetëve. Vetëm bizneset e Rajonit Jug e bëjnë një diferencë në këtë aspekt, posaçërisht kur bie fjala për *'taksat e larta'* dhe *'administrata tatimore jo-eficiente'*; bizneset duket të jenë jo shumë optimiste për të ardhmen e këtyre pengesave në krahasim me rajonet e tjera.

'Taksat e larta' i prijnë listës së kufizimeve fiskale për periudhat e marra parasysh në këtë studim. Kjo barrierë fiskale pranoi një intensitet

me shkallë prej 76.3 pikësh për periudhën e 2009-ës, duke pësuar një rënie të lehtë në 74.8 në periudhën përcjellëse (2013). Kjo rënie marginale mund të jetë pjesërisht e lidhur me reformat e aplikuara në fund të 2009-ës që përgjysmuan taksën në profit – por, megjithatë, jo mjaftueshëm për të përmirësuar perceptimin, meqenëse disa taksa të tjera janë ngritur gjatë kësaj periudhe (mes tjerash edhe TVSH-ja). Për 2017-ën, bizneset presin, ndonëse pak ambicioze, që kjo pengesë të ulët edhe më tepër, afërsisht 14 përqind, duke rezultuar me një intensitet prej 64.4 pikësh. Intensiteti i lartë për taksat që del nga rezultatet e anketës është i lidhur me interpretimin arbitrar të rregulloreve të taksave, taksat selektive dhe zhvatjet nga administrata tatimore. Këto praktika *'të pandershme'* kanë qenë më prezente posaçërisht gjatë viteve të fundit, ku Qeveria e Kosovës ka rritur presionin për t'i realizuar të hyrat e parashikuara në mënyrë që të jetë në gjendje ta përballojë pjesëmarrjen e madhe të investimeve kapitale.

Kategorizimi i të dhënave për *'taksat e larta'* ndër rajone nxjerr në pah se për 2009-ën shkalla e intensitetit ndryshon nga 70.1 pikë në Rajonin Qendër deri te 82.9 pikë në Rajonin Jug. Rajoni Veri anon më shumë nga vlerat e ulëta me 72.5 pikë; kurse Rajoni Lindje (79.8) dhe Rajoni Perëndim (78.9) anojnë kah vlerat e larta. Katër vite me vonë (në 2013-ën), serioziteti i kësaj pengese nuk ka rënë; shkalla e intensitetit pësoi rënie neglizhuese; jo më shumë se 2 pikë në secilin rajon ekonomik, duke treguar kështu se është një sfidë e madhe që e pengon zhvillimin e firmave. Në 2017-ën, megjithatë, serioziteti i kësaj pengese parashihet të zbutet në katër rajone ekonomike, përveç Rajonit Jug (për paraqitje vizuale, shih Figurën 13). Pritet negative të bizneseve të Rajonit Jug sugjerojnë se praktikat jo formale që rezultojnë nga taksat indirekte janë një lloj fenomeni i ngjizur, i cili nuk mund të eliminohet shumë lehtë.


Ndonëse administrata tatimore mendohet të jetë kryesisht jo-eficiente, pengesa e listuar si *'administrata tatimore jo-eficiente'* konsiderohet jo shumë serioze nga ana e bizneseve në të gjitha periudhat. Shkallët e intensitetit tregojnë se kjo barrierë në 2009-ën është menduar të jetë 54.6 pikë, e përcjellë nga një rënie prej 52.2 pikësh në 2013-ën. Pas katër vjetëve, parashihet rënie e më tutjeshme, duke përfunduar me intensitet 47 pikë.

Kategorizimi i rezultateve sipas rajoneve nxjerr në pah se ndikimi i kësaj pengese varijon nga Rajoni Qendër, i cili merr intensitetin më të ulët në secilën periudhë (45.3 për 2009-ën, 43.9 për 2013-ën, dhe 42.1 për 2017-ën) tek Rajonin Lindje, i cili merr intensitetin më të lartë (62.7 për 2009-ën, 58.7 për 2013-ën dhe 41.2 për 2017-ën). Rajoni Perëndim dhe Rajoni Linde qëndron afër Rajonit Jug me shkallë të intensitetit, edhe pse ndryshimi i ndikueshmërisë përgjatë viteve nuk është shumë sinjifikant tek rajoni i fundit. Rajoni Veri, në anën tjetër, është pozicionuar më afër Rajonit Qendër në këtë aspekt; që domethënë se kjo pengesë ka qenë më pak shqetësuese për bizneset e tyre dhe kështu do të jetë në të ardhmen (për paraqitje vizuale, shih Figurën 14).

'Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare' rezultojnë në një sfidë të moderuar për bizneset në të gjitha periudhat e studimit. Për ta specifikuar, bizneset e intervistuar në Kosovë i dhanë një in-

Figura 13.


'Normat e larta të taksave' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 14.


'Administrata tatimore jo-efiçente' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 15.

‘Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare’ sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

tensitet prej 65.9 pikësh për 2009–ën dhe me pak peshë për 2013, përkatësisht 64.4. Këto të dhëna demonstrojnë se kostot që lidhen me importin, aplikimin e rregulloreve të rëndësishme, pengesat për të depërtuar në tregun e huaj, si dhe tarifat e tjera të vendit, qoftë për arsye politike apo ekonomike, e pengojnë zhvillimin e firmave kosovare. Firmat eksportuese në Kosovë (ato që eksportojnë se paku 10 përqind të produkteve dhe/ose shërbimeve të tyre) vlerësojnë këtë mangësi me rreth 10 pikë intensiteti për 2009–ën dhe 2013–ën. Kjo është intuitive marrë parasysh faktin se firmat eksportuese ballafaqohen me pengesa e vendosura nga zyrtaret doganorë, edhe si rezultat të rëndohen me kostot e lidhura me të. Në anën tjetër, bizneset e intervistuar konsideruan se pengesat e parashikuara do të jenë më pak serioze në katër vitet e ardhshme, duke i dhënë një intensitet prej 55.7 pikësh.

Me ndarjen e rezultateve në bazë të rajoneve, del se katër nga ato, përkatësisht Rajoni Veri, Jug, Lindje dhe Perëndim, pranojnë intensitete më të larta se sa mesatarja shtetërore për secilën periudhë të përfshirë në këtë studim. Vetëm Rajoni Qendër qëndron nën mesataren shtetërore në këtë rast. Nga pjesët që qëndrojnë mbi mesataren shtetërore, Rajoni Perëndim i vuan pasojat më të rënda të kësaj barriere, duke i pranuar 75 pikë në 2009–ën, 72.6 në 2013–ën dhe 63.2 në 2017–ën. Një rezultat që vlen të përmendet del nga Rajoni Veri. Për dallim nga rajonet tjera, shkalla e intensitetit në Rajonin Veri shënon një rritje prej 3 përqind nga viti 2009 në 2013, përkatësisht nga 69.8 në 72.3 pikë. Duket se zbehja e marrëveshjeve tregtare mes Kosovës

dhe Serbisë, e shkaktuar nga tentimet e mëparshme për ekzekutimin e masave të reciprocitetit në 2011–ën, më se tepërmi i ka ndikuar bizneset e kësaj ane (për paraqitje figurative, shih Figurën 15).


d) Barrierat ligjore

Përveç ‘sistemit gjyqësor jo-efiçent’ që mendohet të jetë një pengesë mjaftë problematike (e 5-ta në listën e barrierave të përgjithshme), ‘ligji i pafavorshëm i punës’ dhe ‘shkeljet e kontratave nga konsumatorët dhe furnizuesit’ duken të jenë më pak serioze nga bizneset (përfshijë bizneset e Rajonit Perëndim), kështu duke u renditur më ulët në vlerësimet e përgjithshme. Pavarësisht faktit se intensitetet e këtyre pengesave nuk kanë ndryshuar shumë përgjatë katër vjetëve të fundit, të tri pengesat në të gjitha rajonet përveç në Rajonin Jug janë parashikuar të marrin shkallë me të ulët të intensitetit në 2017–ën; me fjale të tjera, ato priten të jenë çështje më pak të ndjeshme.

Sistemi gjyqësor konsiderohet i paqëndrueshëm dhe i pakënaqshëm. Rezultatet e anketës tregojnë se ‘sistemi gjyqësor jo-efiçent’ i prinë listës së barrierave ligjore me një shkallë intensiteti prej 77.8 pikësh për periudhën 2009 dhe me një përmirësim të vogël, më pak se 2 përqind, për periudhën 2013. Kjo shkallë e intensitetit tregon se gjykatat kosovare nuk janë mjaft funksionale për ta siguruar pronën dhe zbatimin e kontratave, të cilat kanë një rëndësi të madhe për

Figura 16.

'Sistemi gjyqësor jo-efiçent' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

investime, tregti dhe rritje të përgjithshme të sektorit privat. Me saktësisht, Gjykata Komerciale duhet të fajësohet së pari, duke pasur parasysh se ky është institucioni primar përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekonomike dhe komerciale në mes të entiteteve në biznes. Raporti i punuar nga Departamenti i Shteteve të SHBA-ve (2013) i konfirmon dobësitë që mbizotërojnë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Bazuar në këtë raport, një nga barrierat kryesore për zgjidhjen e lëndëve në gjykatë është numri i madh i lëndëve të pazgjidhura. Krahasuar me periudhën e tanishme, pritjet e bizneseve të intervistuar rreth kësaj barriere për katër vitet e ardhshëm duket të jenë shumë më pozitive (67.9 pikë intensiteti). Kjo për shkak se arbitrazhit i krijuar së fundi ka filluar të shfrytëzohet si zëvendësues i gjykatave për shumë biznese.

Te dhënat ndryshojnë nëpër pese rajone ekonomike. Bizneset e Rajonit Jug duket të jenë ndikuar më së shumti nga jo-efiçenca e gjykatave. Bizneset e këtij rajoni e vlerësojnë 'sistemin gjyqësor jo-efiçent' me 88.1 dhe 87.5 pikë për periudhat e 2009-ës respektivisht 2013-ës. Çuditërisht, ndryshe nga rastet e tjera, bizneset e këtij rajoni duket të jenë më pak optimiste për 2017-ën me një vlerësim prej 84.9 pikësh. Duket se bizneset e këtij rajoni janë të zhgënjyer deri në atë masë sa ata besojnë se asnjë reformë nuk do mund të ndikonte në përmirësimin e sistemit në një të ardhme të afërt. Në anën tjetër, bizneset e Rajonit Qendër, kra-

hasuar me rajonet tjera, shfaqen të jenë më pak të ndikuara nga kjo pengesë. Të dhënat tregojnë se kjo barriere është vlerësuar me 70.2 pikë për periudhën 2009, 68.4 për 2013-ën, dhe 58.9 për 2017-ën; ndërkohë që Rajoni Veri shtrihet drejt një rezultati me të ulet me një intensitet prej 73.1, 73.2, dhe 63.7 pikëve për të njëjtat periudha (për paraqitje vizuale, shih Figurën 16). Në bazë të këtyre rezultateve, krijimi i një sistemi gjyqësor efikas mbetet të jetë njëra nga sfidat më të mëdha për NVM-të që veprojnë në Kosovë.




Bizneset e Rajonit Jug duket të jenë më të ndikuarat nga gjykatat jo-efiçente.

Ndryshe nga 'sistemi gjyqësor jo-efiçent', 'ligji i pa-favorshëm i punës' është perceptuar si pengesë shumë e vogël nga bizneset. Intensiteti për 2009-ën dhe 2013-ën është 52.3 pikë respektivisht 53.4 pikë. Edhe pse fuqia punëtore kosovare ka qenë subjekt i kritikave, rezultatet tregojnë se firmat kosovare nuk janë ndikuar edhe aq nga kjo barriere. Megjithatë, ky intensitet i ulët nuk nënkupton domosdoshmërisht se bizneset janë të kënaqura

me kornizën ligjore. Vlerësimet e ulëta nga bizneset mund të jenë si rezultat i dështimit të inspektoratit që të garantojë zbatueshmërinë e ligjit — kjo për arsye si në vijim: numri i vogël i inspektorëve, numri jo i mjaftueshëm i veturave, mangësia e teknologjisë së komunikimit, dhe buxheti i kufizuar (Instituti GAP, 2012). Bizneset e intervistuar presin që vrazhdësia e kësaj pengese të ulet për rreth 14 përqind në katër vitet e ardhshme.

Figura 17.


‘Ligji i pafavorshëm i punës’ sipas rajoneve
(në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 18.

‘Shkeljet e kontratave nga konsumatorët dhe ofertuesit’ sipas rajoneve
(në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Kur bie fjala për rajonet, rezultatet gjithashtu tregojnë se barrierat e *‘ligjit të pafavorshëm të punës’* nuk duke pengesë e ashpër për NMV-të e intervistuar. Përveç bizneseve të Rajonit Perëndimor, të cilët e konsiderojnë këtë barrierë me shkallë 64.1 në vitin 2009 dhe 62.1 në 2013, bizneset e rajoneve të tjera e vlerësojnë atë nën 60 në të gjitha periudhat (për paraqitje vizuale, shih Figurën 17).

Barriera e *‘shkeljeve të kontratave nga konsumatorët dhe furnizuesit’* mendohet të jetë më pak problematike në krahasim me dy barrierat ligjore të lartpërmendura. Kjo barrierë përfundon me një intensitet jo më shumë se 50 pikë në të gjitha periudhat e përfshira në studim. Për shkak se tregu ku firmat kosovare veprojnë është shumë i vogël, duket se bizneset kanë krijuar raporte të besueshme me ofertuesit dhe konsumatorët e tyre — një fakt, që deri në një mase, e zëvendëson nevojën për kontrata, andaj edhe vlerësimi i ulët. Sidoqoftë, është me rëndësi të theksohet se vetëm besueshmëria dhe marrëdhëniet joformale nuk do të mund t'i zëvendësojnë kontratat në rast se Kosova aspiron ta rrisë tregun.

Ndarja e rezultateve në baza rajonale tregon se firmat e Rajonit Veri, Jug, Lindje dhe Qendër qëndrojnë më mirë në krahasim me Rajonin Perëndim. Në njërin anë, intensiteti për katër rajonet e para është më i ulët se 55 pikë për të gjitha periudhat. Në anën tjetër, bizneset e Rajonit Perëndim e shohin barrierën e shkeljes së kontratave të jetë në mes të të qenurit pengesë e vogël apo pengesë e moderuar në aktivitetet operative të tyre. Me saktësisht, firmat e intervistuar e menduan këtë barrierë ta ketë intensitetin 61.6 pikë në 2009-ën dhe 57.9 pikë në 2013-ën; bizneset presin që ajo të ulët në 49.5 pikë në 2017-ën (për paraqitje vizuale, shih Figurën 18).

e) Barrierat institucionale

Dy barrierat institucionale kanë përfunduar në dy pole të kundërta të listës së barrierave: në njërin anë, *‘mungesa e subvencioneve shtetërore’* perceptohet të jetë në mesin e pengesave më serioze, kurse *‘licencat jo-efiçente të bizneseve dhe procedurat e lejeve’* në mesin e atyre më pak seriozitet. E para u përmirësua lehtë nga 2009-ta dhe parashihet të përmirësohet konsiderueshëm në 2017-ën, përveç në Rajonin Jug, ku parashikimet nuk janë shumë shpresëdhënëse. Ndryshimet pozitive të barrierës së dytë janë të shkallës së njëjtë në tri periudhat e studimit, si dhe nuk ka dallime të theksuara ndërmjet rajoneve.

Rezultatet e anketës tregojnë se *‘mungesa e subvencioneve shtetërore’* u perceptua të jetë pengesë shumë e rëndë për NMV-të në Kosovë në 2009-ën. Shkalla e intensitetit për këtë barrierë rezultoi me 82.3 pikë në këtë periudhë. Për më shumë, rezultatet e kësaj ankete tregojnë se ndikueshmëria e kësaj barrierë nuk ka rënë shumë

që nga ajo kohë, duke u vlerësuar me 81.1 pikë në 2013-ën. Kur bëhet fjalë për seriozitetin e kësaj pengese në katër vitet e ardhshme, firmat e intervistuar tregohen shumë më entuziaste se sa janë tani. Në bazë të përgjigjeve të tyre, intensiteti pritët të pësojë rënie, duke përfunduar në 70.1 pikë. Intensiteti i lartë i kësaj barrierë sugjeron se firmat kosovare kanë nevojë për mbështetje nga shteti pasi që nuk janë mjaft konkurruese me firmat që eksportojnë në Kosovë — të cilat në rastet e shpeshta përfitojnë nga subvencionet shtetërore. Sa për informacion, relacioni import — eksport në Kosovë është rreth 10:1 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013). Megjithatë duhet pasur kujdes se kjo barrierë mund të jetë e mbivlerësuar, duke e pasur parasysht tendencën e bizneseve për të pasur pritje të larta për subvencioneve.

Kur rezultatet e kësaj barrierë për vitin 2009 analizohen, del se me përjashtim të Rajonit Qendër — i cili merr 78.2 pikë — katër rajonet

tjera vlerësohen me intensitete mbi mesataren shtetërore. Në mesin e katër rajoneve që janë mbi mesataren shtetërore, bizneset e Rajonit Jug vuajnë më së shumti nga kjo pengesë, pasi që e vlerësojnë atë me 88.4 pikë. Rezultatet e 2013-ës nuk ndryshojnë shumë prej atyre të 2009-ës (rreth një pikë intensiteti për çdo rajon); Rajoni Qendër sërish qëndron më së miri, përderisa Rajoni Jug më së keqi. Përveç bizneseve të Rajonit Jug, bizneset e rajoneve të tjera kanë pritje pozitive në lidhje me intensitetin e kësaj barrierë. Intensiteti i Rajonit Jug pritët të zbresë për jo më shumë se 2 pikë të intensitetit krahasuar me periudhën e tanishme,

ndërsa për më shumë se 10 pikë të intensitetit në katër rajonet tjera (për paraqitje vizuale, shih Figurën 19).


‘Licencat jo-efiçente për bizneset dhe për procedurat e lejeve’ konsiderohet të jenë një pengesë e vogël për bizneset, siç thonë bizneset e intervistuar. Në bazë të përgjigjeve të tyre, intensiteti i kësaj barrierë në 2009-ën ishte 50.9, kurse tani intensiteti qëndron tek 47.2 pikë. Sa i përket periudhës së ardhshme, bizneset presin që kjo barrierë të ulët në 42.3 pikë të intensitetit. Trendi rënës së kësaj barrierë është pjesërisht i lidhur me hapjen e *‘one-stop shops’* në 26 komuna të Kosovës, të cilat janë të autorizuar që në mënyrë të rregullt të bëjnë regjistrimin e bizneseve dhe të lëshojnë numër fiskal për një kohë më të shkurtër. Gjithashtu, ky trend mund të ju atribuohet reformave të ndërmarra në 2013-ën që çuan tek: heqja e kapitalit minimal dhe e pagesës për regjistrimin e biznesit; eliminimi i kërkesave për validimin e lejes së projekteve të ndërtimit, dhe së fundi deri tek krijimi i një sistemi noterie që kontribuon në kombinimin e procedurave për legalizimin e marrëveshjeve për shit-blerje (Banka Botërore, 2014). Vlen të theksohet se në bazë të Raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore (2014), në indikatorin e *‘hapjes së biznesit’*, Kosova e përmirësoi radhitjen për 26 pozita në krahasim me 2013-ën (Prej të 126-ës tek e 100-ta nga gjithsej 189 vende). Për më tepër, Kosova qëndron 16 vende më lartë në krahasim me 2013 sa i përket *‘punëve me leje të ndërtimit’* (nga pozita e 162-të në të 136-ën) dhe 17 vende më lartë kur bëhet fjalë për *‘regjistrimin e pronësisë’* (nga pozita e 75-të të 78-ën).



Licencat jo-efiçente të bizneseve dhe procedurat e lejes konsiderohet të jetë pengesë e vogël për bizneset.

Figura 19.


'Mungesa e subvencioneve shtetërore' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 20.

'Licencimi jo-efiçent i bizneseve dhe procedurave për leje' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Rajoni Perëndim, Veri dhe Jug për vitin 2009 pranojnë intensitete më të larta se sa mesatarja shtetërore. Saktësisht, intensiteti për këto rajone është si në vazhdim: Rajoni Perëndim, 62.6 pikë; Rajoni Veri, 60.5 pikë; dhe Rajoni Jug, 51.6 pikë. Në anën tjetër, Rajoni Lindje dhe Rajoni Qendër vlerësohen më ulët se sa mesatarja shtetërore; i para nga këta u vlerësua me 43.7 pikë, kurse i dyti u vlerësua me 45.6 pike. Në periudhën përcjellëse (2013), Rajoni Veri i prinë listës me një intensitet prej 57.7 pikësh, përcjellë nga Rajoni Perëndim me 55.8 pikë, Rajoni Jug me 49.1 pikë, si dhe Rajonet Lindje dhe Qendër me rreth 41 pikë intensiteti secili. Në të ardhmen, intensiteti në Rajonin Perëndim, Jug dhe Veri pritet të variojë nga 48-50 pikë, kurse në Rajonin Lindje dhe Qendër pritet të jetë më i ulët se 39 pikë (për paraqitje vizuale, shih Figurën 20).

f) Barrierat e fuqisë punëtore

Barrierat e fuqisë punëtore duket të jenë ndër barrierat më pak serioze në periudhën e tanishme. Tipar dallues i këtyre barrierave është se *'mungesa e motivimit tek punëtorët'* në vend se të përmirësohet si në rastet tjera, ajo është përqësuar nga 2009-ta në 2013-ën. Parashikimet e bizneseve janë se këto pengesa do të përmirësohen në të gjitha rajonet ekonomike, posaçërisht në Rajonin Lindje.

Rezultatet e anketës tregojnë se bizneset e Kosovës qenë me pak të brengosura me *'mungesën e punëtorëve të shkolluar dhe të aftë'* në

treg në vitet e fundit (intensiteti: 51.6 në 2009-ën dhe 47.7-ën në 2013). Një intensitet me i lartë shfaqet vetëm atëherë kur korporatat merren në konsideratë. Dallimi është paksa i pritur, pasi që korporatat janë më të mëdha dhe kërkojnë aftësi me të sofistikuara. Sidoqoftë, kjo barrierë shihet si më e lehtë nga bizneset e intervistuar. Dikush mund të priste që kjo barrierë të ishte e një intensiteti më të lartë, marrë parasysh se institucionet tona arsimore janë të dobëta dhe rrjedhimisht nuk mund të përgatisin studentë të rinj; megjithatë, duket që bizneset kosovare janë ende në nivelin ku vetëm shkathtësitë bazike nevojiten. Barrierat e fuqisë punëtore dolën të jenë në mesin barrierave më pak serioze në periudhën e tanishme.

Bizneset e Rajonit Qendër i konsiderojnë barrierat e fuqisë punëtore si më pak intensivitet, kurse bizneset e Rajonit Perëndim i konsiderojnë ato si më shumë intensivitet. Bizneset e të parës e vlerësojnë këtë barrierë me 48.3 pikë për periudhën e 2009-ës, me 43.8 pikë për 2013-ën dhe me 48.6 pikë për 2017-ën; kurse bizneset e së dytës i japin 57.7 pikë për periudhën e 2009-ës, 53.4 pikë për 2013-ën dhe 43.3 pikë për 2017-ën. Në tri rajonet e tjera nuk janë vërejtur dallime të mëdha; rezultatet e tyre përfundojnë afër mesatares (për paraqitje vizuale, shih Figurën 21).

'Mungesa e motivimit tek punëtorët' shfaqet më e ashpër në krahasim me barrierën e trajtimit të nivelit të arsimit të punëtorëve dhe shkathtësive të tyre, ndonëse asnjëra e as tjetra nuk konsiderohen në mesin e barrierave më serioze. Intensiteti ndryshon nga 53.9 pikë në

Figure 21.

'Mungesa e punëtorëve të shkolluar dhe të aftë' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)





Figura 22.

‘Mungesa e motivit tek punëtorët’ sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

2009-ën deri në 54.2 pikë në 2013-ën. Për periudhat e ardhshme, bizneset kanë tendencë të jenë më optimiste, pasi që presin që kjo barrierë të zbrësë në 47 pikë të intensitetit.

Fuqia punëtore e rajoneve Lindje dhe Qendër duket të jetë më e motivuar në krahasim me rajonet tjera. Për dy periudhat e para (2009 dhe 2013), kjo barrierë pranoi rreth 45 pikë respektivisht 53 pikë. Në katër vitet e ardhshme, barrierë pritet të zbrësë për rreth 7 pikë të intensitetit në secilin rajon. Punëtorët e Rajonit Perëndim dhe Rajonit Jug duken të mos jenë edhe aq të motivuar. Vlera e këtyre rajoneve ndryshon nga 68 në 61 pikë për dy periudhat e para. Shkaktari kryesor i mungesës së motivimit të punëtorëve në këtë dy rajone lidhet me nivelin e vogël të kompensimit dhe orët e shtuara të punës (në shumë raste pa asnjë dite pushimi). Mirëpo, bizneset e Rajonit Perëndim duken të jenë me entuziaste për periudhën e ardhshme, pasi që e vlerësojnë me 49 pikë, për dallim nga bizneset e Rajonit Jug që e vlerësojnë atë me 10 pikë të intensitetit më shumë. Rajoni Veri përfundon afër mesatares shtetërore; ndoshta dy pikë intensiteti dallim nga mesatarja për secilën periudhë të përfshirë në këtë studim (për paraqitje vizuale, shih Figurën 22).

g) Barrierat infrastrukturore

Barrierat infrastrukturore përgjithësisht janë perceptuar si pengesa të vogla për NVM-të që operojnë në Kosovë në periudhën e tan-


ishme. Një karakteristikë dalluese e këtij grupi të barrierave është se krahasuar me vitin 2009, ‘mungesa e energjisë elektrike’ dhe ‘infrastruktura jo adekuate e transportit’, në veçanti, kanë shënuar përmirësimin më të madh. Katër vite prej sot, asnjëra nga këto nuk pritet të jetë e dëmshme për bizneset; nuk janë gjetur dallime të theksuara ndërmjet rajoneve.

Barrierat infrastrukturore udhëhiqen nga ‘problemet që lidhen me parkimin e veturave’. Rezultatet e anketës, më saktësisht, tregojnë se, intensiteti i kësaj barrierë në periudhën e shkuar ka qenë 69.8 pikë; kjo barrierë përcillet nga një rritje e lehtë me intensitet 1 pikë në periudhën vazhduese (2013). Ky vlerësim nuk është i çuditshëm duke marrë parasysh se shumica dërrmuese e bizneseve kosovare janë mikro dhe të koncentruara në qendër të qytetit ku ka deficit të theksuar të hapësirave për parkim. Sa i përket periudhës së ardhme, ngjashëm me barrierat tjera, bizneset e intervistuar e kanë paraparë që kjo barrierë të jetë më pak problematike për të bërë biznes, dhe kështu i kanë dhënë intensitetin 62.8.

Intensiteti sillet nga 70 deri në 75 pikë për Rajonin Veri, Jug, Qendër dhe Perëndim për dy periudhat e para (e kaluara dhe e tashmja). Rajoni Perëndim përfundon me një intensitet ndjeshëm më të ulët, me më shumë se 10 pikë më pak. Përveç bizneseve të Rajonit Jug ku pritet të mos ketë përmirësim në heqjen e kësaj barrierë (73.1 pikë në 2017-ën), bizneset e rajoneve tjera supozojnë që kjo barrierë të jetë me më pak ndikim. Në fakt, bizneset e Rajonit Lindje e kanë

Figura 23.

'Problemet që lidhen me parkingun' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

paraparë që kjo barrierë të ketë një efekt gati të neglizhueshëm në performacën e tyre (për paraqitje vizuale, shih Figurën 23).


'Mungesa e energjisë elektrike' është barriera që e ka shënuar përmirësimin më të madh gjatë katër vjetëve të fundit; mendohet të ketë rënë për afërsisht 40 përqind, nga një vlerësim prej 70 pikësh në 2009-ën në 42.8 në 2013-ën, duke dhënë indikacione se më pak ndërprerje të energjisë elektrike kanë ndodhur gjatë kësaj kohe. Eksitojnë disa arsye që kanë çuar deri të furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike. Së pari, një mihje e linjitet është hapur në periudhën 2010-2011, dhe si rezultat e ka përmirësuar furnizimin për elektranat ekzistuese, Kosovën A dhe Kosovën B. Së dyti, i njëjti burim sugjeron se ka pasur investime që e kanë përmirësuar rrjetin dhe rrjedhimisht i kanë reduktuar humbjet në transmision – në vitin 2012 humbjet në transmision kanë qenë 1.99 e konsumit bruto. Së treti, si rrjedhojë e përmirësimeve në faturim dhe inkasim të detyrimeve të konsumatorëve, humbjet komerciale pothuajse janë përgjysmuar, nga 31 përqind në 2006-ën në 18 përqind në 2012-ën (Tetra Tech, 2013). Efikasiteti dhe efienca në faturimin dhe mbledhjen detyrimeve të konsumatorëve e ka reduktuar (deri diku) konsumin e panevojshëm tek shfrytëzuesit "ilegal", kështu duke e rritur disponueshmërinë e energjisë elektrike në tërë vendin. Duke marrë parasysh përmirësimin e kësaj barriere për një periudhë kaq të shkurtër, bizneset kishin një tendencë për të qenë shumë optimiste për të ardhmen, duke e vlerësuar këtë barrierë jo më shumë se me 45 pikë.

Ndërprerjet më të rralla të energjisë elektrike i zvogëlojnë kostot operative të bizneset, për arsye se ata nuk paguajnë për burime tjera më të shtrenjta të energjisë elektrike. Ia vlen të ceket se lagjet dhe komunitetet në Kosovë janë të kategorizuara në tri kategori të ndryshme (A-B-C), varësisht nga niveli i pagesave të faturave të energjisë elektrike. Me fjalë tjera, konsumatorët më të rregullt i takojnë Kategorisë A dhe janë më pak të prirur të vuajnë nga mungesa e energjisë elektrike; ndërkaj, konsumatorët më pak të rregullt i takojnë Kategorisë C, që do të thotë se kalojnë më shumë orë pa energji elektrike. Duke e marrë parasysh këtë fakt, intensiteti i kësaj barriere shfaqet i ndryshëm nëpër rajone, posaçërisht në periudhën e shkuar. Për 2009-ën, Rajoni Qendër qëndron më së miri me një rezultat prej 63.1 pikësh, përderisa Rajoni Veri qëndron më së keqi me intensitet 73.8 pikë. Për 2013, intensitetet për pesë rajonet ekonomike është rreth 42 pikë. Katër vite prej tash, kjo barrierë pritet të jetë jo sinjifikante për bizneset e rajoneve, sepse asnjëri nga këto rajone nuk pritet t'i ketë më shumë se 39 pikë të intensitetit (për paraqitje vizuale, shih Figurën 24).

'Infrastruktura jo-adekuate e transportit' tani për tani konsiderohet të jetë pengesa më e vogël nga bizneset e intervistuar. Bizneset e vlerësojnë këtë barrierë me 44.5 pikë. Katër vite më parë, është perceptuar të ketë qenë një pengesë më serioze, ndonëse jo në nivelin e barrierës që lidhet me parkingun. Kjo është për shkak se Qeveria e Kosovës si dhe pushtetet lokale kanë realizuar investime të mëdha në rrugë gjatë katër vjetëve të fundit. Në vitin 2013, buxheti i alokuar për rrugë ka përfshirë afërsisht 22 përqind (rreth 357€ milion) të

Figura 24.


‘Mungesa e energjisë elektrike’ sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 25.


‘Infrastruktura joadekuarte e transportit’ sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 26.

'Telekomunikacioni jo-adekuat' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

buxhetit total. Në vitet paraprake (2010-2012), investimet në rrugë hanë qenë edhe më të larta. Për shembull, ndërtimi i autostradës për Shqipëri, edhe pse kontrata kurrë nuk është bërë publike, mendohet të ketë qenë mbi 1 € miliard – kjo është 1/4 e BPV-së së vendit. Fokusi i investimeve të qeverisë kryesisht në rrugë siç duket ka pasur efekt pozitiv tek bizneset e intervistuar.

Në katër vitet e ardhshme, intensiteti pritet të bie më tutje, duke përfunduar te një vlerësim prej 38.5 pikësh. Duke pasur parasysh që bizneset kosovare janë mikro dhe kryesisht të fokusuar në treg vendor, është e kuptueshme që infrastruktura e transportit nuk ka qenë ndonjë problem me ndikim në vitet e fundit dhe nuk do të jetë në të ardhmen e afërt. Firmat e Rajonit Veri duket të kenë pasur infrastrukturë transportuese më pak adekuate në të gjitha periudhat, krahasim me rajonet tjera. (62 në 2009-ën, 47.5 në 2013-ën, dhe 41.7 në 2017-ën). Rajonet tjera shfaqen të jenë më të zhvilluara sa i përket infrastrukturës në transport; rrjedhimisht, asnjëra nga rajonet tjera nuk kanë marrë pikë më shumë se 55 në secilën periudhë (për paraqitje vizuale, shih Figurën 25).

Për fund, 'telekomunikacioni jo-adekuat' ka qenë pengesë e vogël gjatë katër vjetëve të fundit, dhe pritet të jetë edhe me më pak ndikim në të ardhmen. Rajoni Veri duket të ketë pasur probleme me këtë barrierë në të kaluarën; megjithatë, këto probleme janë evituar në masë më madhe sipas bizneseve. Në rajonet tjera, në anën tjetër, kjo barrierë duket të mos ketë qenë pengesë gjatë

katër vjetëve të fundit, dhe nuk do të jetë në të ardhmen (për paraqitje vizuale, shih Figurën 26). Kosova qëndron afër vendeve të zhvilluara sa i përket internetit. Shtrirja e internetit në Kosovë sipas përdoruesve është rreth 76 përqind; kjo përqindje është e ngjashme me vendet e zhvilluara (77 përqind) (STIKK, 2013). Për më shumë, operatorët e telefonisë mobile në Kosovë në mënyrë të vazhdueshme i kanë përmirësuar shërbimet sa i përket kualitetit (p.sh. 3G i njoftuar nga IPKO nga fundi i vitit 2013), si dhe ka ofruar paketa me çmime më të volitshme për bizneset, andaj dhe trendi i intensitetit në përmirësim tek kjo barrierë gjatë viteve të fundit.


h) Barrierat tjera

'Tregu i vogël' është perceptuar të jetë një barrierë problematike për zhvillimin e NVM-ve në Kosovë. Vlerësimi i bizneseve për dy periudhat e para (2009 dhe 2013) tregon se intensiteti qëndron tek 67.8 dhe 68.8, respektivisht. Në anën tjetër, në 2017-ën pritet që ndikueshmëria e kësaj barrierë të bie drastikisht, duke përfunduar me një intensitet prej 60.1 pikësh.

Në një vend të vogël dhe të regionalizuar me një treg të vogël, i cili është i rrethuar me vende të cilat i vendosin barrierat tregtare të ndryshme, është shumë e vështirë për firmat të jenë të mëdha dhe të integruara mjaftueshëm për ta arritur ekonominë e shkallës;

Figura 27.


‘Tregu i vogël’ sipas rajoneve
(në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 28.


‘Krimi i rrugës, vjedhja dhe
mungesa e rregullit’ sipas
rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Figura 29.

'Qasja e kufizuar në tokë' sipas rajoneve (në pikë të intensitetit)



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

njëkohësisht është e vështirë të jenë në numër të mjaftueshëm për me nxitë konkurrencë efektive.

Kategorizimi i të dhënave për *'tregun e vogël'* tregon se bizneset e Rajonit Lindje dhe Qendër shfaqen si rajonet më së paku të konfrontuara me këtë barrierë, krahasuar me mesataren shtetërore të vitit 2009; dallimi është rreth 5 përqind. Në këtë kohë, kjo barrierë duke të jetë më intensive, sepse është ngritur për 2 pikë të intensitetit. Në të ardhmen, ndikueshmëria e kësaj barriere pritet të shënojë rënie për 7 pikë të intensitetit në Rajonin Qendër, dhe rreth 14 pikë të intensitetit në Rajonin Lindje.

Në anën tjetër, Rajoni Perëndim dhe Jug qëndrojnë mbi mesataren shtetërore në cilën periudhë sa i përket kësaj pengese. Dallimi në intensitet varijon nga 8 deri në 13 përqind, varësisht nga rajoni dhe periudha që merret për bazë. Për fund, Rajoni i Veriut aq pikë sa për t'u pozicionuar afër mesatares shtetërore sa i përket kësaj barriere (për paraqitje vizuale, shih Figurën 27).

Barriera e *'krimit të rrugës, vjedhjes dhe mungesës së rregullit'* është perceptuar të ketë pasur ndikim negativ në vitet e fundit. Bizneset e intervistuar e kanë vlerësuar këtë barrierë me intensitet prej 72.1 pikësh në vitin 2009 dhe 71.0 në vitin 2013. Në parim, ambienti i krimit mund të sjellë shumë pasoja për bizneset.

Ky lloj ambienti mund të çojë në kosto më të madhe të të bërit biznes, për shkak të nevojës për të aplikuar forma të ndryshme të sigurimit. Kjo si rezultat ndikon në investime për zhvillim të biznesit

dhe përmirësim të produktivitetit, si dhe mund të çojë në strategji jo optimale të operimit.

Për më shumë, kjo barrierë mund të çojë në ulje të prodhimit për shkak të numrit të reduktuar të orëve të punës, kryesisht duke i evituar ndërrimet e natës. Sërish, si në rastin a barrierave tjera, bizneset presin që *'krimi i rrugës, vjedhja dhe mungesa e rregullit'* të jetë më pak pengesë në të ardhmen, duke i dhënë kështu 64 pikë të intensitetit për 2017-ën.

Bizneset e Rajonit Perëndim dolën të jenë më të afektuarat nga kjo barrierë, duke e vlerësuar atë me 85 pikë të intensitetit për vitin 2009 dhe 83.7 për vitin 2013, pasuar nga Rajoni Jug (77.7 për 2009-ën dhe 77 për 2013-ën), Rajoni Veri (73.5 për 2009-ën dhe 71.6 për 2013-ën), dhe Rajoni Lindje (70.5 për 2009-ën dhe 69.6 për 2013-ën). Në anën tjetër, Rajoni Qendër qëndron relativisht më mirë duke u vlerësuar me 65.3 pikë të intensitetit për vitin 2009 dhe 62.5 për vitin 2013.

Bizneset e Rajonit Perëndim dolën të jenë më optimistët për të ardhmen e këtij fenomeni negativ, duke i dhënë një intensitet prej 15 pikësh më pak në 2017-ën. Rajoni Veri vjen më pas me 9.7 pikë të intensitetit, i pasuar nga Rajoni Lindje (7.5 pikë më pak), Rajoni Qendër (5.6) dhe Rajoni Jug (2.8) (për paraqitje vizuale, shih Figurën 28).

'Qasja e kufizuar në tokë' është perceptuar të jetë me ndikim të moderuar në të bërit biznes. Kjo barrierë ka pranuar një intensitet prej 67.5 pikësh për vitin 2009, 65.2 për 2013-ën, dhe 55.1 për

2017-ën. Ndarja e rezultateve sipas rajoneve tregon se Rajoni Jug i prin listës së rajoneve në secilën periudhë të trajtuar në këtë studim (74.6 pikë për 2009-ën, 72.7 për 2013-ën dhe 70.1 për 2017-ën), përderisa Rajoni Qendër qëndron i fundit (56.4 pikë për 2009-ën, 55.3 për 2013-ën dhe 49.6 për 2017-ën). Rajoni Veri qëndron afër rajonit që i prin listës së rajoneve, përderisa Rajoni Lindje dhe Perëndim qëndrojnë afër mesatares shtetërore për secilën periudhë të studimit (për paraqitje vizuale, shih Figurën 29).

4.4 Përmbledhje për të ardhmen e bizneseve dhe për barrierat e tyre

Ky nën-seksion jep një përmbledhje të rezultateve që kanë për qëllim të bëjnë parashikimin e performancës së bizneseve dhe barrierave në të bërit biznes në vitin 2017. Specifikisht, Tabela 12 hedh dritë mbi diferencën në mes të vitit ekzistues dhe pritjeve për vitin 2017 sa i përket matësve të performancës në biznes dhe grupit të agreguar të barrierave, në nivel qendror dhe rajonal. Në fakt, diferencat në nivel rajonal janë kalkuluar kryesisht për qëllim të krahasimit të pesë rajoneve me mesataren shtetërore; kështu që, Tabela 12 e tregon vetëm magnitudën e ndryshimit në mes të mesatares shtetërore dhe mesatares rajonale. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se për shkak të mungesës së të dhënave krahasuese në shitje dhe në rroga për vitin aktual, diferenca në mes të periudhave për këto dy variabla nuk ka mundur të gjenerohet, por vetëm të dhënat për të ardhmen. Përshkrimet e detajuara të metodologjisë janë dhënë në përfundim të tabelës përmbledhëse.

Sa i përket shitjeve, mesatarisht, 91.2 përqind e bizneseve të intervistuar presin që në vitin 2017 do të mbeten të njëjta ose do rriten. Kur rajonet krahasohen me mesataren shtetërore, duket që proporcioni i bizneseve që presin të rriten ose të qëndrojnë njëjtë është më i larti në Rajonin Veri (4.3 pikë përqindje më i lartë); në anën tjetër, përgjigja më e ulët duket në Rajonin Qendër (4.7 pikë përqindje më e ulët). Rajonet tjera qëndrojnë afër mesatares shtetërore (më pak se 1 përqind dallim) sa i përket pritjeve në shitje në vitin 2017.

Sa i përket rrogave të punëtorëve në vitin 2017, rezultatet e anketës tregojnë proporcion të ngjashëm si në rastin e shitjeve. Thënë saktësisht, 87 përqind e firmave të intervistuar parashohin që rrogat e punëtorëve ose do të stagnojnë ose do të rriten në 2017-ën. Kur ndryshimet ndërmjet rajoneve janë analizuar në këtë aspekt, rezultoni se proporcioni i bizneseve që presin t'i ngritin rrogat e punëtorëve ose t'i mbajnë të njëjta është më i ulët në Rajonin Perëndim dhe Qendër krahasuar me mesataren shtetërore – 5.1 respektivisht 2.1 më pak. Në anën tjetër, sërish Rajoni Veri del të jetë më optimisti sa i përket trendit të rrogave. Specifikisht, proporcioni i bizneseve që presin që

rrogat të rriten ose të stagnojnë është për 3.9 pikë përqindje më i madh se mesatarja shtetërore; ky rajon pasohet nga Rajoni Jug me një difference pozitive prej 2.9 pikëve të përqindjes. Proporcioni në Rajonin Lindje është i ngjashëm me mesataren shtetërore (0.4 pikë përqindje më e ulët).

Rezultatet e agreguara tregojnë se numri i punëtorëve pritet të rritet për mesatarisht 1.9 punëtor. Rezultatet ndërmjet pesë rajoneve ekonomike nuk ndryshojnë shumë nga mesatarja shtetërore. Bizneset e intervistuar në Rajonin Qendër dolën të jenë pak më konservative në këtë aspekt; këto firma presin që të punësojnë mesatarisht 0.9 punëtorë më pak në krahasim me mesataren e të gjitha firmave në Kosovë.

Në krahasim me Seksionin 4.3, këto barrierat interpretohen në mesatare të grupit. Të kihet parasysh se, për ndryshim nga matësit e performacës në të ardhmen, këtu shigjetat poshtë në tabelë tregojnë se klima e biznesit është duke u përmirësuar; shigjetat lartë e tregojnë të kundërtën.

Përgjithësisht, gjashtë grupet e barrierave pritet të jenë më pak serioze në 2017-ën në nivel shtetëror. Nga këto barrierat, ato financiare perceptohen të shënojnë ndryshimin më të madh pozitiv, krahasuar me vitin ekzistues; rreth 11.7 pikë të intensitetit më e ulët. Krahasuar me rezultatet e rajoneve në këtë barrierë, del se bizneset e intervistuar në Rajonin Jug janë më pak optimiste, sepse kjo barrierë pranon 6 pikë të intensitetit më shumë krahasuar me mesataren shtetërore, përderisa firmat e Rajonit Lindje janë më optimiste (5.1 pikë të intensitetit më pak).

Në nivel vendi, barrierat e informalitetit dhe ato fiskale pritet të ulen secila për rreth 8 pikë të intensitetit. Sërish, Rajoni Jug del të jetë më pak entuziasti rreth potencialit të uljes së këtyre barrierave. Dallimi në mes të intensitetit në këtë rajon dhe mesatares shtetërore për të dyja grupet e barrierave është afërsisht 5.5 pikë të intensitetit. Në anën tjetër, Rajoni Perëndim shfaqet të jetë rajoni më optimist në relacion me barrierat financiare. Dallimi në mes të pikëve të intensitetit në mes të këtij rajoni dhe mesatares shtetërore është 6.1; përderisa Rajoni Perëndim duket të jetë rajoni më entuziast në relacion me barrierat e informalitetit (3.2 pikë të intensitetit dallim).

Në nivel shtetëror, bizneset presin që barrierat ligjore, institucionale, dhe infrastrukturore të zbrisin për mesatarisht 6.9, 7.9 dhe 5.3 pikë të intensitetit, respektivisht. Sërish, intensiteti për të tri grupet e barrierave në Rajonin Jug dallon ndjeshëm nga mesatarja shtetërore. Dallimi është 4.7 pikë të intensitetit për barrierat ligjore; 6.1 pikë të intensitetit për barrierat institucionale dhe 3.6 për barrierat infrastrukturore.

TABELA 12: PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE RRETH PERFORMANCËS SË BIZNESEVE DHE BARRIERAVE NË TË BËRIT BIZNES NË TË ARDHMEN

	Mesatarja shtetërore (A)	Δ (A) – Rajoni Qendër (B)	Δ (A) - Rajoni Lindje (C)	Δ (A) - Rajoni Jug (D)	(A) - Δ Rajoni Perëndim (E)	(A) - Δ Rajoni Veri (F)
Bizneset në rritje dhe stagnuese (shitjet)*	▼ 91.2	▼ 4.7	▼ 0.7	▲ 0.8	▲ 0.3	▲ 4.3
Bizneset në rritje dhe stagnuese (pagat)**	▲ 87.0	▼ 2.1	▲ 0.4	▲ 2.9	▼ 5.1	▲ 3.9
Numri i punëtorëve***	▲ 1.9	▼ 0.9	▲ 0.8	▼ 0.5	▲ 0.1	▲ 0.5
Barrierat financiare****	▼ 11.7	▲ 0.1	▼ 5.1	▲ 6	▼ 0.3	▲ 0.7
Barrierat që lidhen me informalitetin	▼ 8.1	▲ 1.1	▼ 0.8	▲ 5.3	▼ 6.1	▼ 0.8
Barrierat fiskale	▼ 8	▲ 1.3	▼ 3.1	▲ 5.8	▼ 2	▼ 3.2
Barrierat ligjore	▼ 6.9	▲ 0.8	▲ 1	▲ 4.7	▼ 2.6	▼ 1.2
Barrierat institucionale	▼ 7.9	▲ 0.9	▼ 3.3	▲ 6.1	▼ 1.5	▼ 2.8
Barrierat infrastrukturore	▼ 5.3	▲ 0.5	▼ 3.3	▲ 3.6	▼ 1.7	▼ 0.8

* Numri në Kolonën (A) të këtij rreshti paraqet përqindjen mesatare të bizneseve kosovare, që presin që shitjet e tyre ose të mbeten të njëjta ose të rriten në 2017-ën; numrat prej kolonës (B) tek (F) të këtij rreshti përfaqësojnë dallimin në mes të kolonës (A) dhe përqindjes mesatare të bizneseve të secilit rajon, që presin që shitjet e tyre ose të mbesin të njëjta ose të rriten në 2017-ën.


** Numri në Kolonën (A) të këtij rreshti paraqet përqindjen mesatare të bizneseve kosovare që presin ose të mbesin të njëjta ose të rriten në aspekt të pagave në 2017-ën; numrat prej kolonës (B) tek (F) të këtij rreshti përfaqësojnë dallimin në mes të kolonës (A) dhe përqindjes mesatare të bizneseve të secilit rajon që presin ose të rrisin ose t'i mbajnë të njëjta pagat në 2017-ën.

*** Numri në Kolonën (A) të këtij rreshti tregon dallimin në mes të numrit aktual të punëtorëve dhe numrit të punëtorëve që parashihet të jetë në 2017-ën në nivel shtetëror; numrat prej kolonës (B) dhe (F) të këtij rreshti përfaqësojnë dallimin në mes të kolonës (A) dhe dallimit në mes të numrit aktual të punëtorëve dhe atyre që parashihen në 2017-ën në secilin rajon.

**** Numri në Kolonën (A) të këtij rreshti tregon dallimin në mes të intensitetit mestar të barrierave financiare në 2013-ën dhe 2017-ën në nivel shtetëror; figurat prej kolonës (B) tek (F) të këtij rreshti përfaqësojnë dallimin në mes të kolonës (A) dhe dallimin në mes të intensitetit mestar të barrierave financiare në 2013-ën dhe 2017-ën në secilin rajon. Ekuacioni i njëjtë vlen për grupet tjera të barrierave në këtë tabelë.

FIGURA 30: PERSPEKTIVA E BIZNESEVE MBI SHËRBIMET E KOMUNËS (NË %)

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

4.5 Perspektiva e bizneseve mbi institucionet lokale dhe qendrore

Ky nën-seksion prezanton perspektivën e bizneseve në lidhje me shërbimet e ofruara nga komunat e tyre, qeveria qendrore, dhe AZhR-të. Përveç kësaj, ky nën-seksion prezanton njohuritë e bizneseve lidhur me ndikimin e këtyre institucioneve në zhvillimin e NVM-ve dhe se sa të hapura janë këto institucione ndaj bizneseve.

Bizneseve të anketuara u është kërkuar të vlerësojnë shërbimet e ofruara nga komuna e tyre përkatëse. Rezultatet e përgjithshme tregojnë se mbi 50 përqind e bizneseve konsiderojnë se shërbimet janë ose ‘shumë të dobëta’ ose ‘të dobëta’, ndërsa rreth 22 përqind e pohojnë të kundërtën. Pjesa tjetër (rreth 29 përqind) janë neutral në këtë drejtim. Për shkak të stafit jo-efektiv dhe jo-efikas, komunat e Kosovës janë duke u përballur me vështirësi në lidhje me kapacitetin për të absorbuar kompetencat që u janë transferuar atyre, si dhe vështirësi për të absorbuar fondet e donatorëve (Schultze-Kraft, 2013). Përveç kësaj, sipas Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (2012), në shumicën e rasteve, paqartësia në ekzekutimin e

detyrave dhe përgjegjësi është një pengesë për arritjen e funksionalitetit dhe efikasitetit më të madh në ofrimin e shërbimeve në komunat e Kosovës. I njëjti institucion thekson se mbetet shumë për t’u bërë për përmirësimin e planifikimit financiar dhe kapaciteteve menaxhuese apo absorbuese të komunave.

Një kategorizim i rezultateve sipas rajoneve tregon se bizneset e Rajonit Perëndim duket të jenë më pak të kënaqura me shërbimet



Përqindja më e lartë e bizneseve të cilët mendojnë se përkrahja nga komuna nuk ka kontribuar në zhvillimin e NVM-ve është në Rajonin Lindje.

e ofruara nga komuna e tyre përkatëse vis-à-vis rajoneve tjera. Mbi 60 përqind e tyre pohuan se shërbimet janë ose ‘shumë të dobëta’ ose ‘të dobëta’, ndërsa jo më shumë se 15 përqind pohuan se shërbimet komunale janë ‘të mira’ ose ‘shumë të mira’. Pjesa tjetër e bizneseve të anketuara ishin neutral. Pas Rajonit Perëndim pason Rajoni Jug, me rreth 56 përqind të bizneseve të cilat i perceptojnë shërbimet komunale si “të dobëta” ose “shumë të dobëta”, rreth 23 përqind ‘të mira’ ose ‘shumë të mira’, dhe pjesa tjetër janë neutral; Rajoni Lindje (‘të dobët’ ose ‘shumë të dobëta’ – rreth 52 përqind, ‘të mira’ ose ‘shumë të mira’ – rreth 24 përqind dhe neutral – rreth 24 përqind); Rajoni Veri (‘të dobëta’ ose ‘shumë të dobëta’ – rreth 48 përqind, ‘të mira’ ose ‘shumë të mira’ – rreth 23 përqind dhe neutral – rreth 29 përqind); dhe Rajoni Qendër (‘të dobëta’ ose ‘shumë të dobëta’ – 39 përqind, ‘të mira’ ose ‘shumë të mira’ –

rreth 24 përqind, dhe neutral – rreth 27 përqind) (për paraqitje vizuale, shih Figurën 30).

Për më tepër, shumica e bizneseve të anketuara, rreth 78 përqind, kanë deklaruar se mbështetja (p.sh. subvencionet, lehtësimet tatimore) e dhëna nga komuna e tyre gjatë katër vjetëve të fundit nuk ka kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve. Në anën tjetër, pothuajse 7 për qind e tyre nuk u pajtuan me pohimin dhe rreth 16 përqind nuk kishin asnjë ide nëse mbështetja ka pasur ndonjë ndikim gjatë kësaj periudhe. Mund të jetë që bizneset të cilat përbëjnë përqindjen e fundit nuk janë në dijeni për ndonjë mbështetje konkrete të bërë nga komuna e tyre, prandaj edhe refuzuan për të marrë një qëndrim në anketë. Duke lënë anash vetëm disa biznese bujqësore që kanë përfituar, komunat në përgjithësi nuk japin grante apo subvencione për NVM-të, as nuk aplikojnë ndonjë lehtësim domethënës tatimor. Kjo mund jetë si rezultat i mungesës së vullnetit politik nga ana e zyrtarëve komunal, si dhe buxhetit të pamjaftueshëm.

Një krahasim i rezultateve nëpër rajone tregon se përqindja më e lartë e bizneseve të cilët mendojnë se përkrahja nga komuna nuk ka kontribuar në rritjen e NVM-ve është në Rajonin Lindje; ato përbëjnë rreth 90 përqind, pasuar nga Rajoni Jug me rreth 85 përqind, Rajoni Perëndim me afërsisht 76 përqind, Rajoni Qendër me rreth 73 përqind, dhe Rajoni Veri me 64 përqind. Përqindja e mbetur për çdo rajon përbëhet nga ato biznese që besojnë se përkrahja nga komuna ka pasur një ndikim pozitiv në rritjen e NVM-ve dhe nga ato biznese të cilat nuk kishin ndonjë qëndrim.

Vlen të përmendet se firmat që nuk kanë qëndrim e dominojnë këtë grup të bizneseve. Në rastin e Rajonit Lindor, për shembull, vetëm 2 përqind e bizneseve të anketuara pohuan se ka pasur një ndikim pozitiv në rritjen e NVM-ve (për paraqitje vizuale, shih Figurën 31).

Një pyetje e ngjashme ju është parashtruar bizneseve, duke tentuar të shqyrtojë mbështetjen e dhënë nga qeveria. Ngjashëm me rastin e komunave, mesatarisht, rreth 78 përqind e bizneseve të anketuara u pajtuan me idenë se qeveria nuk ka pasur asnjë rol pozitiv në rritjen e NVM-ve në rajonin e tyre gjatë katër vjetëve të fundit; rreth 6 për qind nuk u pajtuan, dhe pjesa tjetër (16 përqind) kanë preferuar të mos japin ndonjë qëndrim në këtë drejtim. Kjo nuk është për t'u habitur, duke pasur parasysh se gjatë disa viteve të fundit Qeveria e Kosovës, përveç subvencioneve të ofruara për bizneset bujqësore, nuk ka bërë shumë për NVM-të në drejtim të sigurimit të subvencioneve. Mungesa e mbështetjes financiare nga qeveria është duke i penguar bizneset që të bëhen konkurrese vis-à-vis importuesve, prandaj kemi raportin eksport- import prej 1:10. Vini re se këto rezultate, megjithatë, duhet të interpretohet me kujdes pasi ndonjëherë pritjet e NVM-ve për të marrë mbështetje financiare janë joreale.

Prej bizneseve që kanë marrë një qëndrim sa i përket pyetjes së lartpërmendur, kompanitë me përgjegjësi të kufizuar duket të jenë grupi më i madh i cili sheh një ndikim pozitiv (15 përqind), ndjekur nga partneritetet dhe bizneset individuale (6 përqind secili). Kjo, në një farë mase, tregon se disa nga kompanitë më të mëdha mund të kenë përfituar më shumë nga qeveria (përmes tenderëve që marrin, për shembull), dhe si rezultat kanë qëndrim pozitiv ndaj këtij institucioni.

Shpërndarja e përgjigjeve nëpër rajone, duke marrë parasysh mbështetjen e qeverisë për NVM-të, në shkallë të konsiderueshme përkon me shpërndarjen e përgjigjeve për mbështetjen e komunave për NVM-të; përgjigjet mund të ndryshojnë nga jo më shumë se 3 pikë përqindje (për paraqitje vizuale, shih Figurën 32).

Rezultatet e anketës sugjerojnë se një pjesë shumë e vogël e bizneseve të anketuara janë ftuar nga komunat e tyre gjatë hartimit të politikave që kanë të bëjnë me biznese. Më konkretisht, më shumë

se 93 përqind e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se kurrë nuk kanë marrë ndonjë ftesë nga komuna e tyre, ndërsa më pak se 6 përqind ka marrë një ftesë një herë gjatë vitit. Kjo shifër tregon se debatet publike janë rrallë të organizuar nga komunat, duke treguar kështu se procesi i vendim-marrjes zakonisht është i centralizuar në kuptimin që nuk ka aktorë të tjerë të cilët marrim pjesë. Në parim, përfshirja e ulët e bizneseve në proceset e vendim-marrjes mund të çojë në vendime që nuk adresojnë nevojat më të rëndësishme të bizneseve.

Një kategorizim i rezultateve për nga numri i punëtorëve në një firmë tregon se bizneset që përbëhen nga një numër më i madh i të punësuarve janë ftuar më shpesh nga komuna e tyre, kur janë hartuar politikat e ndërlidhura me biznesin. Më konkretisht, më shumë se 24 përqind e bizneseve me më shumë se 50 punëtorë kanë qenë të përfshira në proceset e vendim-marrjes në komunat e tyre – që është rreth 18 pikë përqindje më shumë se mesatarja e Kosovës. Edhe pse bizneset me më pak se 9 punonjës përbëjnë përqindjen më

të madhe të bizneseve në Kosovë, duket se ato kanë qenë të lëna pas dore nga komunat e tyre pasi vetëm 5 për qind e tyre ishin të ftuara të marrin pjesë në proceset e krijimit të politikave që lidhen me bizneset. Rezultatet e mëtejshme në lidhje me çdo kategori biznesi (në aspektin e numrit të të punësuarve) janë dhënë në Figurën 33.

Komunat e Rajonit Qendër, Lindje dhe Perëndim duket të jenë më pak përfshirëse, kur është fjala për hartimin e politikave të biznesit. 94.5 përqind e bizneseve të intervistuar në secilin nga tre rajonet kurrë nuk kanë marrë ftesë që të jenë pjesë e ndonjë procesi në hartimin e politikave në lidhje me ta, ndërsa vetëm 5.5 përqind kanë marrë ftesë. Rezultatet e anketës tregojnë se komunat e dy rajoneve të tjera, Jug dhe Veri, nuk shënojnë ndonjë ndryshim në këtë drejtim. Më saktësisht, vetëm 9 përqind e bizneseve të anketuara në Rajonin Jug janë ftuar nga komunat e tyre, ndërsa rreth 8 përqind e



Rreth 68 përqind e bizneseve i konsiderojnë AZhR-të e tyre përkatëse të jenë ose 'shumë të dobëta' ose 'të dobëta'. Më shumë se 93 për qind e bizneseve kanë deklaruar se kurrë nuk kanë marrë ndonjë ftesë nga komunat e tyre në hartimin e politikave të lidhura me biznesin.

FIGURA 31: PERSPEKTIVA E BIZNESEVE NË LIDHJE ME NDIKIMIN E KOMUNËS SË TYRE NË RRITJEN E NVM-VE (NË %)

BURIMI: KALKULIMET E
AUTORËVE NGA TË DHËNAT
E ANKETËS




FIGURA 32: PERSPEKTIVA E BIZNESEVE NË LIDHJE ME NDIHMËN E QEVERISË SË KOSOVËS NË RRIJTJEN E NVM-VE (NË %)

BURIMI: KALKULIMET E
AUTORËVE NGA TË
DHËNAT E ANKETËS




FIGURA 33: PËRFSHIRJA E BIZNESEVE NË PËRPILIMIN E POLITIKAVE TË NDËRLIDHURA ME BIZNESET (SIPAS MADHËSISË SË FIRMËS, NË %)

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

▼ PO ▼ JO




FIGURA 34: PËRFSHIRJA E BIZNESEVE NË PËRPILIMIN E POLITIKAVE TË NDËRLIDHURA ME BIZNESE (SIPAS RAJONIT, NË %)

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

▼ PO ▼ JO





FIGURA 35: PERSPEKTIVA E BIZNESEVE NË LIDHJE ME MBËSHTETJEN E AZHR-VE NË RRITJEN E NVM-VE (SIPAS RAJONIT)

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS



bizneseve që i përkasin Rajonit Veri janë ftuar nga komunat e tyre (për informata më të hollësishme, shih Figurën 34).

Kur bizneset u pyetën në lidhje me shërbimet e Agjencive për Zhvillim Rajonal (AZhR), pjesa më e madhe e tyre, rreth 68 përqind, e konsideronin agjencinë e tyre përkatëse të jetë 'shumë e dobët' ose 'e dobët'; ndërsa 8 përqind e konsiderojnë si 'të mirë' ose 'shumë të mirë'. Pjesa e mbetur, e përbërë nga rreth 24 përqind të bizneseve të intervistuar, rezultoi në përgjigjet neutrale. Vlen të përmendet se këto rezultate duhet të interpretohen me kujdes për dy arsye kryesore. Së pari, për 308 nga 1000 biznese mungojnë të dhënat në këtë pyetje, pasi këto biznese kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje, kryesisht për faktin se ato kurrë nuk kishin dëgjuar për agjenci të tilla. Së dyti, është e mundshme që shumë nga ato biznese që e kanë marrë një pozicion neutral e kanë bërë këtë për ta mos e anashkaluar pyetjen; përndryshe, do të kishin përfunduar në kategorinë e të dhënave që mungojnë (anglisht: "missing values"). Këto rezultate mund të interpretohen për të konkluduar se AZhR-të kanë qenë kryesisht të orientuara nga vetja dhe jo mjaftueshëm aktive për të ndihmuar bizneset me shërbimet e tyre. Mund të jetë që shërbimet e AZhR-ve të ndikojnë tërthorazi tek bizneset, pasi që AZhR-të bashkëpunojnë kryesisht me zyrtarët publik në komuna dhe jo me biznese drejtpërdrejt.

Rajoni Jug është rajoni me përqindjen më të lart të bizneseve të cilat i konsiderojnë shërbimet e AZhR-ës së tyre të jenë 'shumë të varfra' ose 'të varfra' në krahasim me rajonet e tjera. Më specifikisht, rreth 76 përqind të bizneseve të anketuara në Rajonin Jug janë të mendimit se shërbimet e AZhR-ës së tyre janë 'shumë të varfra' ose 'të varfra'.



Krahasuar me rajonet tjera, Rajoni Jug është rajoni me përqindjen më të madhe të bizneseve të cilat e konsiderojnë AZhR-në e tyre të jetë 'shumë e dobët' ose 'e dobët'.

Afër me këtë vlerësim duket të jetë Rajoni Lindje, ku rreth 74 përqind e bizneseve të anketuara në këtë pjesë ndajnë të njëjtin mendim, pasuar nga Rajoni Qendër me rreth 69 përqind, Rajoni Perëndim me 59 përqind dhe Rajoni Veri me 56 përqind. Proporcioni e bizneseve që i konsiderojnë shërbimet e AZhR-ës së tyre të jenë ose 'të mira' ose 'shumë të mira' shkon nga 2 përqind në Rajonin Veri në rreth 8 përqind në Rajonin Jug. Përqindja më e vogël e bizneseve të cilat kanë marr një pozicion neutral shfaqet në Rajonin Jug (rreth 22 përqind), ndërsa përqindja më e madhe në rajonin e Qendër (rreth 36 përqind).

Vetëm 2 përqind e të gjitha bizneseve të intervistuar mendojnë se AZhR-ët e tyre kanë kontribuar në rritjen e NVM-ve të vendit gjatë katër vjetëve të fundit, ndërkohë që 64 përqind pohuan të kundërtën dhe rreth 34 përqind nuk e dinë. Përgjigjet e bizneseve në çdo rajon janë shumë të afërta me mesataren shtetërore, shih Figurën 35.

78%

e bizneseve te anketuara janë pajtuar me idenë se qeveria nuk ka pasur ndonjë rol pozitiv në rritjen e NVM-ve në rajonet e tyre në katër vitet e fundit.

93%

te bizneseve te anketuara kanë deklaruar se ata nuk kanë pranuar asnjëherë ndonjë ftesë nga komuna e tyre.



Instituti Riinvest
aranzhoi pesë
fokus grupe (një
për secilin rajon)
me hisedarë të
ndryshëm të
bizneseve, siç
janë: zyrtarët
e komunave,
shoqëria civile,
dhe palët e tjera
të interesuara.”



5. REZULTATET E FOKUS GRUPIT

Pas interpretimit dhe analizës së rezultateve të anketës, raporti vazhdon me rezultatet e fokus grupeve, që nxjerrin në pah perspektivat e drejtoresve të komunave për zhvillimin ekonomik, ekspertëve ekonomik lokal, si dhe perspektivat e përfaqësuesve të OJQ-ve, Agjencie të Zhvillimit Rajonal (AZhR-ve), Bankave, Asociacioneve të Biznesit dhe palëve tjera të interesuara. Ky seksion është i organizuar si në vijim. Seksioni 5.1 i tregon të gjeturat e pesë grupeve të barrierave të mundshme për të bërë biznes sipas rajoneve ekonomike në Kosovë. Seksioni 5.2 i prezanton opinionet e pjesëmarrësve të fokus grupeve të secilit rajon ekonomik në lidhje me rolin e institucioneve (qeverisë qendrore, pushtetit lokal dhe AZhR-ve) drejt zhvillimit të bizneseve. Seksioni 5.3 i prezanton të dhënat e fokus grupit, që kuantitativisht e vlerësojnë implementimin e strategjive të zhvillimit rajonal. Seksioni 5.4 e prezanton perspektivën e diskutimeve të fokus grupit në lidhje me potencialet e sektorëve të Kosovës.

5.1. Barrierat në zhvillimin e NVM-ve

Ky nën-seksion i paraqet të gjeturat e pesë diskutimeve të fokus grupeve në relacion me barrierat e të bërit biznes dhe efektin e tyre në zhvillimin e NVM-ve. Grupet e barrierave të diskutuara janë si në vijim: *barrierat e fuqisë punëtore, barrierat infrastrukturore, barrierat financiare, barrierat ligjore dhe barrierat fiskale*. Renditja e këtyre barrierave nuk është bazuar në seriozitetin e tyre.

a) Barrierat e fuqisë punëtore

Kur bizneset ishin pyetur të tregojnë opinionin e tyre nëse fuqia punëtore në rajonin e tyre i kënaq nevojat e NVM-ve, afërsisht të gjithë pjesëmarrësit në diskutimet e fokus grupit shfaqen brenat e tyre për nivelin e fuqisë punëtore. Në bazë të tyre, ekziston një numër i madh i njerëzve në fuqinë punëtore, të cilët janë të pajisur me diploma universiteti, por atyre iu mungojnë aftësitë bazike për bërjen e punëve të caktuara në mënyrën e duhur. Një i anketuar nga Rajoni Perëndim deklaroi, *“Kosova është duke krijuar punë për njerëz me nivel me të lartë të arsimimit, por jo edhe njerëz të cilët do ta bënin punën e tyre në mënyrën e duhur. Programet e shkollave/universiteteve nuk janë të dizajnuara që t’i mbulojnë kërkesat e bizneseve.”* Një diskutues tjetër nga Rajoni Perëndim tha, *“Ne duhet ta bëjmë një dallim në mes të kuantitetit dhe kualitetit të fuqisë punëtore. Problemi është me këtë të fundit.”*

Është përmendur në pothuajse të gjitha grupet se kjo pengese është deri në një masë më e theksuar tek bizneset që kërkojnë aftësi më të

sofistikuara teknike. Për shembull, një diskutues nga Rajoni Qendër deklaroi, *“... disa start-ups të reja në sektorin e IT-se kanë telashe të gjejnë ekspertë të certifikuar dhe të aftë të IT-së; si rezultat, ata duhet të paguajnë për trajnimet e pothuajse çdo punëtori të ri. Kjo i ngrit kostot e të bërit biznes.”* I njëjti diskutues vazhdoi, duke thënë se kostot e lidhura me trajnimet i bëjnë bizneset e IT-së që veprojnë në Kosovë më pak konkurruese në krahasim me bizneset e njëjta që veprojnë në vendet fqinje.

Një numër i diskutuesve në Rajonin Veri ngritën një problem tjetër, i cili nuk është i ndërlidhur me aftësitë e punëtoresve, por me motivimin dhe gatishmërinë e tyre që të punojnë. Sipas tyre, pavarësisht nivelit të lartë të papunësisë në Kosovë, ata që arrijnë të pranohen në një punë të caktuar nuk janë të motivuar ta kryejnë punën e tyre. Një diskutues nga Rajoni Veri pohoi, *“Mungesa e etikës së punës është mangësi e madhe në shoqërinë tonë. Gjithmonë nevojitet prezenca e një menaxheri apo pronari për t’i mbikëqyrur punëtorët e tyre, përndryshe produktiviteti dhe rezultatet e tyre nuk do të jenë në nivel të kënaqshëm.”* Pjesëmarrësit e këtij rajoni raportuan se shkaktarët kryesorë për mungesën e motivimit janë pamundësia e punëdhënësve për të dhënë paga të mira, dhe remitancat që rrjedhin nga diaspora kosovare.

Për më tepër, ndrojtjet mbi mungesën e shkollave profesionale të cilat ofrojnë kurse të aplikuara janë cekur në pothuajse të gjitha diskutimet e fokus grupeve të organizuara. Pjesëmarrësit deklaruan se, pavarësisht disa tentimeve për të themeluar shkolla profesionale, asgjë që vlen të përmendet nuk është ndërmarr në këtë drejtim. Një pjesëmarrës nga Rajoni Lindje deklaroi, *“...si rezultat i mungesës së shkollave profesionale funksionale, bizneset mund të hasin në vështirësi të gjejnë një saldues, e mos të përmendim ndonjë teknik tjetër specifik.”* Për të ilustruar nevojat e shkollave profesionale, një pjesëmarrës nga Rajoni Jug pohoi, *“...tash për tash, në nuk kemi ndonjë qendër që do të ‘arsimonte’ mirëfilli as një vozitës kamioni.”*

Pjesëmarrësit në pothuajse çdo diskutim ishin të mendimit se duhet të ekzistojë një institucion koordinues, i cili ofron informata për kërkesat e

tregut të punës; përndryshe studentet do t’i zgjedhin drejtimet e gabuara. Sipas një pjesëmarrësi, *“Kosovaret kryesisht studiojnë juridik apo ekonomi pa qenë në dijeni se tregu i punës në Kosovë është i mbushur me njerëz të këtyre fushave.”*

Disa pjesëmarrës në fokus grup të Rajonit Jug kishin tendencë ta shikojnë anën pozitive të fuqisë punëtore në Kosovë. Ata potencuan faktin se në kemi fuqinë punëtore me të lirën në rajon. Një pjesëmarrës theksoi, *“fuqia punëtore është mjaft e lirë... unë nuk njoh ndonjë rajon tjetër që e ka një fuqi punëtore kaq të lirë.”*



Ne duhet ta bëjmë dallimin në mes të kuantitetit dhe kualitetit të fuqisë punëtore; problemi është tek kjo e fundit.

Përgjithësisht, pjesëmarrësit e secilit fokus grup ndanë të njëjtën ide se fuqia punëtore e tanishme në Kosovë nuk i posedon aftësitë e duhura. Për më tepër, të gjithë nga ta kanë një perceptim pozitiv, duke parashikuar se ky barrierë do të përmirësohet në vitet e ardhshme.

b) Barrierat infrastrukturore

Shumica e pjesëmarrësve nga secili fokus grup kanë qenë mirënjohës për zhvillimet e qeverisë në vitet e fundit. Ata pohuan se një punë e madhe ka përfunduar për përmirësimin e rrugëve urbane si dhe rrugëve që lidhin pjesët kryesore urbane. Për shembull, një diskutues nga Rajoni Veri raportoi, *“Sa i përket infrastrukturës rrugore, së fundi është përmirësuar; ekziston një infrastrukturë e përshtatshme për zhvillimin e biznesit.”* Fakti se disa rruge janë në përfundim e sipër i kënaq disa nga pjesëmarrësit, posaçërisht ata të Rajonit Veri dhe Qendër. Një pjesëmarrës nga Rajoni Veri pohoi se, *“Rruga Mitrovicë-Prishtinë thjeshtë mund të quhet autostradë. Është pothuajse në përfundim dhe shpresojmë se ajo do të ndihmojë në zhvillimin e bizneseve në të ardhmen e afërme.”*

Ndër diskutimet e fokus grupit, kishte pjesëmarrës të cilët kishin pikëpamje negative mbi investimet e vendit në infrastrukturën rrugore. Së pari, kishte disa nga ta që deklaruan se investimet e Kosovës në infrastrukturë nuk janë bazuar në studime fizibiliteti. Për shembull, një dikustes nga Rajoni Perëndim theksoi, *“...problemi me investime kapitale (duke iu referuar rrugëve) qëndron tek fakti se janë bërë pa ndonjë studim fizibiliteti.”* Një i anketuar tjetër nga Rajoni Lindje pohoi se, *“Investimet në rrugë janë bërë në baza ad-hoc, që domethënë se grupet e qytetareve që kanë bërë më shumë presion në zyrtarët publik arritën të përfitojnë nga ata në lidhje me rrugët.”* Së dyti, ishin disa të tjerë nga Rajoni Lindje, të cilët konsideruan se akoma ka hapësirë për përmirësime, veçanërisht kur bëhet fjalë për rrugë rurale dhe brenda qytetit. Siç edhe u theksua nga njeri prej pjesëmarrësve të këtij rajoni, *“Për një distancë 46 km nga Gjilani në Prishtinë, të merr një orë me veturë. Kjo na bënë më pak atraktiv për investime.”*

Pjesëmarrësit në secilin fokus grup vlerësuan se reduktimi i energjisë elektrike përbënte një pengesë të madhe për bizneset në të kaluarën; megjithatë, shumica prej tyre i pranojnë zhvillimet e fundit pozitive. Për shembull, një diskutues nga Rajoni Jug deklaroi, *“Mungesa e energjisë elektrike ka qenë problem për bizneset në tërë Kosovën, por duhet të pajtohemi se situata është duke u përmirësuar.”* Njëkohësisht, një diskutues tjetër nga Rajoni Jug theksoi, *“Sa i përket energjisë elektrike, konsideroj se nuk ka shume hapësirë për anketa për shkak se përgjithësisht ka qenë mirë.”*

Disa (shumë pak) pjesëmarrës nga Rajoni Jug dhe Veri i shfaqen brenat e tyre lidhur me faktin se tarifat e energjisë elektrike ndaj bizneseve janë të larta dhe përbejnë një kosto të lartë për bizneset. Një diskutues

nga Rajoni Veri pohoi, *“Edhe pse furnizimi me energji elektrike është përmirësuar në vitet e fundit, tarifat për biznese janë shumë të larta.”* Në këtë linjë të diskutimit, një diskutues tjetër nga Rajoni Qendër shtoi, *“Bizneset janë të obliguara të paguajnë tarifa më të larta se sa familjet në mënyrë që t’i subvencionojnë faturat e këtyre të fundit. Ky nuk është problem vetëm për bizneset e këtij rajoni, por për bizneset nëpër gjithë territorin e Kosovës.”*

Një diskutues nga Rajoni Veri e potencoi faktin se bizneset e vendeve rurale, vuajnë më shumë nga reduktimet. Ai theksoi, *“Nëse flasim për zhvillimin e bizneseve, duhet të fokusohemi edhe në fshatra. Për shembull, ka fermerë të cilët ballafaqohen me shumë probleme si rezultat i mungesës së energjisë elektrike.”* Një diskutues tjetër nga Rajoni Lindje deklaroi se në vendet malore të largëta nuk ka fare rrjet të energjisë elektrike. Sipas tij, kjo si pasojë e pengon zhvillimin e turizmit, si njërin nga sektorët më premtues të kësaj zone.



Pjesëmarrësit në secilin fokus grup vlerësuan se reduktimet e energjisë elektrike përbënin një pengesë të madhe për bizneset në të kaluarën; sidoqoftë, shumica prej tyre i përshëndeten zhvillimet pozitive të kohëve të fundit.

Te pyetur se a janë bizneset e kënaqura me ujësjellës, pjesëmarrësit e Rajonit Qendër dhe Lindje shprehen brenga të konsiderueshme. Një pjesëmarrës nga Rajoni Qendër, për shembull, raportoi, *“Mungesa e ujësjellësit është një problem thelbësor i këtij rajoni. Ka shumë fshatra që nuk janë të lidhura me sistemin shpërndarës të ujit.”* Një diskutues tjetër nga Novobërda e Rajonit Lindje theksoi, *“Një problem i madh për bizneset e zonës sonë (Novobërdës) është uji i pijshëm, kryesisht për shkak të konfigurimit tonë gjeografik.”* Bizneset e rajoneve të tjera nuk duket të kenë ndonjë sfidë të madhe me ujësjellësin.

Për ta përmbyllur, shumica e pjesëmarrësve nga të gjitha fokus grupet ndanë mendimin se rrugët dhe furnizimi i energjisë elektrike ka përparuar në vitet e fundit; andaj edhe janë më pak preokupuese për bizneset sot. Kjo gjetje është gjithashtu e konfirmuar në rezultatet e anketës në Seksionin 4, ku bizneset

kishin i vlerësuar barrierat e transportimit dhe energjisë elektrike me shumë pak pikë të intensitetit. Rajoni Lindje qëndron ndoshta pak me keq se sa rajonet e tjera sa i përket rrugëve; megjithatë, këto konstatime duhet të interpretohen me kujdes ngase ata që e ndajnë këtë opinion përbejnë një pjesë shumë të vogël të fokus grupit të këtij rajoni. Është e rëndësishme të përmendet se kishte disa diskutues (nga Rajoni Veri, Qendër, dhe Jug), të cilët konsideruan se tarifat e larta të energjisë elektrike dhe jodisponueshmëria e saj dhe rrugëve në zonat rurale krijon disa pengesa për bizneset. Sa i përket, ujësjellësit, përveç Rajonit Qendër dhe Lindje, rajonet e tjera nuk duket të kenë ndonjë problem. Thënë shkurt, kanë qenë disa ndryshime të mira në infrastrukturën e Kosovës përgjithësisht, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në klimën e të berit biznes.

c) Barrierat financiare

Kur u pyetën rreth ndikimit të institucioneve financiare në rritjen e NVM-ve, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht rajonit, poten-

cuan faktin se institucionet financiare nuk ofrojnë kredi të cilat janë mjaft të volitshme për t'i ndihmuar bizneset në ballafaqimin e tyre me sfidat financiare. Së pari, sipas shumicës së pjesëmarrësve, normat e interesit të ofruara nga bankat komerciale nuk janë të favorshme. Për shembull, një pjesëmarrës nga Rajoni Jug deklaroi, "Normat e interesit janë ekstrem të larta; ky fakt nuk vihet në pyetje." Një diskutues tjetër nga Rajoni Lindje raportoi, *"Bankat përfaqësojnë një barrierë të madhe, ratat e interesit janë shumë të larta..."* Se dyti, pjesëmarrësit fajësuan institucionet financiare për mos ofrimin e kredive me të favorshme për bizneset në krahasim me kategoritë e tjera të klientëve. Një pjesëmarrës nga Rajoni Veri theksoi, *"Bankat komerciale nuk e bëjnë dallimin në mes të kredive të bizneseve dhe kredive për ndërtimin e shtëpisë. Që të dyja kanë pothuajse normë të njëjtë interesi."* Se treti, një numër i madhe i pjesëmarrësve shfaqin pikëpamje negative lidhur me kriteret që bizneset duhet përmbushur për ta marrë një kredi biznesi. Përderisa diskutohej kjo çështje një diskutues nga Rajoni Perëndim theksoi, *"Për ta marrë një kredi, bizneset duhet të plotësojnë shumë kërkesa pasi që institucionet financiare në Kosovë janë shumë restriktive kur bëhet fjalë për dhënien e kredive për biznes."*

Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit propozuan se institucionet publike të Kosovës duhet të krijojnë një fond special që garanton kredi për biznese. Ky fond, sipas tyre, do t'i zvogëlonte normat e interesit. Duke e adresuar rastin e normave të larta të interesit, një diskutues nga Rajoni Perëndim theksoi, "Duhet të krijohet një fond shtetëror që do të ndihmojë në zhvillimin e bizneseve." Gjatë këtij diskutimi, një pjesëmarrës nga Rajoni Lindje theksoi, *"Qeveria duhet të ndërtojë një bankë zhvillimore e cila do të ofrojë kredi të lehta për bizneset."* Disa prej diskutuesve të fokus grupeve druajnë se nëse nuk merren hapa në ofrimin e normave të interesit më të besueshme, sistemi herët ose vonë do të kolapsojë. Për shembull, një diskutues nga Rajoni Veri raportoi, *"Duke mos pasur alternativa tjera, shumica e atyre që kanë biznese i kanë marrë më shumë se dy kredi dhe nuk jam i sigurt nëse do jenë në gjendje t'i kthejnë ato."* Një tjetër participant nga Rajoni Jug deklaroi se profiti neto i shumë bizneseve është më i vogël se normat e interesit; si pasojë, bizneset kosovare po hasin në vështirësi t'i kthejnë kreditë e tyre.

Përveç kësaj, ishin disa participant që mbanin pikëpamje të kundërta. Ata ishin të pajtimit se normat e interesit janë të larta, por sipas tyre, sistemi bankar është akoma burim i rëndësishëm i financave për shumë biznese. Për shembull, njeri nga pjesëmarrësit nga Rajoni Jug, i cili kishte punuar në sektorin bankar për ca vite, deklaroi, *"Ndonëse normat e interesit kanë qenë të larta, bankat komerciale kanë luajtur një rol të rëndësishëm për t'i ndihmuar bizneset në kohët e tyre më të vështira, duke qenë si 'lender of last resort'."*

Në përgjithësi, shumica e pjesëmarrësve u pajtuan se kreditë e ofruara për biznese nga institucionet financiare nuk janë pro rritjes së bizneseve. Në të kundërtën, sipas tyre, ato i kufizojnë bizneset me normat tejte të larta të interesit. Shumë prej tyre u pajtuan me faktin se institucionet financiare janë shumë restriktive kur vije tek dhënia e

kredive. Kjo si rezultat, sipas pjesëmarrësve, i pengon bizneset që janë më së shumti në nevojë të marrin kredi. Mendimet konsensuale të pjesëmarrësve sa i përket kësaj pike, janë të kuptueshme, duke pasur parasysh se normat e interesit dhe kostot e tjera financiare të kësaj natyre nuk dallojnë shumë nëpër rajone. Opinionet e pjesëmarrësve të fokus grupeve mbi barrierat financiare ngjasojnë me rezultatet e anketës në Seksionin 5, ku bizneset i perceptuan barrierat financiare si grupin më serioz të barrierave, posaçërisht *'koston e lartë të financimit'*.

d) Barrierat ligjore

Kur u diskutua tema e funksionimit të sistemit gjyqësor dhe relacionit të tij me bizneset, pikëpamje të ndryshme njëkohësisht informative u ceken nga pjesëmarrësit. Paragrafët e radhës i paraqesin pikëpamjet e pjesëmarrësve në lidhje me sistemin gjyqësor.

Një numër i madh i hisedarëve të ftuar në Rajonin Veri, Perëndim, dhe Qendër ndanë mendimin se gjykatat në Kosovë janë tejte jo-eficiente. Një diskutues nga Mitrovica, i cili morri pjesë në fokus grupin e organizuar në Rajonin Veri, theksoi, *"Sa i përket sistemit gjyqësor, Mitrovica ka ngecur prapa pasi që gjykatat e saj nuk janë duke funksionuar; si rezultat, një numër i madh i rasteve kanë mbetur të pazgjidhura."* Duke diskutuar për mungesën e efikasitetit në

sistemin gjyqësor, posaçërisht në relacion me rastet e bizneseve, një pjesëmarrës tjetër i këtij rajoni raportoi, *"Rastet ekonomike janë parë gjithmonë si raste jo të natyrës urgjente; kjo si rezultat ka ndikuar negativisht në bizneset tona."* Për më tepër, një pjesëmarrës nga Rajoni Lindje theksoi, *"Sistemi gjyqësor është problemi kryesor tek bizneset. Bizneset shpesh gjinden në situatë ku është më efikase për ta të paguar ryshfetin se sa ta dërgojnë rastin në gjykatë, pasi që merr 6-7 vite që rasti të zgjidhet."* Një tjetër diskutues nga Rajoni Qendër deklaroi, *"Me stafin e tanishëm i merr 10 vite dhe prapë rastet e tanishme do të mbesin të pazgjidhura."* Thënë shkurt, një numër i madh i pjesëmarrësve të ardhur nga këto tri rajone e potencuan haptas jo-eficiencën e gjykatave.

Për më tepër, sipas disa diskutuesve nga Rajoni Qendër ligjet mbi bizneseve duken shumë të avancuara në letër, por problemi është që institucionet e Kosovës dështojnë në implementimin e tyre. Një diskutues nga ky rajon deklaroi, *"Ne nuk themi se nuk ka ligje; përkundrazi, ekziston një legjislacion që është në harmoni me standardet e Bashkimit Evropian, por problemi është se infrastruktura legale nuk respektohet."*

Përderisa shumica nuk janë të kënaqur me sistemin gjyqësor, kishte ca pjesëmarrës të cilët e theksuan faktin se sistemi gjyqësor është duke u përmirësuar kohëve të fundit. Për shembull, një pjesëmarrës nga Rajoni Lindje raportoi, *"Gjatë viteve të fundit, gjykatat janë bërë më të shpejta" në procesimin e rasteve të tyre, posaçërisht të atyre*



Një numër i madhe i pjesëmarrësve ishin e theksuan rolin negativ që sistemi gjyqësor kishte luajtur në (mos) zhvillimin e NVM-ve.

që lidhen me ekonomi.” Një numër i tyre e përmendën rolin pozitiv që luajti themelimi i Tribunalit Permanent të Arbitrazhit të Kosovës. “Nuk ka shumë biznese që i adresojnë rastet e tyre në tribunalin e arbitrazhit, por lajmi i mirë është se numri është në rritje e sipër. Ky tribunal parashihet të krijojë një avantazh të madh për tërheqjen e investimeve të huaja”, pohoi një pjesëmarrës nga Rajoni Perëndim. Duke mos e përjashtuar rolin pozitiv që ky tribunal mund të ketë në të ardhmen, kishte pjesëmarrës nga Rajoni Veri të cilët e theksuan se bizneset nuk janë duke i adresuar konfliktet në këtë tribunal për shkak të mungesës së besimit. “Fatkeqësisht në mentalitetin tonë akoma qëndron fakti se nëse nuk është gjykatë, konfliktet tona nuk mund të zgjidhen”, deklaroi një pjesëmarrës nga ky rajon. Vlen të ceket se një diskutues e përmendi hapjen e noterive si iniciativë e mire që ka kontribuar në zhvillimin e sistemit.

Një diskutues nga Rajoni Perëndim e sqaroi lidhjen shkakore në mes të mungesës së sundimit të ligjit dhe sektorit bankar. Sipas tij, për shkak se trupi gjyqësor nuk është produktiv në penalizmin e atyre që nuk e paguajnë kredinë, shumë biznese kosovare janë ndikuar duke u dashur të paguajnë norma më të larta të interesit në institucionet financiare që veprojnë në Kosovë.

Ne përgjithësi, një numër i madh i pjesëmarrësve ishin në dijeni për rolin negativ që sistemi gjyqësor kishte luajtur në zhvillimin e NVM-ve në vend. Megjithatë, sipas disa prej tyre e ardhmja duket premtuese, pasi që ka disa iniciative janë ndërmarrë për përmirësimin e sistemit.

e) Barrierat fiskale

Shumica e hisedarëve në fokus grupe ishin të opinionit se, në përgjithësi taksat për biznese janë të një niveli të pranueshëm; andaj janë edhe më pak problematike për zhvillimin e NVM-ve. Duke e përmendur llojet e ndryshme të taksave të aplikuara ndaj bizneseve, një diskutues nga Rajoni Qendër, deklaroi, “...TVSH-ja e Kosovës është me e ulëta në Ballkan. Taksat e tjera, si për shembull, taksa mbi korporata, janë gjithashtu të shumë të ulëta.” Diskutuesit tjerë nga rajonet e tjera mbajnë qëndrime të njëjta; me fjalë tjera, ata u pajtuan me faktin se, mesatarisht, taksat e aplikuara ndaj bizneseve janë më të ulëta në krahasim me vendet fqinje. Përveç kësaj, ata sugjeruan se nuk duhet të ekzistojë një taksë uniforme e TVSH-së, por duhet të bëhet një vlerësim varësisht nga potenciali i biznesit.

Pasi që pjesëmarrësit dinin më shumë për taksat lokale, ata e fokusuan diskutimin e tyre më shumë tek ato lloj taksash. Sipas përgjigjeve të tyre, shumica e komunave në Kosovë i kanë hequr taksat lokale, përderisa shumë pak nga to i detyrojnë bizneset me ndonjë shumë simbolike të taksave, të cilat nuk pengojnë këta të fundit në zhvillimin e tyre.

Disa përfaqësues të bizneseve, në anën tjetër, ndonëse në dijeni për nivelin e ulët të taksave, besojnë se disa prej tyre i pengojnë bizneset e

vogla, pasi që ato e shohin si të vështirë konkurrencën me kompanitë me të mëdha; prandaj, ato propozuan se bizneset e vogla duhet të jenë të liruara nga ato lloj taksash.

Një diskutues nga Rajoni Veri e potencoi problemin e mbledhjes së taksave. Sipas tij, taksat e aplikuara ndaj bizneseve mbledhen në mënyre selektive. Një diskutues nga ky rajon deklaroi, “Disa biznese janë më të privilegjuar sa i përket dhënies së taksave, pasi që ato i financojnë aktivitetet e partive politike.” Sipas përgjigjeve të tyre, mbledhja selektive e taksave ka ndikuar negativisht në klimën e biznesit, duke krijuar hapësirë për konkurrencë jo fer.

Ne përgjithësi, taksat në Kosovë, pavarësisht rajonit, duken të mos kenë ndonjë ndikim negativ të theksuar në zhvillimin e bizneseve. Megjithatë, sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve, duhet të ekzistojë një mekanizëm që e lufton mbledhjen selektive të taksave, kjo si rezultat do ta përmirësojë konkurrencën ndërmjet bizneseve.



Pjesëmarrësit e fokus grupeve kryesisht pohuan se bizneset shumë rrallë paraqiten në debate publike, ndonëse ftohen çdoherë. Arsyeja e neglizhencës së tyre është mungesa e besimit në institucione.

5.2. Marrëdhëniet në mes të bizneseve dhe institucioneve

Nën-seksioni i paraqet pikëpamjet e pjesëmarrësve të fokus grupeve për rolin e institucioneve kosovare në zhvillimin e bizneseve. Me saktësi, ky nën-seksion synon t'i prezantojë perspektivat e pjesëmarrësve të fokus grupeve në përfshirjen e bizneseve në politikë-bërje, mbështetjen financiare të qeverisë qendrore dhe lokale, si dhe rolin e AZHR-ve.

a) Përfshirja e bizneseve në politik-bërje

Kur të ftuarit e fokus grupeve janë pyetur nëse bizneset ishin ftuar gjatë procesit të hartimit të politikave lokale, pothuajse të gjitha thanë që po. “Komuna e Novobërdës përbëhet nga 230 biznese. Të gjitha këto biznese kanë qenë të ftuara kur komuna e ka hartuar strategjinë për zhvillimin e ekonomisë lokale, si dhe për dokumentet të tjera. Bizneset janë ftuar përmes postës elektronike dhe ftesave fizike”, raportoi një pjesëmarrës nga komuna e Novobërdës e Rajonit Lindje.

Problem për pothuajse të gjitha komunat përfaqësuese të cilat morën pjesë në diskutimet e fokus grupeve ishte fakti se bizneset rrallë paraqiten në debatet e organizuara nga komunat, edhe pse ato ftohen. “Edhe pse 540 ftesa janë dërguar tek bizneset për debat publik, vetëm 7 prej tyre morën pjesë në debat”, deklaroi një pjesëmarrës nga një komune e Rajonit Veri. Për më tepër, kishte raste kur bizneset e bojkotuan thirrjen për pjesëmarrje në debate publike. Një diskutues nga një komune e Rajonit Veri raportoi, “Fakti me shqetësues është se, deri me tani, vetëm zyrtarët administrativ të cilët punojnë në komunat tona kanë marrë pjesë në debate.”

Sipas shume zyrtareve komunal, arsyeja e neglizhencës se tyre është mos-besueshmëria në institucione. *“Kjo ndodhë (neglizhencia e bizneseve), sepse shoqëria jonë është akoma e dominuar nga mentaliteti se, pavarësisht bizneset a marrin pjesë në debate apo jo, vendimet do të jenë sipas dëshirës së institucioneve”,* theksoi një pjesëmarrës nga Rajoni Veri. Një diskutues tjetër nga një OJQ në Rajonin Lindje theksoi, *“Bizneset janë të mendimit se të gjitha takimet e organizuara nga komunat janë vetëm improvizime pasi që komunat dëshirojnë të duken kinse janë përfshirëse. Ky perceptim i bizneseve rrjedh nga fakti se asgjë që është propozuar nga bizneset që morën pjesë në takimet e komunave më parë nuk është marrë në konsideratë.”* Njëjtë, një përfaqësues nga Rajoni Jug theksoi, *“Bizneset janë të zhgënjyera pasi që mendojnë se asgjë nuk mund të zgjidhet nga takimet komunale. Ata mendojnë se këto takime organizohen nga komunat vetëm sa për të përmbushur obligimet e tyre formale.”* Në anën tjetër, kishte biznese që fajësuan komunat për mos-qartësinë e tyre në ftesat që u janë bërë bizneseve. Përderisa flitej për një debat të dështuar të organizuar nga një komunë në Rajonin Veri, një përfaqësues komunal raportoi, *“Problemi qëndron tek ne (...) pas diskutimit rreth pjesëmarrjes jo të kënaqshme të bizneseve në takime, ne konkludim se dështuam t’iu qartësojmë bizneseve rëndësinë e takimeve; nuk i bindem ato se pjesëmarrja e tyre dhe sugjerimet e tyre mund të përfundonin në një rregullore më të mirë.”*

b) Niveli i ndihmës financiare nga qeveria qendrore dhe qeveritë lokale

Kur janë pyetur nëse ka pasur ndonjë subvencion shtetëror që ka kontribuar në rritjen e NVM-ve gjatë viteve të fundit, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e kanë cekur se ndihmat kryesisht i jepen sektorit të agrikulturës. *“Ka pasur ndihma prej qeverisë qendrore dhe lokale të dedikuara vetëm për agrobiznese”,* raportoi një pjesëmarrës nga Rajoni Veri. *“Ministria e Bujqësisë është duke i ndihmuar serrat, qumështoret dhe prodhimet tjera bujqësore, gjatë dy vjetëve të fundit. Në lidhje me këtë, ne kemi shënuar progres”,* deklaroi njëri prej pjesëmarrësve nga Rajoni Lindje.

Një numër pjesëmarrësish deklaruan se nuk ishin shumë të kënaqur me kriteret e përzgjedhjes së fituesve të granteve dhe ndihmave bujqësore. Për shembull, një pjesëmarrës nga Rajoni Veri u shpreh: *“Përzgjedhja e granteve bujqësore ka qenë shumë problematike, pasi që ata të cilët kanë vendosur për grante, kanë qenë të njëanshëm. Anëtarët e familjes sime, kanë aplikuar për grante të mundësuar nga Ministria e Bujqësisë, por nuk janë përzgjedhur, përkundër faktit që i kanë përmbushur të gjitha kriteret.”* Për më shumë, sipas një pjesëmarrësi nga i njëjti rajon, grantet bujqësore janë ndarë sipas interesave politike, në vend që të ndaheshin sipas kriterëve transparentë. Megjithatë, sa i përket procesit të përzgjedhjes, disa pjesëmarrës e drejtuari gishtin nga vetë agrobizneset. Sipas tyre, disa fermer nuk ishin në gjendje t’i plotësonin formularët e aplikimit.

Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve, pavarësisht rajonit, raportuan se pothuajse asgjë nuk është bërë nga qeveria qendrore për ti ndihmuar financiarisht NVM-të, e as sektorët tjerë. Njëri prej diskutuesve nga

Rajoni Perëndim deklaroi, *“Qeveria jonë nuk i ka përkrahur asnjëherë bizneset në formë të subvencioneve. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk ka dhënë asnjë ndihmë financiare për t’i ndihmuar bizneset.”* Për më tepër, një pjesëmarrës nga Rajoni Qendër deklaroi, *“Përpos agrikulturës, duhet të subvencionohen edhe sektorët tjerë, siç është sektori i Teknologjisë Informative (IT), meqë nuk janë subvencionuar asnjëherë nga qeveria qendrore.”*

Kur pjesëmarrësit u pyetën nëse kishte subvencione të ndara nga qeveritë komunale gjatë viteve të fundit, shumë pjesëmarrës deklaruan se komunat e tyre i ndihmuan disa biznese, por ata ishin të vetëdijshëm se ndihmat nuk ishin të mjaftueshme për t’i përmbushur nevojat e shumicës së bizneseve. Ata theksuan se buxheti i tyre i limituar, i ka kufizuar ata që të jenë më mbështetës ndaj bizneseve. *“Ndihma financiare e komunave ndaj bizneseve është shumë solide”,* deklaroi njëri pjesëmarrës nga Rajoni Lindje. Duke ju referuar një përfaqësuesi komunal, i cili merrte pjesë në diskutimin e Rajonit Jug, deklaroi, *“Kapaciteti buxhetor nuk i lejon komunat të ju ndihmojnë bizneseve në avancimin e tyre.”*

Rajoni Veri duket se dallon prej rajoneve të tjera sa i përket mbështetjes financiare nga pushtetet e tyre lokale. Pjesëmarrësit në Veri, pavarësisht komunës, theksuan se komunat e tyre kanë mbështetur disa grante për disa firma përkatëse. Për shembull, sipas një pjesëmarrësi nga Rajoni Veri, komuna e tij mundësoi grante për biznese, duke arritur deri në vlerën prej 5000 €. Një pjesëmarrës tjetër i po këtij rajoni, deklaroi se komuna e tij mbështeti rritjen e NVM-ve, duke hartuar një skemë për biznese, e cila punësoi më shumë se 10 punëtorë.

Ja vlen të përmendet se kishte disa pjesëmarrës që deklaruan se komunat e tyre kanë shërbyer si urë lidhëse ndërmjet organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve. *“Komuna ime ishte ndërmjetësuese e donacioneve ndërkombëtare dhe bizneseve. Kjo ishte ndihma e vetme që mund të jepnim bizneseve, duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara financiare”,* deklaroi një përfaqësues komunal nga Rajoni Perëndimor.

Në përgjithësi, rezultatet e fokus grupit tregojnë se përpos subvencioneve/granteve bujqësore, bizneset janë lënë anash nga pushteti lokal dhe qeverisja qendrore.

c) AZhR-të dhe roli i tyre

Kur u pyetën pjesëmarrësit e fokus grupit për rëndësinë e AZhR-ve, të gjithë shprehën mirënjohjen e tyre për ndihmën e ofruar nga AZhR-të e tyre përkatëse. Megjithatë, ata nuk mund ta lidhnin atë shumë me biznese. Në vazhdim, janë disa prej deklaratave të tyre lidhur me rolin e AZhR-ve:

“Bashkëpunimi me AZhR-të ka qenë i frytshëm. Anëtarët e stafit të AZhR-së, kanë shprehur vullnetin e tyre për të na ndihmuar, varësisht prej kërkesave dhe nevojave tona. Deri tani, ne kemi bashkëpunuar në projektimin, implementimin dhe hartimin e strategjive komunale.” (Rajoni Lindje)

"AZhR-ja ka funksionuar mjaft mirë në mbështetjen që i ka dhënë komunave, po ashtu duke vepruar edhe si urë lidhëse mes bizneseve. AZhR-ja jonë ka kryer një punë profesionale, por ende ka hapësirë për përmirësim." (Rajoni Lindje)

"Për këtë periudhë, ne kemi aplikuar për disa projekte dhe AZhR-ja nuk ka hezituar asnjëherë të na ofrojë ndihmë dhe mbështetje në hartimin e aplikacioneve." (Rajoni Veri)

"Është i padiskutueshëm fakti që AZhR-të duhet të vazhdojnë të operojnë. Personalisht, kam pasur një kooperim të frytshëm me AZhR-të. Kemi pasur projekte konkrete që i kemi implementuar së bashku. Shpresoj që AZhR-të, do të zgjerojnë aktivitetet e tyre dhe do të rrisin numrin e stafit." (Rajoni Veri)

"Grantet e pranura prej BE-së kanë qenë të asistuar nga BE-ja." (Rajoni Perëndim)

5.3. Vlerësimi i strategjive zhvillimore rajonale

Në 2009-ën, hisedarët, ekonomistët, duke përfshirë përfaqësues komunalë, përfaqësues të asociacioneve të bizneseve, dhe ndërmarrje të udhëhequra nga AZhR-të, hartuan pesë strategji zhvillimore (një për çdo rajon) për periudhën 2010-2013. Këto strategji, mes tjerash, listuan një numër prioritetesh socio-ekonomike, që duhej adresuar në periudhën e caktuar. Në mënyrë që të vlerësoheshin në formë kuantitative nëse këto prioritete ishin realizuar përgjatë viteve të parapara, pjesëmarrësve të fokus grupeve iu kërkua që të vlerësojnë çdo prioritet me notën 1 deri në 5. Prej vlerësimeve të tyre, duke përdorur të njëjtën metodologji të shpjeguar në kapitullin e anketës, intensitetet të klasifikuara prej 20-100, u gjeneruan. Një vlerësim prej 20 nënkupton që prioriteti nuk është adresuar fare; përderisa, vlerësimi 100 nënkupton që prioriteti është adresuar plotësisht.

Strategjia zhvillimore për Rajonin Qendër përfshin prioritet në vazhdim: (1) përmirësimin e konkurrencës biznesore; (2) përmirësimin e fuqisë punëtore dhe ngritjen e punësimit; (3) përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve dhe ambientit. Sipas përgjigjeve të pjesëmarrësve në fokus grupe, prioriteti i parë është adresuar bashkë me dy prioritetet tjera. Për të qenë më specifik, prioriteti i parë, për nga intensiteti u notua me notën 72, përderisa dy prioritetet tjera u notuan me notat 64 respektivisht 62 (shih Tabelën 13). Në përgjithësi, mund të thuhet se deri diku është punuar në adresimin e këtyre prioriteteve, por ende ka shumë hapësirë për t'u bërë më shumë në të ardhmen.

Prioritetet të përfshira në strategjinë zhvillimore për Rajonin Lindje janë: (1) zhvillimi ekonomik rajonal; (2) zhvillimi i infrastrukturës ekonomike; (3) zhvillimi i resurseve njerëzore; (4) fuqizimi institucional, ndërkombëtar, si dhe bashkëpunimi dhe integrimi ndërkombëtar dhe ndërrajonal. Rezultatet e fokus grupeve, tregojnë se këto prioritete kanë mbetur në masë të madhe të pa adresuara. Secila prej tri prioriteteve të para, është notuar (vlerësuar) me notën 58.3. Intensiteti për prioritetin e fundit është lehtësisht më i ulët, 56.4 (shih Tabelën 14). Rezultatet tregojnë që katër prioritetet e identifikuara janë adresuar pjesërisht.

Kontribuesit e strategjisë zhvillimore rajonale për Rajonin Jug, janë pajtuar për prioritetet në vazhdim: (1) zhvillimi i mjedisit biznesor; (2) zhvillimin i agrikulturës dhe industrisë përpunuese të ushqimit; dhe (3) zhvillimi i turizmit. Të anketuarit e këtij rajoni duket se janë të pakënaqur me realizimin e prioriteteve. Prioriteti i parë është vlerësuar me notën 62.2; i dyti me 57.8, dhe i treti me notën 53.3 (shih tabelën 15).

Tri prioritetet që janë të përfshira në strategjinë zhvillimore të Rajonit Perëndim janë: (1) krijimi i kushteve për rritje ekonomike të qëndrueshme; (2) stimulimi i një baze inventive dhe konkurruese biznesore; (3) zhvillimin e kapitalit njerëzor të Kosovës për qëndrueshmëri; dhe (4) zhvillimi i qëndrueshëm i bazuar në komunitet. Prioriteti i dytë dhe i tretë, u vlerësua me notën e njëjte të intensitetit: 50. Prioriteti i parë, për nga intensiteti u vlerësua lehtësisht më lartë (52.5); përderisa,

Tabela 13.

Prioritetet dhe pikët e intensitetit në Rajonin Qendër

● Prioritetet - Rajoni Qendër



1 Përmirësimi i konkurrencës biznesore



2 Përmirësimi i fuqisë punëtore dhe ngritjen e punësimit



3 Përmirësimi i infrastrukturës, shërbimeve dhe ambientit


BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Tabela 14.

Prioritetet dhe pikët e intensitetit në Rajonin Lindje



Prioritetet - Rajoni Lindje




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Tabela 15.

Prioritetet dhe pikët e intensitetit në Rajonin Jug



Prioritetet - Rajoni Jug



SOURCE: AUTHOR'S OWN CALCULATIONS FROM THE SURVEY DATA

Tabela 16.

Prioritetet dhe pikët e intensitetit në Rajonin Perëndim



Prioritetet - Rajoni Perëndim



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Tabela 17.

Prioritetet dhe pikët e intensitetit në Rajonin Veri



Prioritetet - Rajoni Veri



1

Zhvillimi i një rajoni ekologjikisht të pranuar me shfrytëzim racional të resurseve natyrore



2

Përmirësimi i konkurrencës së mjedisit biznesor



3

Zhvillimi i produkteve bujqësore, shërbimeve dhe industrisë prodhuese



4

Fuqizimi i resurseve njerëzore dhe ngritja e punësimit.

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

prioriteti i katërt u vlerësua me notë lehtësisht më të ulët (45) (shih Tabelën 16). Sipas këtyre rezultateve, shumë pak përpjekje është bërë në adresimin e këtyre prioritetëve.

Në strategjinë zhvillimore të Rajonit Veri janë përfshirë prioritet në vazhdim: (1) zhvillimi i një rajoni ekologjikisht të pranuar me shfrytëzim racional të resurseve natyrore; (2) përmirësimi i konkurrencës së mjedisit biznesor; (3) zhvillimi i produkteve bujqësore, shërbimeve dhe industrisë prodhuese; dhe (4) fuqizimi i resurseve njerëzore dhe ngritja e punësimit. Rezultatet për këtë rajon janë të ngjashme me rezultate e rajoneve tjera, duke treguar se shumë pak përpjekje është bërë për t'i adresuar të katër prioritet. Prioriteti i parë, mori notën vlerësuese për intensitet 62, i dyti 58, i treti 55, dhe i katërti 53 (shih tabelën 17).

5.4. Sektorët me potencial për rritjeje

Ky seksion vë në dukje përgjigjet kuantitative të pjesëmarrësve të fokus grupeve në lidhje me potencialin ekonomik të sektorëve në gjithë Kosovën, si dhe në rajonet e saj. Një listë prej nëntë sektorësh (turizmi, bujqësia, përpunimi i drunjëve, përpunimi i ushqimit, shitja me shumicë dhe pakicë, industria elektronike, ndërtimtaria, tekstili, dhe tregu i patundshmërisë), i është dhënë pjesëmarrësve, dhe prej tyre është kërkuar që të vlerësojnë me notën prej 1-5, ku nota 1, përfaqëson potencialin më të ulët të rritjes, përderisa nota 5 përfaqëson potencialin më të lartë. Për shkak t'i renditur këta sektorë, janë gjeneruar shkallë intensitetit të shtrira prej 20 në 100. Sa më i lartë intensiteti, aq më e madhe pritshmëria për potencialin e rritjes të një sektori të caktuar. Duke pasur parasysh se këto rezultate përfaqësojnë vetëm 50 pronarë biznesesh, rezultatet duhet të interpretohen me kujdes.

Rezultate e fokus grupeve tregojnë se, mesatarisht, në të ardhmen e afërt, sektori më premtues në Kosovë do të jetë agrikultura. Pronarët e bizneseve të intervistuar e vlerësuan këtë sektor me notën e intensitetit, 87.1. Megjithatë, rezultatet nuk janë të befasishme, duke pasur parasysh se afërsisht 53% e sipërfaqes tokësore në Kosovë është tokë bujqësore (10% pikë më shumë se Maqedonia, për shembull) (MTI 2014). Sektori i bujqësisë ndiqet nga industria e turizmit dhe ajo e përpunimit të mishit, afërsisht me 76, respektivisht 73 pikë të intensitetit. Në fund të listës është patundshmëria, me një mesatare pikësh prej 52, rezultat i cili pak a shumë pritej, duke pasur parasysh faktin që tregu për këtë sektor është i ngopur.

Sipas perceptimit të pjesëmarrësve, sektorët më premtues për rajon, janë si në vazhdim. Në Rajonin Qendër, agrikultura pritet të jetë sektori më premtues me 93 pikë, e ndjekur nga përpunimi ushqimor (78), industria elektronike (74), dhe përpunimi i drunjëve (74). Po ashtu, edhe në Rajonin Lindje, agrikultura do të jetë sektori më premtues me 93 pikë, e ndjekur nga përpunimi ushqimor dhe turizmi 80 pikë secila, si dhe shitja me pakicë dhe shumicë me 75 pikë. Në Rajonin Qendër, prapë agrikultura është projektuar që të jetë sektori me potencialin më të lartë për rritje me 80 pikë, e ndjekur nga turizmi (78), dhe ndërtimtaria (73). Në Rajonin Veri, agrikultura duket të jetë sektori më premtues me 85 pikë, e ndjekur nga ndërtimtaria (74), dhe përpunimi i drunjëve (71). Për dallim nga katër rajonet tjera, në Rajonin Perëndim, turizmi pritet që të jetë sektori me potencialin më të madh për rritje, me 86 pikë, i ndjekur nga agrikultura (85), dhe industria elektronike (71). Pikët e sakta të intensiteteve për çdo sektor, gjenden në Tabelën 18.

Rezultatet e fokus grupeve zbulojnë se përveç granteve/subvencioneve në bujqësi, bizneset janë neglizhuar në masë të madhe nga qeveria qendrore dhe lokale.

Prioritetet e përfshira në strategjitë rajonale janë adresuar pjesërisht.

TABELA 18:

POTENCIALI I SEKTORËVE KOSOVARË

NË TË ARDHMEN E AFËRT

(SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)

BURIMI: KALKULIMET E

AUTORËVE NGA TË DHËNAT

E ANKETËS

		Kosova	Qendër	Lindje	Jug	Veri	Perëndim
	Bujqësia	87	93	93	80	82	85
	Turizmi	76	70	80	78	64	86
	Përpunimi i ushqimit	73	78	80	71	69	65
	Përpunimi i drunjëve	68	74	70	60	71	63

		Kosova	Qendër	Lindje	Jug	Veri	Perëndim
	Shitja me shumicë dhe pakicë	68	75	71	64	55	85
	Ndërtimtaria	67	64	68	73	74	53
	Industria elektronike	61	74	55	49	55	71
	Tekstili	53	68	52	38	60	43
	Tregu i patundshmërisë	52	46	52	58	60	50



Pjesëmarrësit e fokus grupeve zbuluan se bujqësia është sektori më premtues për të ardhmen e afërt në të gjitha rajonet.”

KONKLUZIONI DHE REKOMANDIMET

Ky raport e vlerëson në tërësi klimën e biznesit në Kosovë, si dhe në pesë rajonet e saj ekonomike. Kjo temë ekzaminohet në tri periudha kohore: të kaluarën (2009-2012), të tashmen (2013) dhe në të ardhmen (2014-2017). Sa i përket metodologjisë, së pari raporti mbështetet në të dhëna kuantitative, ku është realizuar një anketë me 1000 biznese (200 për rajon). Anketa është realizuar vetëm me menaxherë biznesesh ose pronarë kompanish në mënyrë që të dhënat e mbledhura të jenë më shumë të besueshme. Përpos kësaj, raporti mbështetet në të dhëna kualitative, ku stafi i Riinvest-it ka aranzhuar 5 diskutime në fokus grupe (një për çdo rajon) me zyrtarë komunal, përfaqësues të shoqërisë civile, asociacione të bizneseve, media etj.

Performanca e bizneseve është vlerësuar duke u bazuar në: trendin e qarkullimit, marzhën neto të fitimit, numrin e punëtorëve, dhe trendin e pagave – të dhëna këto të mbledhura gjatë anketimit. Sa i përket qarkullimit në katër vitet e fundit, të gjeturat nga anketa sugjerojnë se afërsisht 56 përqind e bizneseve deklarojnë se shitjet e tyre janë ngritur ose kanë mbetur të njëjta.

Në anën tjetër, rreth 44 përqind deklarojnë se shitjet e tyre kanë pësuar rënie. Në këtë drejtim, Rajoni Veri dhe Rajoni Qendër kanë performuar më së miri, përderisa Rajoni Jug dhe Lindor, dhe në veçanti Rajoni Perëndim kanë performuar më keq. Kur janë pyetur për pritshmërinë e shitjeve në katër vitet e ardhshme, 76.2 përqind të bizneseve të anketuara presin që të performojnë me ritëm të njëjte, ose edhe më mirë; përderisa bizneset e mbetura, besojnë se do të kenë rënie. Në këtë drejtim, krahasuar me rajonet tjera, Rajoni Veri pritet që të performojë më së miri.

Të gjeturat e anketës tregojnë se marzha neto e fitimit për bizneset kosovare për periudhën momentale është 22.2 përqind. Në këtë aspekt, të gjitha rajonet ekonomike duket të jenë afër mesatares shtetërore. Rezultatet po ashtu dëshmojnë se numri mesatar i punëtorëve në kompanitë kosovare është 6.8 – që i bie ngritje për 1 punëtor në mesatare, krahasuar me vitin 2009. Kjo mesatare pritet që të ngritet në katër vitet e ardhshme, specifikuat në 8.7. Krahasuar me mesataren shtetërore, numri mesatar i punëtorëve është më i madh në Rajonin Qendër.

Sa i përket shqetësimeve rreth pagave të punëtorëve rezultojnë se paga mesatare mujore në bizneset kosovare qëndron rreth 228 €. Shumica apo 52 përqind e pronarëve të intervistuar treguan se nuk kishte ndonjë ndryshim në nivelin e pagave gjatë katër vjetëve të fundit; ndërsa 35 përqind deklaruan se i kanë ngritur pagat e punëtorëve të tyre. Bizneset e Rajonit Qendër dhe Veri duket të kenë ngritur nivelin e pagave të punëtorëve më shumë se rajonet tjera. Në fund, rreth 91 përqind e pronarëve/drejtimesve presin që t'i rrisin pagat e punëtorëve

ose t'i mbajnë njëjta, përderisa vetëm 9 përqind presin që t'i ulin. Rajoni Qendër rezultojnë të jetë rajoni me përqindjen më të lartë të bizneseve që presin t'i ulin pagat.

Një pjesë e rëndësishme e këtij raporti është analiza e barrierave të të bërit biznes. Bizneset e intervistuar në këtë anketë janë pyetur që ta vlerësojnë ashpërsinë e 23 pengesave potenciale në fillimin dhe zhvillimin e biznesit. Pengesat mund të dallojnë për nga intensiteti, prej 20 (minimumi), deri në 100 (maksimumi); ku rezultatet më të larta nënkuptojnë se ndikimi negativ është më serioz ndaj bizneseve.

Të gjeturat e anketës në nivel kombëtar, tregojnë që *'kostoja e lartë e financimit'*, prin në listën e pengesave të perceptuara, pasuar nga *'korrupsioni'*, *'mungesa e subvencioneve shtetërore'*, *'konkurrenca jo-fer'*, dhe *'sistemi gjyqësor jo-efiçent'*. Rezultatet e intensitetit tregojnë se këto pesë barrierat, janë shumë sfiduese për fillimin dhe zhvillimin e bizneseve. Kompozicioni i njëjta e barrierave, me radhitje të njëjta shfaqet edhe në vitin 2009, ndonëse me pikë më të larta të intensitetit. Radhitja e këtyre barrierave është projektuar të jetë e njëjta në të ardhmen e afërt; megjithatë, është inkurajues fakti që pikët e intensitetit pritet të ulen, që do të thotë se do të bëhen më pak shqetësuese për rritjen e bizneseve.

Një karakteristikë e dukshme e radhitjes së përgjithshme të pengesave në barrierat infrastrukturore si, *'mungesa e energjisë elektrike'*, *'infrastruktura jo e favorshme e transportit'*, dhe *'telekomunikacioni jo-adekuat'*, është fakti se kanë shënuar përmirësimin më të madh gjatë katër vjetëve të fundit. Përmirësimi i tillë, është rezultat direkt i orientimit qeveritar drejt infrastrukturës dhe sektorit energjetik në Kosovë. Barrierat financiare, posaçërisht *'kostoja e lartë e financimit'* dhe *'qasja e kufizuar në financa'*, pritet të shënojnë përmirësimin më të madh në vitet në vazhdim. Barrierat infrastrukturore, në anën tjetër, pritet të lëvizin më së paku, gjë e cila është e kuptueshme, duke pasur parasysh që veçse janë pengesa minore.

Për shkak të normave të larta të interesit, në mesin e barrierave financiare, *'kostoja e lartë e financimit'*, është perceptuar të jetë më sfiduesja gjatë tri periudhave kohore të studimit. Prej pengesave lidhen me informalitetin, rezultojnë se bizneset shpesh konfrontohen me *'korrupsion'* dhe *'konkurrencë jo-fer'*. Zbërthimi i rezultateve për nga rajoni tregon se bizneset e Rajonit Perëndim vuajnë më së shumti prej këtyre fenomeneve informale. Në listën e barrierave fiskale, 'taksat e larta' besohet të jetë barrierat më serioze nga bizneset e anketuara në të gjitha rajonet ekonomike, si dhe përgjatë gjithë periudhave të studimit. Në mesin e barrierave ligjore, *'sistemi gjyqësor jo-efiçent'* duket të jetë sfida më e madhe për bizneset gjatë tri periudhave kohore. Në listën e barrierave institucionale, *'mungesa e subvencioneve*

shtetërore’ duket të jetë çështja më shqetësuese për bizneset në të gjitha rajonet deri më tani.

Barrierat e ndërlidhura me fuqinë punëtore dhe infrastrukturën (p.sh. *‘mungesa e motivimit tek punëtorët’, ‘telekomunikacioni jo-adekuat’*), pozicionohen në fund të listës; asnjëra prej tyre nuk paraqet sfidë për bizneset e intervistuar. Ja vlen të përmendet që, pavarësisht asaj se sa të ashpra janë barrierat momentalisht, të gjitha priten të bëhen më pak problematike në katër vitet e ardhshme.

Ky studim, po ashtu pasqyron se si bizneset i konsiderojnë shërbimet të mundësuar nga qeveria, komunat dhe AZhR-të e tyre. Rezultatet në nivel kombëtar tregojnë se më shumë se 50 përqind prej tyre i perceptojnë shërbimet si të dobëta ose shumë të dobëta. Bizneset e Rajonit Perëndim duket të jenë më së paku të kënaqura me shërbimet e ofruara nga komunat e tyre përkatëse. Për më shumë, shumica e bizneseve të anketuara, 78 përqind, deklaruan se mbështetja (p.sh. subvencionet, lirimi nga taksat, etj) e dhënë nga komunat e tyre apo qeveria, në katër vitet e fundit nuk ka kontribuar në zhvillimin e NVM-ve.

Përqindja më e lartë është në Rajonin Jug. Të gjeturat tregojnë se më shumë se 93 përqind e bizneseve të intervistuar kanë deklaruar se ato nuk kanë pranuar asnjëherë ndonjë ftesë nga komunat e tyre kur janë hartuar politika biznesore, duke lënë të kuptohet se debatet publike janë organizuar rrallë nga komunat e tyre, për të mos thënë asnjëherë. Zbërthimi i të gjeturave për rajone tregon se komunat e Rajonit Qendër, Lindje dhe Perëndim janë më së paku përfshirëse sa i përket projektimit të politikave biznesore. Në fund, shumica e bizneseve, rreth 68 përqind, kanë perceptuar shërbimet e ofruara nga AZhR-të e tyre përkatëse, si të dobëta, ose shumë të dobëta. Rajoni Jug, duket të jetë rajoni me proporcionin më të lartë të bizneseve që janë të pakënaqur me shërbimet e ofruara nga AZhR-të. Rreth 64 përqind e kompanive të anketuara sugjerojnë që AZhR-të nuk kanë ndonjë ndikim në rritjen e NVM-ve. Rezultatet përgjatë rajoneve nuk dallojnë shumë prej mesatares shtetërore.

Barrierat e të bërit biznes, po ashtu, janë trajtuar në diskutimet e zhvilluara në fokus grupe. Sa i përket barrierave të ndërlidhura me fuqinë punëtore, një shumicë dërrmuese e pjesëmarrësve, pavarësisht rajonit, shprehën shqetësimet e tyre me nivelin e edukimit dhe aftësive të punëtorëve. Sipas tyre, punëtorët, nuk kanë kualifikime të mjaftueshme, për t’i përmbushur kërkesat e tregut. Sa i përket barrierave infrastrukturore, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit kanë qenë mirënjohës ndaj investimeve qeveritare në infrastrukturën kapitale gjatë viteve të fundit. Gjatë diskutimit të barrierave financiare, shumica e pjesëmarrësve pruan faktin që institucionet financiare nuk lëshojnë kredi që janë të volitshme për t’i ndihmuar kompanitë, që t’i tejkalojnë sfidat e tyre financiare. Kur janë pyetur që të diskutojnë ndikimin e pengesave biznesore të ndërlidhura me sistemin juridik, një numër i madh i pjesëmarrësve në fokus grupe ishin të vetëdijshëm për ndikimin negativ. Megjithatë, sipas disa pjesëmarrësve, gjendja dukej inkurajuese pasi që disa iniciativa për të përmirësuar sistemin veçse ishin ndërmarrë.

Për më shumë, diskutimet në fokus grupe mbuluan një temë që trajton marrëdhëniet mes bizneseve dhe institucioneve. Kur pjesëmarrësit u pyetën nëse bizneset ishin ftuar që të diskutonin hartimin e politikave biznesore, një shumicë e tyre thanë po.

Sipas pjesëmarrësve, bizneset e ftuara shumë rrallë marrin pjesë në debate, dhe kjo ndërlidhet me mungesën e besimit në institucione. Kur është diskutuar mbështetja financiare e dhënë ndaj bizneseve nga qeveria dhe komunat e tyre, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit theksuan që subvencionet financiare u janë dhënë kryesisht sektorit të bujqësisë. Sa i përket AZhR-ve, të gjithë pjesëmarrësit në diskutimet në fokus grupe shprehën mirënjohjen e tyre për mbështetjen teknike të dhënë nga AZhR-të e tyre përkatëse. Megjithatë, ata nuk mund ta ndërlidhnin shumë me zhvillimin e bizneseve kosovare.

Në fund, pjesëmarrësit në fokus grupe i diskutuan sektorët me potencialin më të madh për rritje. Rezultatet tregojnë se sektori i agrikulturës është sektori më premtues për të ardhmen e afërt në të gjitha rajonet.

Në linjë me të gjitha anketat e realizuara, dhe rezultatet e fokus grupeve të prezantuara në këtë studim, në vazhdim ekipi i Riinvest-it i prezanton disa rekomandime. Keni parasysh se në rastet e barrierave në biznes, rekomandimet janë dhënë vetëm për grupin e barrierave që dolën të jenë më seriozet për bizneset kosovare.

Për barrierat financiare

- Barrierat financiare të shtyra nga kostoja e lartë e financimit dhe qasja e kufizuar në financim, mund të zvogëlohen duke e funksionalizuar sistemin kadastral. Kjo do ta bënte ekzekutimin e kolateralit të premtuar dhe hipotekës më pak problematike.
- Gjykatat duhet të rrisin numrin e gjykatësve në mënyrë që t’i shpejtojnë paditë e ngritura nga institutet financiare. Rreziku i pamundësisë së ekzekutimit të kolateralit për shkak të jo efikasitetit të gjykatave përkthehet në norma të larta interesi për klientët. Prandaj, kjo reformë ka shumë të ngjarë që do të ndikojë në uljen normave të interesit, pasi që institucionet financiare do ta kuptojnë që rastet në gjykata do të zgjidhen në periudhë shumë më të shkurtë kohore.
- Banka Qendrore e Kosovës duhet t’i lehtësojë kriteret për licencimin e institucioneve të reja financiare. Themelimi i institucioneve të reja financiare me gjasë të madhe do të ndikonte në uljen normave të interesit, meqë konkurrenca në këtë sektor do të rritet.
- Qeveria e Kosovës, OJQ-të, universitetet dhe institucionet tjera kompetente duhet të shikojnë mënyra për të mundësuar trajnime për mbajtjen e financave për ndërmarrësit

kosovarë. Kjo do t'iu mundësonte ndërmarrësve të jenë më të saktë dhe bindës kur aplikojnë për kredi biznesi në institute financiare.

- Kapitali i mbledhur prej procesit të privatizimit duhet të vihet në qarkullim përmes themelimit të një banke zhvillimore, roli kryesor i së cilës do të duhej të jetë facilitimi rritjes së NVM-ve kosovare.
- Qeveria duhet të punojë në zvogëlimin e rrezikut të përgjithshëm të mjedisit biznesor, përmes përmirësimit të gjykatave, luftimit të ekonomisë informale, evitimit të mbajtjes së librave të dyfishtë etj.

Për barrierat që lidhen me informalitetin

- Qeveria duhet të bëjë më shumë përpjekje në zhvillimin e një inspektorati më efektiv dhe efikas për tatime. Po ashtu, duhet të sigurojë që ky organ do të funksionojë në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse. Në këtë mënyrë do të shmangej trajtimi i njëanshëm ndaj disa bizneseve, gjë që e ushqyer konkurrencën jo-fer dhe informalitet në përgjithësi.
- Qeveria e Kosovës duhet të adaptojë dhe të zbatojë politika serioze për anti-korrupsion. Këto politika do ta zvogëlonin evazionin fiskal, duke e rritur bashkëpunimin vullnetar dhe performancën e mekanizmave zbatues.
- Qeveria duhet të themelojë një trup financiar policor, ekskluzivisht përgjegjës për evazionin fiskal dhe çështjet tjera informale.
- Qeveria, po ashtu, duhet të përmirësojë lidhjen mes të hyrave të mbledhura dhe atyre të shpenzuara. Kjo do të nxisë reagim pozitiv nga taksapaguesit ndaj qeverisë dhe institucioneve tjera përkatëse.
- Administrata tatimore duhet të rrisë edhe më shumë dënimet për kompanitë jo bashkëpunuese. Kjo do të zvogëlojë mundësinë e kompanive për të operuar në formë informale.
- Auditimi duhet të fokusohet shumë në sektorët që përshijnë norma më të larta të transaksioneve të mjeteve financiare. Në sektorë të tillë, obligimet legale për posedimin e faturave nga konsumatorët do të mundësonin pjesëmarrjen dhe efikasitetin më të lartë të inspektorëve tatimor.
- Kritikët dhe mendimtarët publikë duhet të përdorin instrumente si morali, për të përmirësuar përqindjen e grumbullimit të taksave. Shmangësit e tatimeve, mash-

truesit dhe zyrtarët e korruptuar, duhet të trajtohen ndryshe publikisht, në mënyrë që të dekurajojnë aktet e turpshme në të ardhmen.

- Industritë më të ndjeshme, ku mos raportimi i punëtorëve është më i dukshëm, duhet të vihen në shënjestër. Në këtë rast, veprimi duhet të jetë korrekt dhe i balancuar për të gjitha industritë, për të siguruar që produktiviteti industrial nuk bie për pasojë.

Për barrierat fiskale

- Qeveria duhet të zvogëlojë barrën tatimore, jo domosdoshmërisht duke i zvogëluar normat e taksave, por duke i zvogëluar shpenzimet shtesë të ndërlidhura me pagesat tatimore si: raportimi i kostove, kostot burokratike, etj. Disa prej këtyre kostove krijojnë hapësirë për sjellje korruptive nga zyrtarët.
- Institucionet e Kosovës duhet të punojnë më shumë në harmonizimin e produkteve/shërbimeve me standarde ndërkombëtare. Harmonizimi i standardeve do ta lehtësonte rrjedhën e mallrave dhe shërbimeve mes Kosovës dhe shteteve tjera.

Për barrierat ligjore

- Qeveria dhe OJQ-të tjera të cilat merren me sundimin e ligjit duhet të angazhohen më shumë në kampanja që e ngritin vetëdijen për arbitrazhin i themeluar rishtas në Kosovë dhe për mundësitë tjera ndërmjetësuese.
- Numri i gjyqtarëve duhet të ngritet në mënyrë që të përmirësohet eficaenca në sistemin gjyqësor, si dhe të zvogëlohet kohëzgjatja e rasteve që lidhen me bizneset.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të avokojë më shumë për sigurimin e objekteve më të mira, pagave më të larta për gjyqtarë, si dhe për resurse tjera të nevojshme për gjykatat (p.sh. numër adekuat të sallave gjyqësore).
- Duhet të themelohet një sistem menaxhues i të dhënave që do të përdorej për ta përmirësuar eficaencën, transparencën dhe llogaridhënien në sistemin tonë gjyqësor, sidomos tek gjykata komerciale. Sistemi do të përdorej për t'i përcjellë dhe monitoruar rastet që lidhen me bizneset dhe të dhënat tjera relevante.

Për barrierat që lidhen me fuqinë punëtore

- Universitetet/Kolegjet në Kosovë, qoftë publiket, qoftë privatet, duhet të punojnë në përputhje me plan programeve të tyre, me nevojat e tregut, pasi që ka një mospërputhje të madhe mes këtyre dyjave. Si rezultat, bizneset do të mund të gjejnë punëtorë që janë të aftë të kontribuojnë menjëherë në punë, pa pasur nevojë për trajnim paraprak.
- Një sistem profesional edukimi dhe trajnimi duhet të krijohet, meqë sistemi aktual nuk është në të njëjtën vijë me nevojat e tregut të punës. Si pasojë, të trajnuarit profesional do të jenë në gjendje që t'i përbushin kualifikimet e kërkuara nga tregu i punës.
- Qeveria dhe OJQ-të të cilat merren me të drejtat e punëtorëve duhet të ofrojnë trajnime për pronarët dhe drejtuesit e bizneseve në lidhje me rëndësinë e motivimit të punëtorëve, duke pasur parasysh që mungesa e motivimit kufizon operacionet ditore të bizneseve.

Për barrierat institucionale

- Qeveria e Kosovës duhet të skicojë skema për grante/subvencione në mënyrë që a inkurajojë zhvillimin e sektorëve me potencial të lartë zhvillimor. Veç kësaj, duhet t'i mbrojë ato biznese vendore që duhet të konkurrojnë me bizneset që importojnë nga shtetet tjera dhe që përfitojnë nga subvencionet shtetërore.
- Qeveria duhet të projektojë skema investimi, varësisht nga sektori, numri i punëtorëve dhe qarkullimi.

Për marrëdhëniet mes bizneseve dhe institucioneve

✓ *Për shërbime, transparencë, dhe mbështetje financiare ndaj komunave*

- Komunitet në Kosovë duhet t'i trajnojnë punëtorët e tyre në mënyrë që t'i bëjnë më të përgjegjshëm ndaj nevojave të bizneseve. Gjithashtu, punëtorët komunal që merren me biznese duhet të vlerësohen vazhdimisht, për t'u siguruar që janë duke i kryer detyrat në kohë dhe mënyrë të duhur.

- Komunitet duhet të jenë më përfshirëse kur hartojnë politika për bizneset. Takimet bashki⁵ mund të jenë një mënyrë për t'i përfshirë bizneset në hartimin e politikave për ta.

- Komunitet duhet të konsiderojnë hapjen e zyrave të NVM-ve dhe atyre investuese të përbëra nga ekspertë, të cilët çdo vit e vlerësojnë tregun e Kosovës, i identifikojnë sektorët me rritje të lartë potenciale, dhe hartojnë skema stimuluese për ta. Në këtë mënyrë, komunitet do të jenë më aktive në mbështetjen dhe themelimin e NVM-ve.

✓ *Për mbështetjen financiare të mundësuar nga qeveria:*

- Qeveria, përmes një politike të detajuar dhe konkrete, duhet të hartojë një strategji industriale, ngjashëm si shtetet tjera të Ballkanit. Duhet të jetë një strategji në formën e një kornize përfshirëse, që merr parasysh pikëpamjet e bizneseve, hartuesve të politikave dhe akademisë. Jashtë kësaj strategjie shtetërore, programe mbështetëse të koordinuara mund të hartohen.
- Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës, e në veçanti Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, duhet të përpilojë skema stimuluese investimi, që mbështesin financiarisht aktivitete të caktuara të kompanive, që planifikojnë të bëjnë investime të mëdha. Po ashtu, ata duhet të japin subvencione varësisht prej numrit të vendeve të punës të krijuara.

✓ *Për shërbimet e AZhR-ve dhe mbështetjen e rritjes ekonomike:*

- AZhR-të duhet ta promovojnë më shumë rolin e tyre tek bizneset, pasi që duket se një numër i madh i këtyre të fundit nuk është njoftuar rreth benefiteve që ata mund t'i marrin nga këto agjenci. Promovimi mund të bëhet përmes kanaleve të ndryshme mediatik, duke përfshirë këtu rrjetet sociale.
- AZhR-të duhet t'i orientojnë aktivitetet e tyre më shumë drejt adresimit të shqetësimeve të bizneseve. Ndihma e tyre ndaj bizneseve në formë drejtpërdrejtë, e jo nëpërmjet institucioneve publike, do të rezultojë në rezultate më të dukshme.

5 Takimet në bashki (town hall meetings) është një term amerikan që përdoret për takimet publike jo-formale, ose eventet që derivojnë nga takimet e bashkive të mbajtura dikur në Anglinë e Re. Këto takime janë të hapura për secilin banor të komunitetit dhe mbahen në ndërtesën e komunës. Pjesëmarrësit mund t'i ndajnë opinionet e tyre dhe t'u bëjnë pyetje figurave publike, zyrtarëve të zgjedhur, ose kandidatëve politik të vendit.

REFERENCAT

Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2013). Studim mbi remitancat në Kosovë – 2013. Prishtinë: Republika e Kosovës, 2013.

Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2013). *Popullsia e përgjithshme rezidente: Vlerësim Dhjetor 2012*. Prishtinë: Republika e Kosovës, 2013.

Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2013). Të dhëna demografike sipas komunave. Prishtinë: Republika e Kosovës, Prill 2013.

Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2013). *Të dhëna socio-ekonomike sipas komunave*. Prishtinë: Republika e Kosovës Maj, 2013

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2013). Stastikat e tregtisë ndërkombëtare. Prishtinë, Republika e Kosovës

Agjencia e Zhvillimit Rajonal Qendër et al. (2010). Strategjia zhvillimore e Rajonit Qendër 2010-2013. Prishtinë, Republika e Kosovës, 2010.

Agjencia e Zhvillimit Rajonal Lindje et al. (2010). Strategjia zhvillimore e Rajonit Lindje 2010-2013. Gjilan, Republika e Kosovës, 2010.

Agjencia e Zhvillimit Rajonal Perëndim et al. (2010). Strategjia zhvillimore e Rajonit Perëndim 2010-2013. Pejë, Republika e Kosovës, 2010.

Agjencia e Zhvillimit Rajonal Jug et al., Strategjia zhvillimore e Rajonit Jug 2010-2013. Prizren, Republika e Kosovës, 2010.

Agjencia e Zhvillimit Rajonal Veri et al. (2010). Strategjia zhvillimore e Rajonit Veri 2010-2013. Mitrovicë, Republika e Kosovës, 2010.

Banka Botërore. (2010). *“Kosovo: Unlocking Growth Potential: Strategies, Policies, Actions. A Country Economic Memorandum*. 29 April 2010. World Bank Report No. 53185-XK. Poverty Reduction and Economic Management Unit, Europe and Central Asia Region. Uashington, DC. <http://go.worldbank.org/SKC9IEMMC0>

Banka Botërore, T. W. (2011). Doing Business in South East Europe. Uashington, DC: Banka Botërore.

Banka Botërore (2012). World Development Report (WDR) 2013: Jobs. Banka Botërore, Uashington, D.C.

Banka Botërore. (2013). Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore në Kosovë në 2012-ën. Prishtinë, Agjenica e Statistikave e Kosovës, Shtator 2013.

Banka Botërore. (2013). Varfëri në Republikën e Kosovës në 2011-ën. Prishtinë, Agjenica e Statistikave e Kosovës, Mars 2013.

Banka Botërore, 2014, Data Bank, e përdorur nga: <http://databank.worldbank.org/data/home.aspx#>

Banka Botërore (2014). Raporti i të bërit biznes 2014: Profili ekonomik: Kosovë. Banka Botërore, Uashington

Banka Qendrore e Kosovës. (2013). *Raporti i Stabilitetit Financiar – 2012*. Prishtinë: Republika e Kosovës, 2013.

Banka Qendrore e Kosovës. (2014). *Raporti i Stabilitetit Financiar – 2013*. Prishtinë: Republia e Kosovës, 2014.

Canadian International Development Agency (CIDA) (2013). Policy on Private Sector Development. Kubek.

Instituti GAP (2011). Labour Law: Its implementation in the first six months. Prishtinë, Republika e Kosovës

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (2012). The Municipal Major a Representative or a Dominant Authority. Prishtinë, Republika e Kosovës

Instituti Riinvest (2003). Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë. Prishtinë, Republika e Kosovës

Instituti Riinvest (2011). Barrierat e Ndërmarrjeve Anketë . Prishtinë, Republika e Kosovës

Instituti Riinvest (2013). Performanca, barrierat, dhe besueshmëria e bizneseve në Kosovë. Prishtinë. Kosovë

International Monetary Fund (IMF). (2013). *Republic of Kosovo - Fifth review under the stand-by arrangement*. IMF Country Report No. 13/379, Dhjetor 2013

Komisioni Evropian (KE) (2013). Raporti i Progresit – Kosovë 2013.

Kosovo Association of Information and Communication Technology (STIKK) (2013). Analiza e tregut të ICT në Kosovë ICT . Prishtinë, Republika e Kosovës

KOSTT (2013). Studim rreth sigurisë dhe sigurimit të engjergjisë elektrike në Kosovë. Prishtinë, Republika e Kosovës.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) (2013). Strategjia e zhvillimit të sektorit privat 2013 – 2015. Prishtinë, Republika e Kosovës

Federata e Punëtorëve të Malit të Zi (MEF) (2013) Assesment of the Environemnt for Women Enterprentuershim in Montenegro.

Oda Ekonomike e Kosovës (2013). The Kosovo Business Climate Findings from the 1stquarter of 2013. Prishtinë. Kosovë

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) (2012). Perspectives on Local Economic Development in Kosovo's Decentralised Municipalities. Prishtinë, Republika e Kosovës

UNDP. (2012). *Human Development Report, 2012*. Pristina, United Nations Development Programme, 2012.

US Department of State (2013). Pasqyra e Klimës Investive –Kosovë. Raport.

Tetra Tech (2013). Korporata Energjetike e Kosoves (KEK) dhe Projekti i Furnizimit 2007-2013. Raport.

Transparency International (2013). Transparency International. Përdorur me 7 Korrik, 2014

SHTOJCAT

TABELA A1. DEFINIMI I BARRIERAVE

BARRIERAT	DEFINICIONET
Qasja e kufizuar në financa	I referohet vështirësive që lidhen me sigurimin e dokumenteve për kredi, garantuesve dhe dokumenteve tjera të nevojshme.
Kostoja e lartë financiare	I përfaqëson normat e interesit dhe kostot tjera administrative që bizneset duhet t'i paguajnë kur të aplikojnë për kredit biznesi në një institucion financiar.
Mungesa e subvencioneve shtetërore	Kjo i referohet mbështetjes financiare nga qeveria ose komuna dhe vështirësive që i hasin bizneset duke konkurruar me konkurrentët e jashtëm të cilët përkrahen nga qeveritë e tyre.
Telekomunikacioni jo-adekuat	E përfshin përhapjen e internetit dhe të rrjetit telefonik, si dhe tarifat.
Mungesa e energjisë elektrike	I referohet vështirësive që lindin si rezultat i problemeve për t'u lidhur me rrjet të energjisë elektrike, reduktimeve dhe tarifave.
Infrastruktura jo-adekuate e transportit	I referohet sfidave sa i përket rrugëve urbane, magjistrale dhe autostradave.
Qasja e kufizuar në tokë	I referohet sfidave që lidhen me çmimin e tokës dhe dokumentet e përvetësimit.
Problemet që lidhen me parkingun e veturave	I referohet problemeve për të gjetur parking me kohë.
Taksat e larta	I referohet problemeve që derivojnë nga taksa në të ardhura, taksa në korporatë, akciza, TVSH-ja dhe taksat tjera indirekte.
Administrata tatimore jo-efiçente	I referohet stafit jo-profesional që punon në administratën tatimore; po ashtu, përfshin numrin e pamjaftueshëm të inspektorëve në administratë.
Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare	I referohet problemeve që lidhen me barrierat tregtare tarifore dhe jo-tarifore.

BARRIERAT

DEFINICIONET

Licencimi jo-efiçent i bizneseve dhe procedurat e lejeve	I referohet kostos dhe kohës që duhet ta “paguajnë” bizneset për të marrë një licencë apo leje nga institucionet kompetente.
Mungesa e punëtorëve të shkolluar dhe të shkathët	I referohet vështirësive që derivojnë nga shkathtësitë dhe niveli i mjaftueshëm i arsimimit tek fuqia punëtore në tregun e Kosovës
Sistemi gjyqësor jo-funksional	I referohet vështirësive që lidhen me ligjet, numrin e gjyqtarëve dhe in-efiçencën e gjykatave në përgjithësi.
Korrupsioni	I referohet sfidave që lidhen me mashtrimet nga pushtetarët, duke e përfshirë kryesisht mit-marrjen.
Krimi i rrugëve, vjedhja dhe mungesa e rregullit	I referohet vandalizmit të mafisë që ndodhë në vendet ku bizneset operojnë.
Konkurrenca jo-fer	I referohet vështirësive që lindin nga konkurrenca jo e barabartë për shkak të evazionit fiskal apo informalitetit në përgjithësi.
Tregu i vogël	I referohet numrit të vogël të klientëve potencial.
Mungesa e motivimit të punëtorëve	I referohet problemeve që derivojnë nga motivimi i ulët i punëtorëve për të kryer një punë të dhënë.
Zhvatja	I referohet parave që bizneset duhet t'i paguajnë për shkak të kërcënimeve nga grupet e krimit të organizuar.
Shkelja e kontratave nga klientët dhe furnizuesit.	I referohet problemeve me të cilat bizneset ballafaqohen sa i përket (mos)zbatimit të kontratave
Vështirësitë në mbledhjen e borxheve	I referohet vështirësive që lidhen me mbledhjen e borxheve nga furnizuesit dhe klientët.
Ligji i pafavorshëm i punës	I përfaqëson problemet të lidhura me implementimin e ligjit të punës të aprovuar në 2010-ën.

TABELA A2. RENDITJA E BARRIERAVE NË TË BËRIT BIZNES NË RAJONIN QENDËR (SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)

		Tani	Para 4 vjetëve	Pas 4 vjetëve
1	Kostoja e lartë e financimit	76.4	78.0	64.1
2	Mungesa e subvencioneve shtetërore	75.5	78.2	65.1
3	Korrupsioni	74.9	75.8	64.2
4	Konkurrenca jo-fer	73.4	73.5	60.6
5	Problemet që lidhen me parkingun	69.7	73.0	61.5
6	Taksat e larta	68.4	70.1	58.8
7	Sistemi gjyqësor jo-funksional	68.4	70.2	58.9
8	Tregu i vogël	65.5	63.7	57.8
9	Krimi i rrugës, vjedhja dhe mungesa e rregullit	62.5	65.3	56.9
10	Qasja e kufizuar në financa	61.9	62.4	51.8
11	Vështirësitë në mbledhjen e borxhit	59.7	58.9	50.8
12	Qasja e kufizuar në tokë	55.3	56.4	49.6
13	Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare	53.9	56.8	45.4
14	Mungesa e motivit tek punëtorët	52.8	52.8	44.4
15	Ligji i pafavorshëm i punës	45.2	48.1	40.8
16	Infrastruktura jo-adekuate e transportit	43.9	50.9	38
17	Administrata tatimore jo-efiçente	43.9	45.3	42.1
18	Mungesa e punëtorëve të arsimuar dhe të aftë	43.8	48.3	38.6
19	Licencimi jo-efiçent i bizneseve dhe procedurat e lejes	41.7	45.6	38.2
20	Shkelja e punëtorëve nga klientët dhe furnizuesit	41.5	42.5	37
21	Mungesa e energjisë elektrike	41.0	63.1	36.9
22	Zhvatja	34.7	36.4	35.6
23	Telekomunikacioni jo-adekuat	34.3	43.0	32.2

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

TABELA A3. RENDITJA E BARRIERAVE NË TË BËRIT BIZNES NË RAJONIN LINDJE (SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)

		Tani	Para 4 vjetëve	Pas 4 vjetëve
1	Kostoja e lartë e financimit	88.8	89.2	70.3
2	Mungesa e subvencioneve shtetërore	83.5	82.9	66.3
3	Konkurrenca jo-fer	83.3	84.4	67.8
4	Korrupsioni	82.1	83	71.4
5	Taksat e larta	77.8	79.8	64.8
6	Sistemi gjyqësor jo-funksional	77.2	79.1	67.7
7	Qasja e kufizuar në financa	70.7	72.8	56.7
8	Krimi i rrugës, vjedhja dhe mungesa e rregullit	69.6	70.5	62.1
9	Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare	67.1	68.2	56
10	Problemet që lidhen me parkingun	64.4	62.8	54.5
11	Tregu i vogël	63.5	61.8	48.6
12	Vështirësitë në mbledhjen e borxhit	62.7	63.3	48.4
13	Administrata tatimore jo-efiçente	59.7	62.7	50.4
14	Qasja e kufizuar në tokë	57.4	60	49.5
15	Ligji i pafavorshëm i punës	47.9	48.6	42.4
16	Mungesa e energjisë elektrike	45.6	76.9	34.4
17	Shkelja e punëtorëve nga klientët dhe furnizuesit	45.6	45.9	36.9
18	Mungesa e motivit tek punëtorët	44.9	44.8	38.2
19	Infrastruktura jo-adekuate e transportit	43.9	53.3	34.8
20	Mungesa e punëtorëve të arsimuar dhe të aftë	43.3	47.7	35
21	Licencimi jo-efiçent i bizneseve dhe procedurat e lejes	40.9	43.7	35.8
22	Telekomunikacioni jo-adekuat	35.7	45.1	30.9
23	Zhvatja	32.4	31.2	30.4

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

TABELA A4. RENDITJA E BARRIERAVE NË TË BËRIT BIZNES NË RAJONIN JUG (SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)

		Tani	Para 4 vjetëve	Pas 4 vjetëve
1	Kostoja e lartë e financimit	83.8	82.2	70.6
2	Mungesa e subvencioneve shtetërore	83.4	83.9	70.1
3	Konkurrenca jo-fer	77.3	76	65.7
4	Korrupsioni	77.3	77.7	68.6
5	Taksat e larta	76	75.2	62.9
6	Sistemi gjyqësor jo-funksional	73.2	73.1	63.7
7	Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare	72.3	69.8	60.7
8	Problemet që lidhen me parkingun	71.8	72.5	65.9
9	Krimi i rrugës, vjedhja dhe mungesa e rregullit	71.6	73.5	62
10	Vështirësitë në mbledhjen e borxhit	69.9	69.3	60.1
11	Qasja e kufizuar në tokë	69.9	69.9	60.1
12	Tregu i vogël	66.1	67.1	60.1
13	Zhvatja	59.3	59.7	53.7
14	Ligji i pafavorshëm i punës	57.7	57.3	47.3
15	Licencimi jo-efiçent i bizneseve dhe procedurat e lejes	57.7	60.5	49.5
16	Mungesa e motivit tek punëtorët	57.4	56.1	50.8
17	Qasja e kufizuar në financa	54.4	65.2	48.2
18	Shkelja e punëtorëve nga klientët dhe furnizuesit	54	54.9	45.3
19	Mungesa e punëtorëve të arsimuar dhe të aftë	51.3	54.3	43.7
20	Administrata tatimore jo-efiçente	49	52.3	40.2
21	Infrastruktura jo-adekuate e transportit	47.5	62	41.7
22	Mungesa e energjisë elektrike	45.6	73.8	38.6
23	Telekomunikacioni jo-adekuat	39.4	54.8	34

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

TABELA A5. RENDITJA E BARRIERAVE NË TË BËRIT BIZNES NË RAJONIN PERËNDIM (SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)

		Tani	Para 4 vjetëve	Pas 4 vjetëve
1	Korrupsioni	91.2	92.4	77.4
2	Konkurrenca jo-fer	86.1	86.1	75.7
3	Kostoja e lartë e financimit	85.3	85.6	72.4
4	Krimi i rrugës, vjedhja dhe mungesa e rregullit	83.7	85	68.7
5	Sistemi gjyqësor jo-funksional	82.4	85.5	73.6
6	Mungesa e subvencioneve shtetërore	81.1	82.9	70.5
7	Taksat e larta	76.9	78.9	63.2
8	Tregu i vogël	76.1	75.8	65.3
9	Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare	72.6	75	63.2
10	Problemet që lidhen me parkingun	70.6	71.7	63.2
11	Qasja e kufizuar në financa	68.2	71.5	55.9
12	Zhvatja	66.7	68.5	51
13	Qasja e kufizuar në tokë	63.8	66.2	58.4
14	Ligji i pafavorshëm i punës	62.1	64.1	50.8
15	Mungesa e motivit tek punëtorët	59.4	61	48.9
16	Shkelja e punëtorëve nga klientët dhe furnizuesit	57.8	61.6	49.5
17	Administrata tatimore jo-efiçente	57.2	61.1	50.4
18	Vështirësitë në mbledhjen e borxhit	55.9	59.3	48.8
19	Licencimi jo-efiçent i bizneseve dhe procedurat e lejes	55.8	62.6	47.8
20	Mungesa e punëtorëve të arsimuar dhe të aftë	53.4	57.7	43.3
21	Infrastruktura jo-adekuate e transportit	49	55.8	43.3
22	Mungesa e energjisë elektrike	42.6	64.4	35.3
23	Telekomunikacioni jo-adekuat	40.3	45.3	34

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS

TABELA A6. RENDITJA E BARRIERAVE NË TË BËRIT BIZNES NË RAJONIN VERI (SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)

		Tani	Para 4 vjetëve	Pas 4 vjetëve
1	Kostoja e lartë e financimit	83.8	82.2	70.6
2	Mungesa e subvencioneve shtetërore	83.4	83.9	70.1
3	Korrupsioni	77.3	77.7	68.6
4	Konkurrenca jo-fer	77.3	76	65.7
5	Taksat e larta	76	75.2	62.9
6	Sistemi gjyqësor jo-funksional	73.2	73.1	63.7
7	Tarifat e larta doganore dhe rregulloret e rënda tregtare	72.3	69.8	60.7
8	Problemet që lidhen me parkingun	71.8	72.5	65.9
9	Krimi i rrugës, vjedhja dhe mungesa e rregullit	71.6	73.5	62
10	Qasja e kufizuar në tokë	69.9	69.9	60.1
11	Vështirësitë në mbledhjen e borxhit	69.9	69.3	60.1
12	Tregu i vogël	66.1	67.1	60.1
13	Zhvatja	59.3	59.7	53.7
14	Licencimi jo-efiçent i bizneseve dhe procedurat e lejes	57.7	60.5	49.5
15	Ligji i pafavorshëm i punës	57.7	57.3	47.3
16	Mungesa e motivit tek punëtorët	57.4	56.1	50.8
17	Qasja e kufizuar në financa	54.4	65.2	48.2
18	Shkelja e punëtorëve nga klientët dhe furnizuesit	54	54.9	45.3
19	Mungesa e punëtorëve të arsimuar dhe të aftë	51.3	54.3	43.7
20	Administrata tatimore jo-efiçente	49	52.3	40.2
21	Infrastruktura jo-adekuate e transportit	47.5	62	41.7
22	Mungesa e energjisë elektrike	45.6	73.8	38.6
23	Telekomunikacioni jo-adekuat	39.4	54.8	34

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE NGA TË DHËNAT E ANKETËS



ZYRA E
BASHKIMIT
EVROPIAN
NË KOSOVË

INSTITUTI PËR
HULUMTIME
ZHVILLIMORE
RIINVEST

